

POLITIKA MJEDISORE DHE SOCIALE

Miratuar nga Këshilli i Administrimit, në mbledhjen e datës 7 maj 2014

Përkthimet e tekstit origjinal të këtij dokumenti bëhen nga BERZH-i vetëm për lehtësi të lexuesit. Ndërkohë që BERZH ka treguar kujdes të arsyeshëm për të siguruar autenticitetin e përkthimit, BERZH nuk garanton e as vërteton saktësinë e përkthimit. Lexuesi që mbështetet në një përkthim të tillë, e bën këtë me përgjegjësinë e vet. Në asnjë rrethanë, BERZH-i, punonjësit ose agjentët e saj nuk mbajnë përgjegjësi përpara lexuesit apo përpara kujtdo tjetër për ndonjë pasaktësi, gabim, mungesë, fshirje, defekt dhe/ose ndryshim të përmbajtjes së përkthimit, pavarësisht shkakut, ose për ndonjë dëm që vjen si pasojë e tyre. Në rast mospërputhjeje mes versionit në gjuhën angleze dhe atij të përkthyer, përparësi ka versioni në gjuhën angleze.

Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it

A. Qëllimi i kësaj Politike

1. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH ose Banka) është e angazhuar të promovojë “zhvillim të qëndrueshëm dhe që mbështet mjedisin” në të gjithë gamën e veprimtarive të saj në fushën e investimeve dhe bashkëpunimit teknik, në zbatim të Marrëveshjes themeluese të BERZH-it.¹ Banka beson se qëndrueshmëria mjedisore dhe sociale² është aspekti themelor i arritjes së rezultateve në përputhje me mandatin e saj për tranzicionin dhe konfirmon se projektet që nxisin qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale gëzojnë përparësinë më të lartë në veprimtaritë e saj.
2. Në këtë Politikë, termi “projekt” përdoret për tërësinë e përcaktuar të veprimtarive tregtare për të cilat një klient kërkon financim nga BERZH-i ose për të cilat është siguruar që më parë financim nga BERZH-i, ku tërësia e veprimtarive të punës është përcaktuar në kontratat e financimit dhe është miratuar nga Këshilli i Administrimit ose nga një organ tjetër vendimmarrës.
3. Në këtë Politikë parashtrohet se si Banka duhet të trajtojë ndikimet mjedisore dhe sociale të projekteve të saj:
 - përmes përcaktimit të roleve dhe përgjegjësiwe përkatëse të BERZH-it dhe klientëve të saj gjatë planifikimit, zbatimit dhe shfrytëzimit të projekteve në përputhje me këtë Politikë dhe me kriteret e performancës
 - përmes vendosjes së një objektiwi strategjik për promovimin e projekteve me përfitime mjedisore dhe sociale të mëdha
 - përmes përfshirjes së elementëve të qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale në të gjitha veprimtaritë e saj.

B. Angazhimet e BERZH-it

4. Të gjitha projektet e BERZH-it duhet të strukturohen në mënyrë të atillë që të përmbushin kërkesat e kësaj Politike.
5. BERZH-i ka miratuar një paketë specifike kriteresh të performancës (KP) që pritet të përmbushin projektet. Banka pret prej klientëve të saj që ata të menaxhojnë çështjet mjedisore dhe sociale që shoqërojnë projektet, për të përmbushur KP-të brenda një periudhe të arsyeshme kohore.
6. BERZH-i do të kërkojë, brenda mandatit të saj, të sigurojë përmes proceseve të saj të vlerësimit dhe të monitorimit mjedisor dhe social, planifikimin, zbatimin dhe funksionimin e projekteve në përputhje me kërkesat rregullatore të zbatueshme dhe praktikën e mirë ndërkombëtare (PMN).³ Thelbësore për këtë qasje është përdorimi i shkallës së zbutjes së ndikimeve.⁴

¹ Neni 2.1, nënpika vii e Marrëveshjes themeluese të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

² Në kuptim të kësaj Politike, fjala sociale përdoret për ato çështje që u përkasin personave të prekur nga projekti dhe komuniteteve të tyre, si dhe punonjësve dhe kanë të bëjnë me statusin shoqëror-ekonomik, pozitat e pambrojtura, identitetin gjinor, të drejtat e njeriut, orientimin seksual, trashëgiminë kulturore, kushtet e punës, shëndetin dhe sigurinë dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje.

³ Praktika e mirë ndërkombëtare është ushtrimi i zotësisë profesionale, korrektesës, maturisë dhe vizionit afatgjatë që do të pritej në mënyrë të arsyeshme nga profesionistët e zotë e me përvojë, të angazhuar në të njëjtën lloj ndërmarrjeje në kushte të njëjta ose të ngjashme në shkallë botërore ose rajonale. Rezultati i një ushtrimi të tillë duhet të jetë që projekti të përdorë teknologjitë më të përshtatshme në rrethanat specifike të projektit.

⁴ Hierarkia zbutëse përfshin masat e marra për të shmangur krijimin e ndikimeve mjedisore ose sociale që në fillim të veprimtarive të zhvillimit dhe, kur kjo nuk është e mundur, për të zbatuar masa të tjera shtesë që do ta minimizonin, zbusnin dhe, si zgjidhje të fundit, kompensonin çdo ndikim të mbetur të padëshirueshëm.

7. BERZH-i, si nënshkruese e Parimeve Evropiane për Mjedisin,⁵ është e angazhuar për nxitjen e përdorimit të parimeve, praktikave dhe standardeve thelbësore mjedisore të BE-së⁶ përmes projekteve të financuara nga BERZH, kur këto mund të përdoren në nivel të projektit, pavarësisht vendndodhjes gjeografike. Kur rregulloret e vendit pritës ndryshojnë nga standardet mjedisore organike të BE-së, nga projektet do të pritet të përmbushin nivelin më të rreptë të rregullimit.
8. BERZH-i njez ratifikimin e marrëveshjeve, traktateve dhe konventave mjedisore dhe sociale ndërkombëtare nga vendet ku ushtron aktivitetin. BERZH-i duhet të kërkojë, brenda mandatit të saj, t'i strukturojë projektet që financon në mënyrë të atillë që të orientohen nga parimet përkatëse dhe kërkesat thelbësore të së drejtës ndërkombëtare. BERZH-i nuk duhet të financojë me dijeni projekte të cilët do të binin ndesh me detyrimet e një vendi në bazë të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të identifikuar gjatë fazës së përgatitjes dhe miratimit të projektit.
9. BERZH-i njez përgjegjësinë e klientëve dhe të veprimtarive të tyre për të respektuar të drejtat e njeriut⁷ dhe ky është një aspekt tërësor i qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale. Kjo përgjegjësi kërkon respektimin e të drejtave të njeriut, shmangien e shkeljes të të drejtave të njeriut për të tjerët dhe trajtimin e ndikimeve të padëshirueshme tek të drejtat e njeriut që mund të shkaktojnë veprimtaritë e tyre tregtare ose në të cilat ato mund të kontribuojnë.
10. BERZH-i beson se barazia gjinore është një aspekt themelor i një ekonomie bashkëkohore dhe mirë-funksionuese tregu dhe i një shoqërie demokratike. BERZH-i pret nga klientët të identifikojnë çdo ndikim të mundshëm që thellon pabarazitë gjinore dhe ndikime të padëshirueshme dhe të marrin përsipër hartimin e masave zbutëse për zvogëlimin e tyre. Sipas rastit, klientëve do t'u kërkohet të rrisin efektin pozitiv gjinor të projekteve përmes promovimit të barazisë së mundësive dhe fuqizimit shoqëror-ekonomik të grave, sidomos në lidhje me mundësitë për të marrë financim, shërbime dhe punësim.
11. BERZH-i do të vlerësojë nivelin deri ku ndryshimet tarifore të shkaktuara nga projektet mund të krijojnë probleme lidhur me përbalimin financiar të niveleve bazë të shërbimeve për grupet e popullsisë në pozita të pafavorshme dhe/ose më të ndjeshëm⁸ dhe duhet të bindet se janë hartuar dhe vënë në zbatim skema të efektshme për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi.
12. Përmes zbatimit të kësaj Politike, BERZH-i duhet të ndërtojë partneritete me klientët për t'i ndihmuar ata në rritjen e vlerës së veprimtarive të tyre, për të rritur qëndrueshmërinë afatgjatë dhe për ta fuqizuar kapacitetin e tyre për menaxhimin mjedisor dhe social.

⁵ Parimet Evropiane për Mjedisin (PEM) janë miratuar nga Këshilli i Bankës Evropiane për Zhvillim, BERZH-i, Banka Evropiane e Investimeve, Korporata Nordike për Financimin e Mjedisit dhe Banka Nordike e Investimeve. PEM është një nismë e marrë në përgjigje të shtytjes për rritje të harmonizimit të parimeve, praktikave dhe standardeve mjedisore që shoqërojnë financimin e projekteve. Angazhimet e PEM janë reflektuar në kriteret KP 1, KP 3, KP 4 dhe KP 10.

⁶ Standardet mjedisore thelbësore të Bashkimit Evropian jepen në legjislacionin dytësor të BE-së, për shembull në rregullore, direktiva dhe vendime. Nga ky përkufizim përjashtohen normat procedurale që u drejtohen shteteve anëtare dhe institucioneve të BE-së dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila zbatohet për shtetet anëtare, institucionet e BE-së dhe personat juridikë dhe fizikë të BE-së.

⁷ Në kuptim të kësaj Politike, BERZH-i orientohet nga Karta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe tetë konventat qendrore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

⁸ Në kuptim të kësaj Politike, grupet në pozita të pambrojtura janë ata persona të cilët, për shkak të identitetit gjinor, orientimit seksual, fesë, përkatësisë etnike, statusit si indigjenë, moshës, aftësive të kufizuara, pozitës së pafavorshme ekonomike apo statusit shoqëror, mund preken më negativisht nga ndikimet e projektit në krahasim me të tjerët dhe të cilët mund ta kenë të kufizuar mundësinë për të kërkuar të drejtat e tyre apo për të marrë përfitimet e projektit. Individët dhe/ose grupet në pozita të pambrojtura mund të përfshijnë, ndër të tjerë, edhe personat që jetojnë nën kufirin e varfërisë, personat pa tokë, të moshuarit, familjet me kryefamiljare gra ose fëmijë, refugjatët, personat e shpërngulur brendapërbrenda vendit, pakicat kombëtare, komunitetet që varen nga me burimet natyrore ose çdo person tjetër të zhvendosur që mund të mos mbrohet nga legjislacioni kombëtar dhe/ose e drejta ndërkombëtare.

13. BERZH-i nje rëndësinë e trajtimit të shkaqeve dhe të pasojave të ndryshimeve klimatike në vendet ku ushtron aktivitetin. BERZH-i do të angazhohet, sa herë të jetë nevoja, në investime novatore dhe asistencë teknike për të mbështetur investime pa ose me nivel të ulët karboni dhe mundësi për zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike, si dhe do të identifikojë mundësitë për pakësimin e shkarkimeve në projektet e mbështetura nga BERZH-i. BERZH-i do të mbështesë klientët edhe në hartimin e masave përshtatëse që nxisin investime ripërtëritëse ndaj ndikimeve klimatike.
14. BERZH-i do të tregojë kujdes në qasjen e saj për mbrojtjen, ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe do të kërkojë që projektet përkatëse të përfshijnë masa për ruajtjen dhe, nëse mundet, për përmirësimin e ekosistemeve dhe të biodiversitetit që ato mbështesin.
15. BERZH-i është e angazhuar për parimet e transparencës, llogaridhënies dhe angazhimit të palëve të interesit. Ajo do të japë herë pas here informacion të përmbledhur për ecurinë e Bankës në fushën e çështjeve mjedisore dhe sociale dhe do të përfshihet në dialog të plotë me palët e interesit të Bankës, në përputhje me Politikën e BERZH-it për informimin e publikut (PIP). Banka do të nxisë praktika të mira të ngjashme tek klientët e saj.
16. BERZH-i do të punojë së bashku me institucione të tjera financiare ndërkombëtare, Bashkimin Evropian, donatorët dypalësh, agjencitë e OKB-së dhe organizata të tjera për të bashkërenduar ndërhyrje të efektshme për nxitjen e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale në nivel rajonal ose sektorial në vendet ku ushtron aktivitetin. Kur bashkëfinancon projekte me institucione të tjera financiare ndërkombëtare, BERZH-i do të synojë të bashkëpunojë me to për të rënë dakord për një qasje të përbashkët për përgatitjen dhe miratimin e projekteve, kërkesat dhe monitorimin e tyre.
17. Strategjitë e BERZH-it për vendet përkatëse, si edhe strategjitë dhe politikat sektoriale, do të përmbajnë informacion për sfidat dhe shanset e mundshme mjedisore dhe sociale të cilat shoqërojnë veprimtaritë e parashikuara të BERZH-it.
18. Përmes bashkëpunimit teknik dhe dialogut për politikat, BERZH-i do të synojë gjetjen e mundësive për të ngritur kapacitetet për marrjen në konsideratë dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore dhe sociale në vendet ku ushtron aktivitetin. BERZH-i do të drejtojë procesin e zhvillimit të një mjedisi nxitës, në të cilin klientët e saj do të arrijnë rezultate me qëndrueshmëri mjedisore dhe sociale.
19. Në funksionimin e tij të brendshëm, BERZH-i do të përdorë praktikën e mirë ndërkombëtare në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale dhe do të synojë të punojë me furnitorë dhe sipërmarrës që ndjekin standarde po kaq të larta.

C. Integrimi i argumenteve mjedisore dhe sociale në ciklin e projektit

Roli dhe përgjegjësitë e BERZH-it

20. Përgjegjësitë e BERZH-it janë në përputhje me rolin e saj si institucion financiar ndërkombëtar që jep financim bankar për projekte, duke përdorur burimet e BERZH-it, të miratuara nga administratorët dhe Këshilli i Administrimit ose nga një organ tjetër vendimmarrës. Në lidhje me çdo projekt të veçantë investimi ose bashkëpunimi teknik, niveli i angazhimit të BERZH-it përcaktohet nga natyra dhe objekti i projektit, gatishmëria e fondeve të donatorëve, si dhe nga rrethanat konkrete të bashkëpunimit dhe marrëdhënies me klientin.
21. BERZH-i mund të mos e financojë një projekt, për arsye mjedisore ose sociale. BERZH-i nuk do të financojë projekte që, në dijeninë e saj, ose kërkojnë ose do të sjellin si pasojë dëbime me

forcë të popullsisë.⁹ Gjithashtu, ka disa lloje veprimtarish të cilat BERZH-i nuk i financon, në përputhje me Listën e përjashtimit mjedisor dhe social të BERZH-it, e përfshirë në Shtojcën 1, bashkëlidhur kësaj Politike.

22. BERZH-i administron një sërë fondesh të posaçme dhe fondesh bashkëpunimi. Projektet ose veprimtaritë e financuara tërësisht ose pjesërisht me fonde të posaçme duhet të jenë në përmbushje të kësaj Politike. Kjo Politikë zbatohet edhe për fondet e bashkëpunimit, por mund të zbatohen edhe kërkesa të tjera shtesë të donatorëve në lidhje me çështjet mjedisore ose sociale, me kusht që të jenë në përputhje me këtë Politikë.

Cikli i jetës së projektit

Kategorizimi

23. BERZH-i kategorizon çdo projekt për të përcaktuar natyrën dhe nivelin e nevojshëm të hetimeve mjedisore dhe sociale, të dhënies së informacioneve dhe të përfshirjes së palëve të interesit. Kjo duhet të bëhet në përpjesëtim të drejtë me natyrën, vendndodhjen, ndikimin dhe shkallën e projektit dhe me rëndësinë e ndikimeve të padëshirueshme mjedisore dhe sociale që mund të ketë në të ardhmen. Çështjet mjedisore dhe sociale në të shkuarën dhe të tashmen dhe rreziqet e lidhura me objektet ekzistuese sipas projektit duhet t'i nënshtrohen vlerësimit paraprak mjedisor dhe social, pavarësisht kategorizimit.

Investimet e drejtpërdrejta¹⁰

24. Një projekt i përket kategorisë A nëse do të sillte ndikime të padëshirueshme mjedisore dhe/ose sociale të konsiderueshme në të ardhmen të cilat, në momentin e kategorizimit, nuk mund të identifikohen ose të analizohen pa vështirësi dhe që kërkojnë, për rrjedhojë, një proces pjesëmarrjeje dhe të zyrarizuar vlerësimi të ndikimeve mjedisore dhe sociale (VNMS). Një listë orientuese për projekte të kategorisë A paraqitet në Shtojcën 2 bashkëlidhur kësaj Politike.
25. Një projekt i përket kategorisë B nëse ndikimet e padëshirueshme mjedisore dhe/ose sociale që mund të ketë në të ardhmen zakonisht janë specifike për vendndodhjen dhe/ose identifikohen dhe trajtohen pa vështirësi përmes masave zbutëse. Kërkesat e vlerësimit paraprak mjedisor dhe social mund të ndryshojnë në varësi të projektit dhe të përcaktohen nga BERZH-i rast pas rasti.
26. Një projekt i përket kategorisë C nëse ka të ngjarë të ketë shumë pak ose aspak ndikime të padëshirueshme mjedisore dhe/ose sociale në të ardhmen dhe mund të trajtohet pa vështirësi përmes një vlerësimi paraprak mjedisor dhe social të kufizuar.
27. Shqyrtimet fillestare mjedisore dhe sociale (SHFMS) do të kryhen kur ka informacion të pamjaftueshëm në momentin e kategorizimit për të përcaktuar kategorinë e duhur dhe objektin e vlerësimit.

Ndërmjetësit financiarë

⁹ Veprimet dhe/ose mosveprimet që përfshijnë zhvendosjen me forcë ose të detyrueshme të individëve, grupeve dhe komuniteteve nga shtëpitë dhe/ose tokat dhe burimet në pronësi të përbashkët, të cilat i kanë patur në shfrytëzim apo me të cilat kanë jetuar, duke eliminuar ose kufizuar kështu mundësinë e individit, grupit ose komunitetit të banojë ose të punojë në një banesë ose vend të caktuar, pa i ofruar ose dhënë të drejtën e mbrojtjes ligjore ose formave të tjera të mbrojtjes. Këto nuk përfshijnë dëbimet e kryera në përputhje me ligjin dhe me dispozitat e traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

¹⁰ Projektet e BERZH-it ndahen në "Projekte të investimeve të drejtpërdrejta" dhe "Projekte me ndërmjetës financiarë". Në rastin e projekteve me ndërmjetës financiarë, klienti është një ofruar i shërbimeve financiare, një fond investimi ose një subjekt tjetër i ngjashëm. Të gjitha projektet e tjera janë projekte të investimeve të drejtpërdrejta.

28. Një projekt i përket kategorisë NF nëse struktura e financimit kërkon që fondet të jepen përmes ndërmjetësve financiarë (NF) ku ndërmjetësi financiar¹¹ merr përsipër detyrën e vlerësimit paraprak dhe të monitorimit të nënprojektit.

Qasja e përgjithshme për vlerësimin paraprak të projekteve

29. Të gjitha projektet duhet t'i nënshtrohen vlerësimit paraprak mjedisor dhe social, si për të ndihmuar BERZH-in të vendosë nëse do të financohet apo jo projekti dhe, nëse po, edhe për mënyrën me të cilën duhen trajtuar çështjet mjedisore dhe sociale gjatë planifikimit, zbatimit dhe funksionimit të projektit. Vlerësimi paraprak duhet të bëhet sipas natyrës dhe shkallës së projektit, në përpjesëtim të drejtë me nivelin e çështjeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale, dhe në respekt të nivelit të shkallës zbutëse. Vlerësimi duhet të analizojë nëse mund të zbatohet ose jo projekti në përputhje me këtë Politikë dhe me kriteret e performancës dhe duhet të përfshijë një analizë të rreziqeve të mundshme financiare, juridike dhe të emrit të mirë, si dhe duhet të identifikojë avantazhet e mundshme mjedisore ose sociale. Vlerësimi social dhe mjedisor është pjesë e pandashme e vlerësim-miratimit të përgjithshëm që i bën BERZH-i projektit. BERZH-i mund të kërkojë këshilla të specialistëve të tretë për të ndihmuar në analizën e çështjeve të specializuara ose teknike.
30. Vlerësimi mjedisor dhe social i BERZH-it përfshin marrjen në konsideratë të tre elementeve kyçe: i. çështjet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale që shoqërojnë projektin, ii. kapaciteti dhe angazhimi i klientit për ta zbatuar projektin në përputhje me kriteret përkatëse të performancës dhe iii. për aq sa duhet, objektet dhe veprimtaritë të cilat janë të lidhura me projektin, por që nuk janë financuar nga BERZH-i. Objekti i vlerësimit mjedisor dhe social i BERZH-it përcaktohet rast pas rasti, por mund të përfshijë edhe shqyrtimin e rreziqeve dhe të përgjegjësive të mundshme të lidhura me pasuritë e vendosura si garanci.
31. Është përgjegjësi e klientit të sigurojë dhënien e informacionit të duhur në mënyrë që Banka të mund të kryejë një vlerësim mjedisor dhe social në përputhje me këtë Politikë. Roli i Bankës është: i. shqyrtimi i informacionit të klientit, ii. dhënia e orientimeve për të ndihmuar klientin në hartimin e masave të duhura në përputhje me shkallën e zbutjes për t'u dhënë zgjidhje ndikimeve mjedisore dhe sociale në përmbushje të kriterëve përkatëse të performancës dhe iii. dhënia e ndihmës për të identifikuar mundësitë për përfitime mjedisore ose sociale shtesë.
32. BERZH-i e pranon se projektet mund të kenë nivel të ndryshëm informacioni të gatshëm në kohën kur Banka bën vlerësimin për miratim të projektit. Në disa raste, përdorimi i propozuar i mjeteve monetare nga investimi i BERZH-it dhe gjurma përkatëse mjedisore dhe sociale njihen dhe kuptohen gjerësisht në momentin e vendimit të Bankës për të investuar, siç ndodh normalisht në financimin tradicional të projekteve. Por, në raste të tjera, investimi i Bankës mund të mos ketë për objekt aktive fizike konkrete, si në rastin e financimit të kapitalit qarkullues dhe të disa llojeve të instrumenteve të kapitalit neto, apo kur fondet janë përcaktuar për aktivitete të ardhshme. Në këto rrethana, përdorimi i propozuar i mjeteve monetare dhe gjurma mjedisore dhe sociale janë përgjithësisht të paqarta në momentin e marrjes së vendimit të BERZH-it për të investuar. Për rrjedhojë, Banka i. duhet ta analizojë investimin në bazë të rreziqeve dhe ndikimeve të vetvetishme të sektorit në fjalë dhe të kushteve në të cilat ushtrohet veprimtaria tregtare dhe ii. duhet të analizojë kapacitetin e klientit për ta zbatuar projektin në përputhje me kriteret e performancës.
33. Kur BERZH-it i paraqitet kërkesë për të financuar një projekt, që është në ndërtim e sipër, ose kur projekti i ka marrë lejet përkatëse në vendin pritës, përfshirë edhe miratimin e vlerësimeve të ndikimit lokal mjedisor dhe social, vlerësimi paraprak i Bankës duhet të përfshijë një analizë të boshllëqeve të planifikimit dhe të zbatimit të projektit kundrejt kriterëve të performancës për të

¹¹ Ndër të tjerë, në ndërmjetësit financiarë përfshihen fondet e kapitalit privat, bankat, shoqëritë e financimit në formë qiraje, shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensione.

identifikuar studimet dhe/ose masat zbutëse shtesë që nevojiten për të përmbushur kërkesat e BERZH-it.

34. Vlerësimi paraprak i projektit nga BERZH-i u kërkon klientëve të identifikojnë palët e interesit që mund të preken nga projektet dhe/ose mund të jenë të interesuar për këto projekte, të japin informacion të mjaftueshëm për çështjet dhe ndikimet që lindin nga projektet dhe të konsultohen me palët e interesit në mënyrë të plotë dhe të përshtatshme në aspektin kulturor. Në veçanti, BERZH-i u kërkon klientëve të angazhohen me palët përkatëse të interesit, në përputhje me ndikimet e mundshme që shoqërojnë projektin dhe nivelin e shqetësimit. Një përfshirje e tillë e palëve të interesit duhet të realizohet duke mbajtur parasysh frymën dhe parimet e Konventës së UNECE-së mbi Të drejtën për informim, Pjesëmarrjen publike në vendim-marrje dhe Të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore. Për projektet objekt të VNMS-së që mund të kenë ndikime të konsiderueshme mjedisore përgjatë kufijve ndërkombëtarë, Banka do të nxisë qasjen e Konventës së UNECE-së “Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në nivel ndërkufitar”, pavarësisht vendndodhjes së projektit apo ndikimit të tij të mundshëm. Banka, në disa raste, mund të zhvillojë vetë konsultime publike për të nxjerrë në pah pikëpamjet e palëve të interesit. Identifikimi dhe angazhimi i palëve të interesit mund të përfshihet, sipas rastit, edhe në veprimtaritë teknike të Bankës.
35. Për projektet me ndërmjetës financiarë, Banka do të kryejë studimin e korrektësisë për ndërmjetësin financiar dhe portofolin e ndërmjetësit financiar, për të analizuar i. politikat dhe procedurat ekzistuese mjedisore dhe sociale të ndërmjetësit financiar dhe kapacitetin e tij për t'i zbatuar ato, ii. çështjet mjedisore dhe sociale që shoqërojnë portofolin ekzistues dhe të ardhshëm të ndërmjetësit financiar dhe iii. masat e nevojshme për të fuqizuar sistemin ekzistues të masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale.

Kriteret e performancës (KP)

36. Projektet pritet të përmbushin praktikën e mirë ndërkombëtare në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale. Për t'i ndihmuar klientët dhe/ose projektet e tyre ta arrijnë këtë gjë, Banka ka përcaktuar kritere specifike të performancës për fushat e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale, si më poshtë:
- KP 1 – Vlerësimi dhe menaxhimi i çështjeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale
 - KP 2 – Kushtet e punës
 - KP 3 – Eficienca e burimeve, kontrolli dhe parandalimi i ndotjes
 - KP 4 – Siguria dhe shëndeti
 - KP 5 – Marrja e tokës, shpërngulja e detyruar dhe zhvendosja ekonomike
 - KP 6 – Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore
 - KP 7 – Popullsia indigjene
 - KP 8 – Trashëgimia kulturore
 - KP 9 – Ndërmjetësit financiarë
 - KP 10 – Dhënia e informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit

Projektet e investimeve të drejtpërdrejta duhet të përmbushin kriteret e performancës KP 1 deri në KP 8 dhe KP 10; Projektet NF duhet të përmbushin kriteret e performancës KP 2, KP 9 dhe kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë të KP 4. Secili KP përcakton, tek objektivat e tij, rezultatet e dëshiruara, pas të cilave vijnë kërkesat specifike për projektet, për t'i ndihmuar klientët t'i arrijnë këto objektiva. Përputhshmëria me legjislacionin kombërat përkatës është pjesë integrale e të gjitha kritereve të performancës.

37. Projektet që përfshijnë veprimtari tregtare ose objekte të reja duhet të planifikohen për t'i përmbushur kriteret e performancës që në fillim. Nëse një projekt përfshin veprimtari ose objekte ekzistuese që nuk i përmbushin kriteret e performancës në momentin e miratimit nga Këshilli i Administrimit, klientit do t'i kërkohet të zbatojë masa të kënaqshme për BERZH-in të cilat janë

teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive për të arritur përputhshmërinë e këtyre veprimtarive ose objekteve me kriteret e performancës brenda një afati kohor të pranueshëm për BERZH-in. Krahas kësaj, BERZH-i do të punojë me klientët për t'i menaxhuar rreziqet mjedisore dhe sociale në përputhje me kriteret e performancës në aktivitetet e tjera që e shoqërojnë projektin, por që nuk janë pjesë e tij.

38. Kur projekti përfshin financim të përgjithshëm të një shoqërie tregtare, financim të kapitalit qarkullues ose të kapitalit neto për një shoqëri tregtare, klientit duhet t'i kërkohej të hartojë masa në nivel shoqërie (dhe jo në nivel projekti) për t'i përmbushur kriteret e performancës brenda një periudhe kohore të arsyeshme. Kur mjetet monetare do të përdoren për një aktiv fizik të veçantë, përdorimi i mjeteve monetare do t'u nënshtrohet kriterëve të performancës. Në rastin e mjeteve monetare që nuk shkojnë drejtpërdrejt tek një aktiv fizik i veçantë, zbatohen kërkesat e pikës 32 më lart.

Performanca e palëve të treta

39. Ndonjëherë mundësia e projektit për t'i përmbushur kriteret e performancës varet nga veprimtaritë e të tretëve.¹² BERZH-i synon të sigurojë që projektet që financon të arrijnë rezultate në përputhje me kriteret e performancës edhe kur këto rezultate mbështeten tek performanca e të tretëve. Kur rreziku i palëve të treta është i lartë dhe klienti ushtron kontroll ose ndikim mbi veprimet dhe sjelljen e tyre, BERZH-i do t'i kërkojë klientit të bashkëpunojë me palën e tretë për të arritur rezultatet në përputhje me kriteret e performancës. Kërkesat dhe veprimet konkrete përcaktohen rast pas rasti. Disa rreziqe të caktuara të palëve të treta mund të bëjnë që Banka të vendosë të tërhiqet nga financimi i projektit.

Marrja e vendimeve

40. Dokumentacioni që i paraqitet Këshillit të Administrimit të BERZH-it ose një organi tjetër vendimmarrës të saj për miratimin e një projekti duhet të përfshijë një përshkrim të vlerësimit mjedisor dhe social, të ndikimeve dhe çështjeve me peshë, të masave zbutëse të identifikuar dhe një përmbledhje lidhur me angazhimin e palëve të interesuara dhe të mënyrës se si këto ndikime dhe çështje po marrin ose do të marrin zgjidhje nga klienti. Këshilli i Administrimit ose organi tjetër vendimmarrës, gjatë procesit të vendimmarrjes i merr në konsideratë komentet dhe shqetësimet e palëve të interesuara, në kuadër të vlerësimit të përfitimeve dhe rreziqeve të përgjithshme të projektit.
41. Këshilli i Administrimit i BERZH-it ka të drejtën të vendosë nëse do të bjerë dakord që, si kusht për financimin nga BERZH-i, disa elemente të caktuara të vlerësimit mjedisor dhe social të bëhen pas miratimit të Këshillit dhe pas nënshkrimit të kontratave të financimit. Këshilli merr në shqyrtim ndikimet, rreziqet dhe përfitimet në total të qasjes së propozuar. Kur projekti është miratuar në varësi të kushteve të tilla, Dokumenti Përmbledhës i Projektit përfshin një përshkrim të përqasjes.

Dokumentacioni ligjor

42. Kontratat e financimit që BERZH-i nënshkruan me klientët në lidhje me një projekt do të përfshijnë dispozita të veçanta që pasqyrojnë kërkesat mjedisore dhe sociale të BERZH-it. Këto përfshijnë përmbushjen e të gjitha kriterëve të zbatueshme të performancës, si dhe dispozitat për raportimin mjedisor dhe social, angazhimin e palëve të interesit dhe monitorimin. Dokumentet ligjore përfshijnë, sipas rastit, edhe të drejtat dhe/ose rrugëzgjdhjet ligjore për Bankën në rastin kur huamarrësi ose shoqëria në të cilën bëhet investimi nuk i zbaton dispozitat mjedisore ose sociale në përputhje me kërkesat e kontratës së financimit.

¹² Ndër të tjerë, një i tretë mund të jetë një agjenci shtetërore, një sipërmarrës kontrate, një furnitor me të cilin projekti/klienti ka marrëdhënie të konsiderueshme ose një përdorues i një objekti apo shërbimi përkatës.

Monitorimi

43. BERZH-i shqyrton ecurinë mjedisore dhe sociale të projekteve dhe përmbushjen e angazhimeve mjedisore dhe sociale për të cilat është rënë dakord në dokumentacionin ligjor. Shkalla e monitorimit duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me çështjet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale që shoqërojnë projektin, përfshi projektet me investim të drejtpërdrejtë dhe me ndërmjetës financiarë. Kërkesat e monitorimit dhe angazhimet përfshijnë, si minimum, shqyrtimin e raporteve vjetore mjedisore dhe sociale për projektet, të cilat i përgatisin klientët. BERZH-i mund të verifikojë periodikisht edhe informacionin monitorues të përgatitur nga klientët përmes vizitave në terren që bëjnë nëpër projekte specialistët mjedisorë dhe socialë të Bankës dhe/ose ekspertët e pavarur.
44. Nëse klienti nuk i përmbush angazhimet e tij sociale dhe mjedisore sikurse parashikohen në marrëveshje, BERZH-i mund të bjerë dakord me klientin që ky të marrë masa korigjuese për të arritur përmbushjen në fjalë. Nëse klienti nuk i përmbush masat korigjuese për të cilat është rënë dakord, Banka mund të marrë masa dhe/ose të përdorë rrugët ligjore të parashikuara në marrëveshjet financimit, si ta gjykojë të arsyeshme. BERZH-i, gjithashtu, shqyrton me klientin çdo mundësi për rritjen e performancës lidhur me projektet.

Ndryshimet operative

45. Pas miratimit nga BERZH-i dhe nënshkrimit të kontratave të financimit, mund të ndodhin ndryshime në natyrën dhe objektin e projektit. Këto ndryshime mund të shoqërohen me pasoja të konsiderueshme mjedisore ose sociale. Kur parashikohen ndryshime të tilla me rëndësi materiale, Banka bën një vlerësim paraprak mjedisor dhe social të ndryshimeve përkatëse, në përputhje me këtë Politikë dhe me çdo kërkesë tjetër për vlerësimin paraprak të projekteve dhe angazhimin e palëve të interesit dhe, në dokumentacionin e modifikuar/ristrukturuar të projektit përfshihen masa zbutëse mjedisore dhe sociale. Kur ndryshimet operative çojnë në një situatë mjedisore dhe/ose sociale e cila dallon materialisht nga situata e miratuar nga Këshilli i Administrimit, ndryshimi i raportohet nivelit të lartë drejtues dhe, sipas rastit, në përputhje me politikën e zbatueshme të BERZH-it, i paraqitet Këshillit për informim ose miratim.

D. Llogaridhënia dhe raportimi publik i BERZH-it

46. BERZH-i do të publikojë një raport vjetor për çështjet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale të lidhura me veprimtaritë e saj dhe për zbatimin e kësaj Politike.
47. Çështjet mjedisore dhe sociale që lidhen me projektet e financuara nga BERZH-i përmbledhen në Dokumentet Përmbledhëse të Projekteve të BERZH-it siç e kërkon Politika e Bankës për informimin e publikut.¹³
48. Departamenti i Vlerësimit i Bankës vlerëson dimensionet e ecurisë mjedisore dhe sociale të projekteve të financuara nga BERZH-i, sipas rastit, në përputhje me Politikën e Bankës për Vlerësimin dhe udhëzuesit përkatës.
49. BERZH-i ka krijuar Mekanizmin e Ankesave për Projektin (MAP) për të vlerësuar dhe shqyrtuar ankesat për projektet e financuara nga Banka. MAP u jep individëve, organizatave dhe grupeve vendore, të cilët mendojnë se shkaktohet dëm nga një projekt i Bankës, një mjet për paraqitjen e ankesave dhe marrjen e ndihmës për zgjidhjen e problemeve në mënyrë të pavarur nga veprimet bankare. Ky mekanizëm mund të përdoret nga individë ose grupe edhe për të depozituar një

¹³ Dokumentet Përmbledhëse të Projekteve duhet të vihen në dispozicion nga Zyra e Botimeve e BERZH-it dhe në hapësirën në internet të BERZH-it (www.ebrd.com).

ankesë nëse ata mendojnë se Banka nuk i ka përmbushur kërkesat e kësaj Politike apo elemente të veçantë të projektit për informimin publik.

E. Promovimi i investimeve me përfitime të larta mjedisore dhe sociale, përfshirë bashkëpunimin me të tjerët

50. BERZH-i do të promovojë projektet dhe nismat që planifikohen në mënyrë të veçantë për të realizuar përfitime të ndjeshme mjedisore dhe sociale. Kjo qasje përfshin:
- realizimin e bashkëpunimit teknik në plotësim të projekteve ekzistuese ose të propozuara të BERZH-it
 - përmirësimin e mjedisit të favorshëm, përmes bashkëpunimit teknik dhe dialogut për politikën, në mënyrë që klientët e BERZH-it t'i trajtojnë më mirë çështjet mjedisore ose sociale
 - nxitjen e projekteve të veçanta të investimeve në fushat me prioritet
 - nxitjen e eficiencës së burimeve në projekte
 - financimin e projekteve pilot për të parë linjat e reja të veprimtarive tregtare me përfitime të ndjeshme mjedisore ose sociale.

F. Marrëveshjet institucionale dhe zbatuese

51. Për të siguruar që vendimet strategjike të përshkruara më lart janë adresuar në mënyrën e duhur, BERZH-i duhet të caktojë përgjegjësitë dhe burimet e duhura për zbatimin efektiv të kësaj Politike. Banka do të ruajë burimet e duhura njerëzore për të mbikëqyrur proceset e vlerësimit dhe të monitorimit mjedisor dhe social dhe për të nisur dhe zhvilluar projekte me përfitim mjedisor dhe social.
52. Kjo Politikë hyn në fuqi gjashtë muaj pas miratimit nga Këshilli i Administrimit. Projektet që kanë marrë miratimin fillestar nga nivelet drejtuese të Bankës¹⁴ përpara hyrjes në fuqi të kësaj Politike janë objekt i Politikës që ka qenë në fuqi në momentin e miratimit fillestar të projektit.
53. BERZH-i do të përgatitë dhe do të ndjekë procedurat mjedisore dhe sociale dhe udhëzuesit e mjetet e duhura për të ndihmuar në zbatimin e kësaj Politike dhe do të sigurojë që personeli të marrë trajnimin e duhur për kërkesat e kësaj Politike.
54. BERZH-i do të vazhdojë të mbështetet nga Këshilli Konsultativ Mjedisor dhe Social (KKMS), mendimet e të cilit do të merren për çështje të përgjithshme të lidhura me politikën dhe për politikën dhe strategjitë sektoriale përpara finalizimit të tyre. Mendimet e këtij Këshilli do të merren edhe për çështje konkrete të lidhura me projektet dhe veprimtaritë e BERZH-it.
55. BERZH-i do të monitorojë dhe do të vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme ecurinë mjedisore dhe sociale të projekteve që financon kundrejt qëllimeve të kësaj Politike. Kjo Politikë do të shqyrtohet në mënyrë të vazhdueshme dhe mund të ndryshohet ose të përditësohet, në varësi të miratimit nga Këshilli i Administrimit. Krahas kësaj, kjo Politikë do të jetë objekt shqyrtimi nga Këshilli i Administrimit çdo pesë vjet.

¹⁴ Në kohën kur është miratuar kjo Politikë, ky miratim fillestar quhet "Shqyrtimi i konceptit".

Shtojca 1: Lista përjashtuese e Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it

BERZH-i, me dijeni të saj, nuk do të financojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, projekte që përfshijnë sa më poshtë:

- prodhimin ose tregtimin e produkteve apo veprimtarive të konsideruara të paligjshme sipas ligjeve apo rregulloreve (kombëtare) të vendit pritës, ose sipas konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ose që janë objekt i nxjerrjes jashtë përdorimit apo bllokimit ndërkombëtar, siç janë:
 - prodhimi ose tregtimi i produkteve që përmbajnë bifenole të poliklorinuara (PCB)¹⁵
 - prodhimi ose tregtimi i produkteve farmaceutike, pesticideve/herbicideve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme që janë objekt i nxjerrjes jashtë përdorimit ose bllokimit ndërkombëtar¹⁶
 - prodhimi ose tregtimi i lëndëve ozon-holluese që janë nxjerrë jashtë përdorimit në nivel ndërkombëtar¹⁷
 - tregtimi i jetës së egër natyrore ose prodhimi apo tregtimi i produkteve të llojeve të egra objekt i CITES¹⁸
 - lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të ndaluara sipas të drejtës ndërkombëtare¹⁹
- prodhimin, përdorimin ose tregtimin e fibrave të palidhura të azbestit ose të produkteve që përmbajnë azbest
- veprimtaritë e ndaluara nga legjislacioni i vendit pritës ose nga konventat ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e burimeve të biodiversitetit ose të trashëgimisë kulturore²⁰
- peshkimin me rrjeta lundruese në det duke përdorur rrjeta me gjatësi më të madhe se 2,5 km
- transportimin e naftës ose të lëndëve të tjera të rrezikshme me anije çisternë që nuk i përmbushin kërkesat e Organizatës Ndërkombëtare për Lundrimin Detar (IMO)²¹

¹⁵ PCB: bifenole të poliklorinuara janë një grup lëndësh kimike shumë toksike. PCB-të mund të gjenden në kondensatorët, kabinat dhe transformatorët elektrikë të mbushur me vaj që i përkasin periudhës 1950-1985.

¹⁶ Dokumentet bazë janë Rregullorja e Këshillit (KEE) nr.2455/92, datë 23 korrik 1992, Për Eksportin dhe Importin e disa Lëndëve Kimike të Rrezikshme, me amendime të herëpashershme; Lista e Konsoliduar e Kombeve të Bashkuara për produktet, konsumi dhe/ose shitja e të cilave është e ndaluar, e eliminuar, rreptësisht e kufizuar ose e pa aprovuar nga qeveritë; Konventa Mbi Procedurën e Njoftimit të Pëlqimit Paraprak për disa Kimikate të Rrezikshme dhe Pesticide në Tregtinë Ndërkombëtare (Konventa e Roterdamit); Konventa e Stokholmit për ndotësit organikë të qëndrueshëm; Klasifikimi i pesticideve sipas rrezikut rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

¹⁷ Lëndët ozon-holluese (ODS): përbërës kimikë që reagojnë me ozonin në stratosferë dhe e zërthejnë atë, duke shkaktuar atë që publikisht njihet si “vrirja e ozonit”. Në Protokollin e Montrealit për lëndët që hollojnë shtresën e ozonit jepet lista e ODS-ve dhe afati për pakësimin dhe eliminimin gradual të tyre. Lista e përbërësve kimikë që rregullohen nga Protokollin e Montrealit, ku përfshihen aerosolët, lëndët ftohëse, lëndët shkumë-formuese, solventët dhe lëndët kundër zjarrit, së bashku me të dhënat për vendet nënshkruese dhe afatet për heqjen graduale të tyre, gjendet pranë Programit për Mjedisin të Kombeve të Bashkuara (UNEP).

¹⁸ CITES: Konventa për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër. Lista e llojeve që mbulon CITES gjendet pranë sekretariatit të CITES.

¹⁹ Dokumentet bazë janë: Rregullorja (KE) nr.1013/2006, datë 14 qershor 2006, për transportimin e mbetjeve; Vendimi C(2001)107/Final i Këshillit të OECD-së për rishikimin e Vendimit C(92)39/Final për kontrollin mbi lëvizjet ndërkufitare të destinuara për rikuperim energjie; Konventa e Bazelit për kontrollin mbi lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre.

²⁰ Në konventat ndërkombëtare përkatëse përfshihen: Konventa për mbrojtjen e llojeve shtegtuese të kafshëve të egra (Konventa e Bonit); Konventa për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë (Konventa e Ramsarit); Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës (Konventa e Bernës); Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore; Konventa për biodiversitetin biologjik.

²¹ Këtu përfshihen: anijet cisternë që nuk i kanë të gjitha certifikatat e nevojshme sipas Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjeve nga Anijet (MARPOL), Konventës Ndërkombëtare për sigurinë e Jetës në Det (SOLAS), (përfshi, ndër të tjera, përputhshmërinë me Kodin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Sigurisë), anijet cisternë të futura në listën e zezë nga Bashkimi Evropian ose të ndaluara me Aktmarrëveshjen e Parisit për Kontrollin Shtetëror mbi Portet dhe anijet cisternë të destinuara për heqje graduale nga puna sipas rregullores 13G të MARPOL-it. Nuk duhet të përdoret asnjë anije cisternë me skaf tek, me vjetërsi më shumë se 25 vjet.

- tregtimin e mallrave pa lejet e nevojshme të eksportit ose të importit apo dëshmi të tjera që lejojnë kalimin nga vendet përkatëse të eksportit, importit dhe, nëse ka, të tranzitit.

Shtojca 2: Projektet e kategorisë A

Kjo listë zbatohet për projektet në formë investimi të ri dhe projektet në formë zgjerimi madhor ose transformim-konvertimi në kategoritë e renditura më poshtë. Llojet orientuese të projekteve të renditura më poshtë janë shembuj të projekteve që mund të sillnin ndikime të padëshirueshme e të konsiderueshme mjedisore dhe/ose sociale në të ardhmen dhe që, për rrjedhojë, kërkojnë një vlerësim të ndikimit mjedisor dhe social. Kategorizimi i secilit projekt varet nga natyra dhe rëndësia e çdo ndikimi aktual ose të mundshëm të padëshirueshëm mjedisor ose social në të ardhmen, sikurse përcaktohet nga veçantitë e natyrës, vendndodhjes, ndjeshmërisë dhe shkallës së projektit.

1. Rafineritë e naftës bruto (me përjashtim të ndërmarrjeve që prodhojnë vetëm lubrifikantë nga nafta bruto) dhe impiantet për gazifikimin dhe lëngëzimin e 500 tonëve ose më shumë shisti qymyror ose bituminoz në ditë.
2. Termocentralet ose impiantet e tjera me djegie të brendshme me fuqi nxehtësie në dalje prej 300 megavat²² ose më shumë dhe centralet bërthamore e reaktorët e tjerë bërthamorë, përfshi çmontimin ose nxjerrjen nga përdorimi të centraleve të tilla (me përjashtim të impianteve kërkimore për prodhimin dhe konvertimin e lëndëve të zërthueshme dhe fertile, fuqia maksimale e të cilëve nuk është më e madhe se 1 kilovat ngarkesë termale e vazhdueshme).
3. Impiantet e projektuara për prodhimin ose pasurimin e lëndëve djegëse bërthamore, ripërpunimin, magazinimin ose largimin përfundimtar të lëndëve djegëse bërthamore radioaktive ose për magazinimin, largimin ose përpunimin e mbetjeve radioaktive.
4. Uzinat e integruara për shkrirjen fillestare të gëzës dhe të çelikut; impiantet për prodhimin e metaleve bruto me ngjyra nga xeherorët, koncentratet apo lëndët e para dytësore me anë të proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike.
5. Impiantet e integruara kimike: impiantet për prodhimin në shkallë industriale të substancave duke përdorur proceset e konvertimit kimik, në të cilat disa agregate janë të instaluar ngjitur me njëri-tjetrin, janë të lidhur funksionalisht me njëri-tjetrin dhe që përdoren për prodhimin e: lëndëve kimike organike bazë; lëndëve kimike inorganike bazë; plehëruesve (të thjeshtë ose të përbërë) me bazë fosfori, azoti ose potasi; produkteve bazë për shëndetin e bimëve dhe biocideve; produkteve farmaceutike bazë duke përdorur proces kimik ose biologjik; lëndëve plasëse.
6. Ndërtimi i rrugëve kombëtare, autostradave dhe linjave të trafikut hekurudhor për distanca të gjata; i aeroporteve me gjatësi bazë piste prej të paktën 2.100 metra; i rrugëve të reja me katër ose më shumë korsi ose ndryshimi i gjurmës dhe/ose zgjerimi i rrugëve ekzistuese që të kenë katër ose më shumë korsi, kur këto rrugë të reja ose segmente rrugore me gjurmë të re dhe/ose të zgjeruara kanë gjatësi të vazhdueshme prej 10 km ose më shumë.
7. Tubacionet sjellëse, terminalet dhe objektet e lidhura me to për transportimin në shkallë të madhe të gazit, naftës dhe lëndëve kimike.
8. Portet e mëdha detare si dhe kanalet e brendshme tëlundrueshme dhe portet për trafikun e brendshëm ujor; portet tregtare, kalatat për ngarkim-shkarkimin të lidhura me tokën dhe portet e jashtme (me përjashtim të kalatave për tragetet).
9. Impiantet për përpunimin dhe depozitimin e mbetjeve për djegie, trajtimin kimik ose groposjen e mbetjeve të rrezikshme ose toksike.
10. Impiantet e depozitimit në shkallë të gjerë të mbetjeve për djegie ose trajtimin kimik të mbetjeve jo të rrezikshme.

²² Ekuivalent i një produkti bruto të energjisë elektrike prej 140 MW për centralet me turbina me avull me cikël të thjeshtë që punojnë me gaz.

11. Digat e mëdha²³ dhe prita të tjera të projektuara për të penguar ose mbajtur në mënyrë të përhershme ujë.
12. Veprimtaritë e nxjerrjes së ujërave nëntokësore ose sistemet e rimbushjes artificiale të ujërave nëntokësore në rastet kur vëllimi vjetor i ujit që nxirret ose rimbushet arrin 10 milion metra kub ose më shumë.
13. Fabrikat industriale për: 1. prodhimin e brumit të letrës nga lënda drusore ose lëndë të ngjashme fibroze; ose ii. prodhimin e letrës dhe kartonit me kapacitet prodhues që i kalon 200 ton në gjendje të thatë në ditë.
14. Nxjerrja e torfës, shfrytëzimi i guroreve dhe nxjerrja e mineraleve në shkallë të gjerë dhe përpunimi i xeherorëve të metaleve ose i qymyrgurit.
15. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare.
16. Impiantet për magazinimin e produkteve të naftës, produkteve petrokimike ose kimike me kapacitet 200.000 ton ose më shumë.
17. Prerja e pemëve në shkallë të gjerë ose shpyllëzimi i sipërfaqeve të mëdha.
18. Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza bashkiake me kapacitet më të madh se ekuivalenti 150.000 banorë.
19. Impiantet e depozitimit dhe të përpunimit në shkallë të gjerë të mbetjeve të ngurta bashkiake.
20. Ndërtimet turistike dhe tregtare në shkallë të gjerë.
21. Ndërtimi i linjave ajrore të tensionit të lartë.
22. Impiantet për prodhimin në shkallë të gjerë të energjisë elektrike nga era.
23. Aktivitetet në shkallë të gjerë për rikuperimin e tokës dhe të gjërryerjes së fundit të detit.
24. Bujqësia ose pyllëzimi në shkallë të gjerë, që kërkon intensifikim, ndryshim të destinacionit të tokës ose konvertim të karakteristikave parësore të biodiversitetit dhe/ose të habitateve me rëndësi kritike.
25. Fabrikat për regjen e lëkurëve, me kapacitet trajtimi më të madh se 12 ton produkt i gatshëm në ditë.
26. Impiantet për mbarështimin intensiv të shpezëve ose derrave me më shumë se: i. 85.000 vende për zogj pule dhe 60.000 vende për pula; ii. 3.000 vende për derra (mbi 30 kg); ose iii. 900 vende për dosa.
27. Projektet²⁴ që planifikohen për t'u realizuar ose që kanë gjasa të kenë një ndikim të perceptueshëm në vendet me ndjeshmëri publike të një rëndësie ndërkombëtare, kombëtare ose rajonale, edhe sikur kategoria e projektit të mos jetë e përfshirë në këtë listë. Vende të tilla me ndjeshmëri, ndër të tjera, përfshijnë zonat e mbrojtura natyrore të përcaktuara si të tilla me ligj kombëtar ose ndërkombëtar, habitatet me rëndësi kritike ose ekosistemet e tjera që mbështetin karakteristikat parësore të biodiversitetit, zonat me rëndësi arkeologjike ose kulturore dhe zonat me rëndësi për popujt indigjenë ose grupet e tjera në pozita të pambrojtura.
28. Projektet që mund të çojnë në ndikime të konsiderueshme sociale të padëshirueshme për komunitetet lokale ose për palët e tjera të prekura nga projekti.
29. Projektet që mund të kërkojnë shpërngulje të detyrueshme të konsiderueshme ose zhvendosje ekonomike të konsiderueshme.

²³ Komisioni Ndërkombëtar për Digat e Mëdha (ICOLD) e përkufizon digën e madhe si një digë me lartësi 15 metra nga themeli ose më shumë. Edhe digat me lartësi nga 5 deri në 15 metra dhe me vëllim rezervuari më shumë se 3 milion metra kub klasifikohen si diga të mëdha.

²⁴ Përfshirë, ndër të tjera, projektet me orientim mjedisor ose social (siç janë burimet e rinovueshme të energjisë).

Kriteri i Performancës nr. 1 i BERZH-it:

Vlerësimi dhe menaxhimi i çështjeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale

Hyrje

1. Në këtë kriter performance (KP) i jepet rëndësi vlerësimit të integruar për të identifikuar çështjet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale¹ që shoqërojnë projektet, si dhe menaxhimin që i bën klienti ecurisë mjedisore dhe sociale gjatë gjithë jetës së projektit. Një Sistem Menaxhimi Mjedisor dhe Social (SMMS) i suksesshëm dhe eficient është një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, që e merr nismën dhe mbështetet nga nivelet drejtuese e që kërkon komunikim kuptimplotë midis klientëve, punonjësve dhe komuniteteve lokale të prekura nga projekti dhe/ose veprimtari të tjera të klientit dhe, sipas rastit, edhe palët e tjera të interesit. Kjo kërkon një qasje me sisteme metodike që përfshin planifikimin, zbatimin, shqyrtimin dhe reagimin ndaj rezultateve në mënyrë të strukturuar, me qëllim arritjen e një përmirësimi të vazhdueshëm në menaxhimin e performancës. Një SMMS i përshtatshëm me natyrën dhe shkallën e projektit nxit një ecuri mjedisore dhe sociale të shëndoshë dhe të qëndrueshme dhe mund të sjellë rritje të rezultateve financiare, mjedisore dhe sociale.
2. Në këtë kriter të performancës përvijohen përgjegjësitë e klientit në procesin e vlerësimit të ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale dhe të hartimit e zbatimit të procedurave për menaxhimin dhe monitorimin e këtyre çështjeve dhe ndikimeve . Angazhimi me palët e interesuara të projektit është pjesë tërësore e këtij procesi. KP 10, që parashton kërkesat lidhur me angazhimin e palëve të interesit, duhet lexuar bashkë me këtë kriter performance.

Objektivat

3. Objektivat e këtij kriteri performance janë:
 - identifikimi dhe vlerësimi i çështjeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale që shoqërojnë projektin
 - përdorimi i një qasjeje me shkallë zbutëse² për t'u dhënë zgjidhje çështjeve dhe ndikimeve të padëshirueshme mjedisore ose sociale për punonjësit, komunitetet e prekura dhe mjedisin si rezultat i veprimtarive të projektit
 - promovimi i ecurisë së përmirësuar mjedisore dhe sociale të klientëve përmes përdorimit të efektshëm të sistemeve administrative
 - hartimi i një SMMS-je të përshtatur sipas natyrës së projektit, për vlerësimin dhe menaxhimin e çështjeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale në përputhje me kriteret përkatëse të performancës.

Fusha e zbatimit

4. Ky kriter performance zbatohet për të gjitha projektet që financohen drejtpërdrejt nga BERZH-i. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të këtij kriteri performance dhe mënyrën si do të trajtohen dhe menaxhohen ato përmes planifikimit të projektit, ndërtimit, aktiviteteve, nxjerrjes nga puna ose mbylljes.
5. Në kuptim të kriterëve të performancës, termi “projekt” përdoret për tërësinë e përcaktuar të veprimtarive tregtare për të cilat një klient kërkon financim nga BERZH-i ose për të cilat është

¹ Në kuptim të kësaj Politike, me ndikime sociale nënkuptohen ndikimet tek individët, komuniteti dhe punonjësit, të cilat lindin nga veprimtaria tregtare që do të mbështetet dhe mënyra me të cilën mund të preken kushtet e tyre të punës, statusi shoqëror-ekonomik, identiteti kulturor, të drejtat e njeriut dhe/ose shëndeti i tyre.

² Shkalla zbutëse përfshin masat e marra për të shmangur krijimin e ndikimeve mjedisore ose sociale që në fillim të veprimtarive të zhvillimit, dhe kur kjo nuk është e mundur, për të zbatuar masa të tjera shtesë që do ta minimizonin, zbusnin dhe, si zgjidhje të fundit, kompensojnë çdo ndikim të padëshirueshëm të mbetur.

siguruar që më parë financim nga BERZH-i, ku tërësia e veprimtarive të punës është e përcaktuar në marrëveshjet e financimit dhe është miratuar nga Këshilli i Administrimit ose nga një organ tjetër vendimmarrës.

6. Projektet që përfshijnë veprimtari tregtare ose objekte të reja duhet të planifikohen për t'i përmbushur kriteret e performancës që në fillim. Nëse projekti ka të bëjë me objekte ekzistuese ose kur projekti nuk i përmbush kriteret e performancës që në fillim, klientit i kërkohet të hartojë dhe të zbatojë një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social (PVMS),³ i cili të përfshijë një varg masash të nevojshme për të arritur përputhshmërinë e këtyre objekteve me kriteret e performancës brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Kërkesat

Vlerësimi mjedisor dhe social

7. Procesi i vlerësimit mjedisor dhe social duhet të mbështetet në informacionet më të fundit, përfshi një përshkrim dhe përvijim të saktë të projektit dhe të veprimtarive përkatëse të klientit, si dhe në të dhënat bazë të situatës sociale dhe mjedisore në një nivel të përshtatshëm detajesh. Procesi i vlerësimit duhet të identifikojë edhe: i. aktet e zbatueshme ligjore dhe nënligjore mjedisore dhe sociale të territorit ku ushtron aktivitet projekti, përfshi edhe ato akte ligjore ku zbatohen detyrimet e vendit pritës të cilat rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare; dhe ii. kërkesat e zbatueshme të kriterëve të performancës. Thelbësore për këtë qasje është përdorimi i shkallës së zbutjes së ndikimeve dhe i praktikave të mira ndërkombëtare.⁴ Për projekte që mund të kenë ndikime të padëshirueshme mjedisore dhe sociale, klienti duhet të identifikojë, si pjesë tërësore të procesit të vlerësimit, palët e interesuara të projektit dhe të hartojë një plan për angazhimin e palëve të interesit në mënyrë të plotë për të marrë në konsideratë vendimet dhe shqetësimet e tyre gjatë planifikimit, zbatimit dhe funksionimit të projektit në përputhje me KP 10.
8. Procesi i vlerësimit duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me çështjet dhe ndikimet e mundshme të projektit dhe duhet të mbulojë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha çështjet dhe ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore dhe sociale të projektit dhe fazat përkatëse të ciklit të projektit (për shembull, parandërtimi, ndërtimi, shfrytëzimi dhe nxjerrja nga puna ose mbyllja dhe rikthimi në punë). Mund të duhet që klienti ta plotësojë vlerësimin e tij mjedisor dhe social me studime të mëtejshme që përqendrohen tek rreziqet dhe ndikimet specifike, siç është ndryshimi i klimës, të drejtat e njeriut dhe çështjet gjinore.
9. Procesi i vlerësimit mjedisor dhe social duhet të identifikojë dhe të përshkruajë, sa duhet, çështjet e mundshme e të rëndësishme mjedisore dhe sociale që shoqërojnë veprimtaritë ose objektet që nuk janë pjesë e projektit, por që mund të ndikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga projekti, ekzistojnë vetëm për shkak të projektit ose mund të përbëjnë rrezik për projektin. Këto veprimtari ose objekte mund të jenë thelbësore për realizueshmërinë e projektit dhe/ose mund të jenë në kontroll të klientit ose mund të realizohen nga palë të treta apo u përkasin të tretëve. Kur klienti nuk mund t'i ketë nën kontroll apo nën ndikim këto veprimtari ose objekte, procesi i vlerësimit mjedisor dhe social duhet të identifikojë rreziqet përkatëse për projektin. Kur identifikohen rreziqet mjedisore dhe/ose sociale mundësisht të padëshirueshme, që janë të lidhura me veprimtari ose objekte të të tretëve, klienti duhet të bashkëpunojë me palët e treta për t'i menaxhuar dhe zbutur këto rreziqe. Po kështu, kur ka mundësi për t'i rritur përfitimet, klienti duhet të ushtrojë pushtetin dhe ndikimin mbi palët e treta. Po kështu, procesi i vlerësimit duhet të marrë në konsideratë ndikimet e projektit të ndërthurura me ndikimet e zhvillimeve të tjera të

³ PVMS-ja përbën pjesë të pandarë të kontratave të financimit.

⁴ Praktikë e mirë ndërkombëtare është ushtrimi i zotësisë profesionale, korrektesës, maturisë dhe vizionit afatgjatë që do të pritej në mënyrë të arsyeshme nga profesionistët e zotë e me përvojë, të angazhuar në të njëjtën lloj ndërmarrjeje, në kushte të njëjta ose të ngjashme, në shkallë botërore ose rajonale. Rezultati i një ushtrimi të tillë duhet të jetë që projekti të përdorë teknologjitë më të përshtatshme në rrethanat specifike të projektit.

shkuara, aktuale dhe të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme, si dhe të veprimtarive të paplanifikuara por të parashikueshme, të mundshme nga projekti dhe që mund të ndodhin më vonë ose në një vend tjetër.

10. Projektet e kategorisë A⁵ mund të sjellin ndikime të padëshirueshme mjedisore dhe/ose sociale të konsiderueshme në të ardhmen, të cilat nuk mund të identifikohen ose të analizohen lehtësisht dhe kërkojnë që klienti të kryejë vlerësim të ndikimit mjedisor dhe social (VNMS). Procesi i VNMS-së duhet të përfshijë një fazë të përcaktimit të qëllimit për të identifikuar ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të ardhshme⁶ që shoqërojnë projektin. VNMS duhet të përfshijë një shqyrtim të alternativave teknikisht dhe financiarisht të realizueshme në burim për këto ndikime, përfshi edhe alternativën sikur të mos kishte projekt, dhe për të dokumentuar arsyetimin e përzgjedhjes së drejtimit të aktivitetit të propozuar. Ky vlerësim duhet të identifikojë edhe shanset e mundshme për përmirësim dhe të rekomandojë masat e nevojshme për të shmangur dhe, kur nuk mund të shmangen, për të minimizuar dhe zbutur ndikimet e padëshirueshme. VNMS mund të duhet të realizohet ose të verifikohet nga ekspertë të pavarur. Procesi i VNMS-së duhet të përfshijë edhe një proces informimi dhe konsultimi me publikun sikurse përcaktohet në KP 10.
11. Për projektet e kategorisë B, ku ndikimet e padëshirueshme mjedisore dhe/ose sociale në të ardhmen zakonisht janë specifike për zonë¹ dhe/ose identifikohen dhe trajtohen pa vështirësi përmes masave zbutëse, klienti duhet të ndërmarrë një vlerësim mjedisor dhe social që të jetë në përpjesëtim me natyrën, madhësinë dhe vendndodhjen e projektit, si dhe me karakteristikat e rreziqeve dhe ndikimeve të mundshme. Vlerësimi duhet të përshkruajë ndikimet e padëshirueshme që mund të shoqërojnë në të ardhmen projektin, të identifikojë shanset e mundshme për përmirësim dhe të rekomandojë masat e nevojshme për të shmangur dhe, kur nuk mund të shmangen, për të minimizuar dhe zbutur ndikimet e padëshirueshme.
12. Për projektet e kategorisë A dhe B, të cilët përfshijnë objekte ekzistuese, duhet bërë një vlerësim i çështjeve mjedisore dhe sociale të aktiviteteve të shkuara dhe të tashme. Qëllimi i këtij vlerësimi është identifikim i rreziqeve, detyrimeve dhe shanseve të mundshme që shoqërojnë objektet dhe aktivitetet ekzistuese, konfirmimi i statusit aktual të përmbushjes së kërkesave rregullatore dhe vlerësimi i sistemeve administruese ekzistuese të klientit dhe i ecurisë së përgjithshme të tij kundrejt kriterëve të performancës. Çdo hetim i objekteve ekzistuese duhet të bëhet nga ekspertë që janë të pavarur nga objekti që po hetohet.
13. Për projektet e kategorisë C, të cilët ka të ngjarë të kenë shumë pak ose aspak ndikime të padëshirueshme mjedisore dhe/ose sociale në të ardhmen dhe të cilët mund të identifikohen dhe të trajtohen pa vështirësi përmes masave zbutëse, klienti duhet të zbatojë një VNMS në përpjesëtim me ndikimet dhe rreziqet sipas pikave 14-22 të këtij kriteri performace dhe të monitorojë e të raportojë për përmbushjen e kriterëve të performancës sipas pikave 23-28 të KP 1.
14. Në rastet kur klientët me aktivitete në disa zona kërkojnë financim të përgjithshëm të shoqërisë tregtare, financim të kapitalit qarkullues ose të kapitalit neto, vlerësimi i parashikuar nga pika 7 deri te 12 nuk mund të jetë i përshtatshëm. Në këto raste, VNMS-ja aktuale e klientit dhe performanca e shkruar dhe ajo aktuale e tij vlerësohen kundrejt kriterëve përkatëse të performancës dhe përgatitet e zbatohet një VNMS në nivel shoqërie (dhe jo në nivel zone).

Vlerësimi në nivel shoqërie duhet:

- të vlerësojë aftësinë e klientit për të menaxhuar dhe trajtuar të gjitha çështjet dhe ndikimet përkatëse sociale dhe mjedisore që shoqërojnë aktivitetin dhe objektet e tij, kundrejt kërkesave të përshkruara në kriteret e performancës

⁵ Një listë orientuese për projektet e kategorisë A jepet në Shtojcën 2 të Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it.

⁶ Vlerësimi i ndikimeve mjedisore dhe sociale duhet të shqyrtojë ndikimet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe progresive të lidhura me projektin, si edhe ndikimet e mundshme ndërkufitare, nëse ka.

- të vlerësojë të dhënat e përputhshmërisë së klientit me kërkesat e zbatueshme rregullatore mjedisore dhe sociale në juridiksionet ku ushtron aktivitet projekti
- të identifikojë palët kryesore të interesit të klientit dhe veprimtaritë aktuale të angazhimit të palëve të interesit.

Objekti i saktë i vlerësimit të shoqërisë tregtare përcaktohet rast pas rasti.

Sistemet e menaxhimit mjedisor dhe social

15. Klientëve u kërkohet të vendosin dhe të mbajnë një sistem menaxhimi mjedisor dhe social (SMMS) sipas natyrës dhe shkallës së projektit, në përpjesëtim të drejtë me nivelin e çështjeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale dhe në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare. Objektivi i një sistemi të tillë menaxhimi është integrimi i zbatimit të kërkesave mjedisore dhe sociale në një proces të thjeshtuar dhe të bashkërenduar dhe trupëzimi i tij në veprimtaritë kryesore operative të vlerësimit që u bën klienti çështjeve dhe ndikimeve.

Politika mjedisore dhe sociale

16. Klienti duhet të vendosë, sipas rastit, një politikë madhore ku të përcaktohen objektivat dhe parimet mjedisore dhe sociale të cilat mundësojnë që projekti të arrijë një ecuri të shëndoshë mjedisore dhe sociale. Politika duhet të sigurojë kuadrin për procesin e vlerësimit dhe të menaxhimit mjedisor dhe social në përputhje me parimet e kritereve të performancës.

Plani i menaxhimit mjedisor dhe social

17. Duke marrë në konsideratë konstatimet e procesit të vlerësimit mjedisor dhe social dhe rezultatet e angazhimit të palëve të interesit, klienti do të hartojë dhe të zbatojë një program veprimesh për të trajtuar çështjet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të identifikuara të projektit dhe masa të tjera të përmirësimit të performancës për të përmbushur kriteret e performancës. Në varësi të projektit, programi mund të konsistojë në një ndërthurje të politikave operative të dokumentuara, të sistemeve të menaxhimit, procedurave, planeve, praktikave dhe investimeve kapitale, bashkërisht të quajtura Plane të menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS).
18. PMMS-ja duhet të pasqyrojë hierarkinë zbutëse dhe, kur është e realizueshme teknikisht dhe financiarisht, të favorizojë shmangien dhe parandalimin e ndikimeve kundrejt minimizimit, zbutjes apo kompensimit, dhe të sigurojë që të gjitha fazat përkatëse të projektit të strukturohen në mënyrë të atillë që të përmbushin kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore dhe kriteret e performancës. Kur individët ose grupet e prekura identifikohen gjatë procesit të vlerësimit paraprak të projektit si individë ose grupe në pozita të pafavorshme ose më të ndjeshëm⁷, PMMS-ja duhet të përfshijë masa të diferencuara, në mënyrë që ndikimet e padëshirueshme të mos bien mbi ta në mënyrë jo proporcionale dhe ata të mund të marrin përparësi nga shanset për të përfituar nga projekti. Sipas rastit, PMMS-ja duhet të mbulojë edhe menaxhimin e çështjeve të të tretëve dhe të furnitorëve.
19. Niveli i hollësisë dhe i kompleksitetit të PMMS-së duhet të jetë në përpjesëtim me çështjet dhe ndikimet projektit, duke trajtuar rreziqet, ndikimet dhe shanset specifike për projektin. PMMS-ja duhet të përcaktojë rezultatet e dëshiruara si ngjarje të matshme, për aq sa është e mundshme, me elemente të tilla si plani dhe treguesit e ecurisë që mund të gjurmohen gjatë periudhës së

⁷ Në kuptim të kësaj Politike, grupet në pozita të pambrojtura janë ata persona të cilët, për shkak të identitetit gjinor, orientimit seksual, fesë, përkatësisë etnike, statusit si indigjenë, moshës, aftësive të kufizuara, pozitës së pafavorshme ekonomike apo statusit shoqëror mund preken më negativisht nga ndikimet e projektit në krahasim me të tjerët dhe të cilët mund ta kenë të kufizuar mundësinë për të kërkuar të drejtat e tyre apo për të marrë përfitimet e projektit. Individët dhe/ose grupet në pozita të pambrojtura mund të përfshijnë, ndër të tjerë, edhe personat që jetojnë nën kufirin e varfërisë, personat pa tokë, të moshuarit, familjet me kryefamiljare gra ose fëmijë, refugjatët, personat e shpërngulur brendapërbrenda vendit, pakicat kombëtare, komunitetet që varen nga burimet natyrore ose çdo person tjetër të zhvendosur që mund të mos mbrohet nga legjislacioni kombëtar dhe/ose e drejta ndërkombëtare.

përcaktuar. Duke pranuar natyrën dinamike të procesit të përgatitjes dhe të zbatimit të projektit, PMMS-të duhet t'iu përgjigjen ndryshimeve në rrethanat e projektit, ngjarjeve të paparashikuara, ndryshimeve rregullatore dhe rezultateve të monitorimit e shqyrtimit dhe të përditësohen herë pas here.

20. PMMS-ja, përfshi dhe çdo kërkesë e veprim specifik që parashtron, duhet të zbatohet për projektin pavarësisht nëse ky realizohet drejtpërdrejt nga klienti apo përmes sipërmarrësve a palëve të nënkontraktuara. Është përgjegjësi e klientit të sigurojë që sipërmarrësit që punojnë në zonat e projektit t'i përmbushin këto kërkesa duke miratuar dhe zbatuar një sistem të duhur të menaxhimit të sipërmarrësve. Menaxhimi i efektshëm i sipërmarrësve përfshin:
- vlerësimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale që shoqërojnë punimet dhe shërbimet e kontraktuara dhe përfshirjen e kushteve përkatëse për PMMS-në në dokumentet e tenderit, sipas rastit, duke kërkuar me kontratë që sipërmarrësi t'i zbatojë këto standarde dhe të parashikojë zbutjen e mospërputhshmërisë
 - mbikëqyrjen e faktit nëse sipërmarrësit i kanë njohuritë dhe aftësitë për t'i përmbushur detyrat e projektit në përputhje me kushtet e kontratës
 - monitorimin e përmbushjes së kushteve të kontratës nga sipërmarrësi
 - në rastin e nënkontratës, kërkesën që sipërmarrësi të bëjë të njëjtat rregullime me palët e nënkontraktuara.

Kërkesat e lidhura me krahun e punës dhe kushtet e punës të punonjësve jo me cilësinë e punëmarrësit parashtrihen në KP 2. Kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë të të gjithë punonjësve jepen në KP 4.

Kapaciteti dhe angazhimi institucional

21. Klienti duhet të krijojë, të mbajë dhe të fuqizojë, sipas nevojës, një strukturë organizative e cila përcakton rolet, përgjegjësitë dhe autoritetin për vënien në zbatim të SMMS-së, për të siguruar përmbushjen në vazhdimësi të kërkesave rregullatore përkatëse kombëtare dhe të kritereve të performancës. Klienti duhet të caktojë personelin specifik, përfshi përfaqësuesin ose përfaqësuesit e administrimit, me hierarki të qartë përgjegjësie dhe autoriteti për të mbajtur dhe zbatuar SMMS-në. Përgjegjësitë kryesore mjedisore dhe sociale duhet të përcaktohen dhe t'u komunikohen punonjësve përkatës. Klienti do të ofrojë mbështetjen e duhur dhe burimet njerëzore dhe financiare në mënyrë të vazhdueshme për të arritur një ecuri të efektshme dhe të vazhdueshme mjedisore dhe sociale.
22. Klienti duhet të sigurojë që punëmarrësit me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për veprimtaritë që lidhen me ecurinë mjedisore dhe sociale të projektit të jenë të kualifikuar dhe të trajnuar.

Menaxhimi i zinxhirit të furnitorëve

23. Klientit i kërkohet të identifikojë rreziqet që shoqërojnë zinxhirin e furnizimit. Kur klienti mund të ushtrojë në mënyrë të arsyeshme kontroll mbi furnitorët parësorë të tij, procesi i vlerësimit mjedisor dhe social duhet të marrë në konsideratë edhe nëse zinxhirët e furnizimit parësor, që janë thelbësorë për funksionet bazë operative të projektit, janë apo jo të lidhur me rreziqet mjedisore dhe sociale. Nëse është kështu, klienti duhet të miratojë dhe të zbatojë një sistem të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit në përpjesëtim me kompleksitetin e këtyre zinxhirëve të furnizimit dhe çështjeve përkatëse mjedisore dhe sociale, përshtatur sipas natyrës dhe shkallës së projektit. Sistemi i menaxhimit duhet të përfshijë proceset për të vepruar me qëllim adresimin e çështjeve mjedisore dhe sociale të identifikuar gjatë vlerësimit të zinxhirit të furnizimit apo gjatë monitorimit të vazhdueshëm, duke mbajtur në konsideratë: i. faktin nëse ka qenë apo jo klienti ai që i ka shkaktuar problemet apo ka ndikuar tek to; ii. fuqinë ndikuese që ka klienti tek furnitori; iii. sa thelbësore është për klientin marrëdhënia; iv. sa të rënda janë problemet; dhe v. nëse zgjidhja e marrëdhënies me furnitorin do të kishte apo jo në vetvete pasoja të

padëshirueshme. Kërkesat për standardet e punës në zinxhirin e furnizimit parashtrohen në KP 2; kërkesat për zinxhirin e furnizimit për burimet natyrore përcaktohen në KP 6.

Monitorimi dhe raportimi i projektit

24. Klienti duhet të monitorojë ecurinë mjedisore dhe sociale të projektit. Ky monitorim synon: i. konstatimin nëse projekti po zbatohet apo jo në përputhje me kriteret e performancës; dhe ii. nxjerrjen e mësimëve, shpërndarjen e burimeve dhe identifikimin e mundësive për përmirësim të vazhdueshëm.
25. Kërkesat e monitorimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën e projektit dhe me çështjet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të tij. Monitorimi duhet të trajtojë:
 - çdo çështje dhe ndikim të konsiderueshëm mjedisor dhe social të identifikuar gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social
 - pjesët përkatëse të kriterëve të performancës të identifikuar gjatë procesit të vlerësimit të projektit dhe gjatë monitorimit pasues, sipas rastit
 - veprimet e përcaktuara në PMMS-në ose PVMS-në, sipas rastit
 - ankesat që vijnë nga punonjësit dhe palët e jashtme të interesit dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre
 - çdo kërkesë rregullatore për monitorimin dhe raportimin
 - çdo monitorim/raportim të kërkuar nga palë të tjera (për shembull, blerësit e burimeve, financuesit apo organet certifikuese).
26. Klienti duhet të sigurojë që për kryerjen e monitorimit janë ngritur dhe funksionojnë sisteme, burime dhe personeli i duhur. Klienti duhet të shqyrtojë rezultatet e monitorimit dhe të fillojë veprimet korrigjuese, sipas nevojës. Krahas kësaj, klienti mund të përdorë palë të treta, siç janë ekspertët e pavarur, komunitetet lokale ose organizatat e shoqërisë civile, për ta plotësuar ose verifikuar informacionin e vet monitorues. Kur autoritetet përkatëse ose të tretët kanë përgjegjësi për menaxhimin e çështjeve dhe ndikimeve të veçanta dhe masave përkatëse zbutëse, klienti duhet të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse ose të tretë të tjerë për vendosjen dhe monitorimin e masave të tilla zbutëse.
27. Klienti duhet t'i paraqesë BERZH-it raporte të rregullta për ecurinë mjedisore dhe sociale të projektit, përfshi përmbushjen e kriterëve të performancës dhe zbatimin e SMMS-së, PMMS-së, PVMS-së dhe Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit, sipas rastit. Mbështetur në rezultatet e monitorimit, klienti duhet të identifikojë dhe të pasqyrojë çdo veprim korrigjues dhe parandalues të nevojshëm në një PMMS-ë ose PVMS-ë, me miratimin e BERZH-it. Klienti duhet të zbatojë veprimet e miratuara korrigjuese dhe parandaluese dhe t'i ndjekë në vazhdimësi këto veprime për ta rritur rezultatin e tyre.
28. Klienti duhet t'i njoftojë menjëherë BERZH-it çdo incident ose aksident mjedisor ose social që ka lidhje me klientin ose me projektin dhe që ka apo ka të ngjarë të ketë një ndikim të konsiderueshëm të padëshirueshëm.
29. Klienti duhet t'i njoftojë menjëherë BERZH-it çdo ndryshim të qëllimit të projektit, të hartimit apo të funksionimit të tij që ka të ngjarë t'i ndryshojë në mënyrë materiale çështjet dhe ndikimet e tij mjedisore ose sociale. Klienti duhet të bëjë çdo vlerësim tjetër shtesë dhe angazhimin e palëve të interesit në përputhje me kriteret e performancës dhe të ndryshojë PMMS-në ose PVMS-në në përputhje me konstatimet, me miratimin e BERZH-it.
30. Për projektet që mund të kishin çështje dhe ndikime të konsiderueshme të padëshirueshme mjedisore dhe sociale, klientit mund t'i kërkohet të angazhojë ekspertë të jashtëm për të kryer shqyrtime të pavarura periodike të projektit ose për të kryer monitorimin e çështjeve të veçanta mjedisore ose sociale. Objekti i kësaj pune dhe i veprimeve pasuese përcaktohet rast pas rasti.

Kriteri i Performancës nr. 2 i BERZH-it:

Kushtet e punës

Hyrje

1. Ky kriter performance pranon se për klientët dhe veprimtaritë tregtare të tyre, krahu i punës është një pasuri e çmuar dhe se menaxhimi i mirë i burimeve njerëzore dhe një marrëdhënie e mirë punonjës-drejtues, bazuar tek respekti për të drejtat e punonjësve, përfshi të drejtën e bashkimit në shoqata dhe të drejtën për negociata kolektive, janë përbërësit kyç të qëndrueshmërisë së veprimtarive tregtare. Duke i trajtuar punonjësit me drejtësi dhe duke u ofruar kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme,¹ klientët mund të krijojnë përfitime të prekshme, si rritja e rendimentit dhe e produktivitetit të aktiviteteve të tyre.

Objektivat

2. Objektivat e këtij kriteri performance janë:
 - respektimi dhe mbrojtja e parimeve dhe të drejtave themelore² të punonjësve
 - nxitja e një programi të pranueshëm pune,³ përfshi trajtimin me drejtësi, mosdiskriminimin dhe mundësi të barabarta të punonjësve
 - vendosja, ruajtja dhe përmirësimi i një marrëdhënieje të shëndoshë punonjës-drejtues
 - nxitja e përputhshmërisë me çdo marrëveshje kolektive palë e të cilave është klienti dhe me legjislacionin kombëtar të punësimit
 - mbrojtja dhe nxitja e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve, sidomos përmes nxitjes së kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës
 - parandalimi i përdorimit të punës së detyruar dhe punës së fëmijëve (sipas përkufizimit të ILO-s) në lidhje me veprimtaritë e projektit.

Fusha e zbatimit

3. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të këtij kriteri performance dhe mënyrën si do të trajtohen dhe të menaxhohen ato përmes ciklit të jetës së projektit. Zbatimi i veprimeve të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri performance duhet të menaxhohet në kuadër të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) dhe të Planeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) sipas projekteve. Kërkesat e vlerësimit dhe të menaxhimit mjedisor dhe social jepen në KP 1.
4. Në këtë kriter performance, termi “punonjës” përdoret për punëmarrësit e klientit, përfshi personelin me orar të kufizuar dhe punonjësit e përkohshëm, sezonalë dhe migrues. Zbatueshmëria e kriterit të performancës për punonjësit jo-punëmarrës parashtrohet në pikat 21-23. Çështjet e krahut të punës të lidhura me zinxhirin e furnizimit trajtohen në pikat 24-26.

¹ Kërkesat për shëndetin dhe sigurinë në punë mbulohen në kuadër të kriteri KP 4.

² Konventat e ILO-s 29 dhe 105 (puna e detyruar), 87 (liria e organizimit në shoqata), 98 (e drejta për negociata kolektive), 100 dhe 111 (diskriminimi), 138 (mosha minimale) 182 (format më të këqija të punës së fëmijëve).

³Puna e pranueshme përmbledh aspiratat e njerëzve gjatë viteve të punës. Ajo përfshin mundësi për të bërë punë produktive dhe që realizon të ardhura të drejta, ofron siguri në qendrën e punës dhe mbrojtje sociale për familjet, perspektivë më të mirë për zhvillim vetjak dhe integritim social, liri që njerëzit të shprehin shqetësimet e tyre, të organizohen dhe të marrin pjesë në vendimet që u prekin jetën dhe barazi në mundësi dhe trajtim për të gjithë gratë dhe burrat.

Kërkesat

Të përgjithshme

5. Projekteve u kërkohet të përmbushin, minimalisht, i. legjislacionin kombëtar të punës, të sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit e sigurisë në punë dhe ii. parimet dhe standardet themelore të mishëruara në konventat e ILO-s.⁴

Menaxhimi i marrëdhënieve me punonjësit

Politikat e burimeve njerëzore

6. Klienti duhet të miratojë dhe/ose të mbajë politika dhe sisteme ose procedura menaxhimi të burimeve njerëzore në përputhje me madhësinë dhe numrin e punonjësve të tij, ku të parashtrohet qasja e ndjekur për menaxhimin e krahut të punës në përputhje me kërkesat e këtij kriteri performance dhe me legjislacionin kombëtar. Këto politika dhe procedura duhet të jenë të kuptueshme dhe të arritshme për punonjësit dhe në gjuhën ose gjuhët kryesore që flasin punonjësit.

Marrëdhëniet e punës

7. Klienti duhet të dokumentojë dhe t'u komunikojë të gjithë punonjësve të drejtat që ju jep legjislacioni kombëtar i punës dhe çdo kontratë e zbatueshme kolektive, kushtet e punës dhe marrëdhëniet e punës, përfshi pagën, orarin e punës, rregullimet dhe kompensimin për punën jashtë orarit, çdo përfitim (si leja shëndetësore, leja e barrë-lindjes ose leja vjetore) dhe kur ndodh çdo ndryshim me rëndësi materiale. Këto informacione duhet të jenë të kuptueshme dhe të arritshme për punonjësit dhe në gjuhën ose gjuhët kryesore që flasin punonjësit. Sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të respektojnë të drejtën e punonjësve për jetë private dhe për mbrojtjen e të dhënave.
8. Komunikimi duhet menaxhuar me qëllim që t'u jepet punonjësve: i. Informacioni i duhur, në veçanti për ndryshimet e pritura që mund të prekin fuqinë punëtore dhe ii. mundësia për të bërë komente në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, përfshi mënyrën e bërjes së ankesave, sikurse përshkruhet në pikën 20.

Puna e fëmijëve

9. Klienti duhet të përmbushë të gjitha aktet ligjore përkatëse kombëtare ose standardet ndërkombëtare të punës në lidhje me punësimin e të miturve, në varësi të faktit se cili prej këtyre ofron shkallën më të lartë të mbrojtjes për fëmijët, në lidhje me punësimin e të miturve.
10. Klienti nuk duhet të punësojë fëmijë për qëllime shfrytëzimi ekonomik apo që të jetë e rrezikshme ose të çënojë arsimimin e fëmijës ose të jetë e dëmshme për shëndetin apo zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror të fëmijës. Të rinjtë nën moshën 18 vjeç duhet të identifikohen nga klienti dhe nuk duhet të punësohen për të kryer punë të rrezikshme. E gjithë puna e personave nën moshën 18-vjeçare duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të duhur të rreziqeve dhe një monitorimi të rregullt të shëndetit, kushteve të punës dhe orarit të punës.

⁴Shih shënimin 2, më lart.

Puna e detyruar

11. Klienti nuk duhet të përdorë punë të detyruar, e cila konsiston në punë apo shërbime të kryera jo me vullnet të lirë e të marra me forcë nga një individ, nën kërcënimin e dhunës ose të gjobës. Kjo mbulon punën e detyruar, siç është ajo me kontratë borxhi, me detyrim ose rregullime të ngjashme të marrjes në punë, apo siç është puna e personave të trafikuar.⁵

Mosdiskriminimi dhe shanset e barabarta

12. Projektet duhet të përmbushin kërkesat përkatëse për mosdiskriminimin në lidhje me punësimin. Në veçanti, lidhur me projektin, klienti:
 - nuk duhet të marrë vendime punësimi në bazë të karakteristikave personale, siç janë përkatësia gjinore, racore, shtetësia, opinionet politike, përkatësia në një sindikatë, origjina kombëtare, shoqërore apo indigjene, feja apo besimi, gjendja civile ose familjare, aftësitë e kufizuara, mosha, orientimi seksual apo identiteti gjinor, që nuk kanë lidhje me kërkesat e vetvetishme të vendit të punës
 - duhet ta mbështesë marrëdhënien e punës tek parimi i shanseve të barabarta dhe i trajtimit me drejtësi dhe nuk duhet të bëjë dallime në lidhje me të gjitha aspektet e marrëdhënies së punës, përfshi rekrutimin dhe marrjen në punë, caktimin e vendit të punës, kompensimin (përfshirë pagat dhe përfitimet),⁶ kushtet e punës dhe të punësimit, përfshirë përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës me aftësitë e kufizuara, mundësinë për të përfituar trajnim, ngritjen në detyrë, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës ose daljen në pension dhe disiplinimin
 - duhet të marrë masa për të parandaluar dhe trajtuar ngacmimin, përfshi ngacmimin seksual, ushtrimin e dhunës, frikësimin dhe/ose shfrytëzimin.

Masat e mëposhtme nuk konsiderohen diskriminim: masat e posaçme të mbrojtjes ose të ndihmës për t'i dhënë zgjidhje veprimeve diskriminuese të së shkuarës; nxitja e mundësive lokale për punësim; ose përzgjedhja për një vend të caktuar pune në bazë të kërkesave të vetvetishme të vendit të punës, të cilat janë në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Organizatave e punonjësve

13. Klienti nuk duhet të shkurajojë punonjësit për të zgjedhur përfaqësues të punonjësve, të formojnë organizata të punonjësve apo të anëtarësohen në organizata të punonjësve, sipas dëshirës së tyre apo sipas negociatave kolektive. Klienti nuk duhet të diskriminojë apo të marrë masa kundër punonjësve të cilët veprojnë si përfaqësues, marrin pjesë apo kërkojnë të marrin pjesë në organizata të tilla apo në negociatat kolektive. Në përputhje me legjislacionin kombëtar, klienti duhet t'i angazhojë këta përfaqësues apo organizata të punonjësve dhe t'u japë informacionet e nevojshme për negociim të plotë brenda kohës së duhur. Kur legjislacioni kombëtar e kufizon ndjeshëm ngritjen ose funksionimin e organizatave të punonjësve, klienti duhet të ngrëjë një proces të pavarur për punonjësit që këta të shprehin ankesat e tyre dhe të mbrojnë të drejtat e tyre lidhur me kushtet e punës dhe termat e punësimit, sipas madhësisë së klientit dhe numrit të punonjësve.

Pagat, përfitimet dhe kushtet e punës

⁵ Trafikimi i qenieve njerëzore përkufizohet si rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave, përmes kërcënimit ose përdorimit të dhunës ose formave të tjera të bindjes me forcë, të rrëmbimit të personave, të mashtrimit, të futjes në kurth, të shpërdorimit të pushtetit apo të një pozite të pambrojtur ose të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka nën kontroll një person tjetër me qëllim shfrytëzimin.

⁶ Klienti duhet të marrë në konsideratë parimin e pagesës së barabartë për punë me vlerë të barabartë.

14. Pagat, përfitimet dhe kushtet e punës që ofrohen (përfshi edhe orarin e punës), në përgjithësi duhet të jenë të paktën të krahasueshme me ato që ofrojnë punëdhënësit e të njëjtit nivel në vendin/rajonin përkatës dhe në sektorin në fjalë.
15. Kur klienti është palë e një kontrate kolektive apo është objekt i një kontrate të tillë, kjo kontratë duhet të respektohet. Kur nuk ka kontrata të tilla ose kur këto kontrata nuk i trajtojnë kushtet e punës dhe termat e punësimit, klienti duhet të ofrojë kushte pune dhe terma punësimi të arsyeshme.
16. Klienti duhet të identifikojë punonjësit migrues dhe të sigurojë që këta të angazhohen me kushte kryesisht të ngjashme si të punonjësve jo migrues që kryejnë të njëjtën punë.

Shëndeti dhe siguria në punë

17. Klientët duhet t'u ofrojnë punonjësve një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm pune dhe projektet duhet të përmbushin dispozitat e KP 4.

Strehimi i punonjësve

18. Kur një klient u siguron strehim punonjësve, ky strehim duhet të jetë i përshtatshëm për vendndodhjen dhe të jetë i pastër, i parrezikshëm dhe, minimalisht, të përmbushë nevojat bazë të punonjësve. Në veçanti, ofrimi i strehimit duhet të jetë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare të sektorit ekonomik në fjalë.⁷ Liria e punonjësve për të hyrë e për të dalë nga strehimi i ofruar nga punëdhënësi nuk duhet kufizuar në mënyrë të paarsyeshme.

Shkurtimet

19. Të gjitha pagat e prapambetura, përfitimet e sigurimeve shoqërore dhe kontributet e përfitimet e pensioneve duhet të paguhën: i. përpara ose në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës; ii. sipas rastit, në momentin e rënë dakort me punonjësin; ose iii. pagesa do të bëhet në përputhje me afatin kohor të miratuar me një kontratë kolektive.

Mekanizmi për ankesat

20. Klienti duhet të ofrojë një mekanizëm të efektshëm për ankesat e punonjësve (dhe të organizatave të tyre, kur këto ekzistojnë), përmes të cilit ata të ngrënë shqetësime për qendrën e punës. Klienti duhet t'i informojë punonjësit për mekanizmin e ankesave në momentin e marrjes në punë dhe duhet ta bëjë lehtësisht të përdorshëm këtë mekanizëm për ta. Mekanizmi duhet të përfshijë një nivel të duhur të drejtimit dhe t'u japë rrugë menjëherë shqetësimeve, duke përdorur një proces të kuptueshëm dhe transparent, i cili t'u kthejë informacion në kohën e duhur palëve në fjalë, pa hakmarrje. Mekanizmi duhet të mundësojë paraqitjen dhe trajtimin e ankesave në formë konfidenciale. Mekanizmi nuk duhet të pengojë përdorimin e rrugëve të tjera gjyqësore ose administrative që parashikon ligji ose procedura ekzistuese e arbitrazhit apo e ndërmjetësimit dhe as nuk duhet të konsiderohet si zëvendësues i mekanizmave të ankimit që ofrohen përmes sindikatave apo kontratave kolektive.

Punonjësit jo punëmarrës

⁷ BERZH/IFC, shënim udhëzues "Strehimi i punonjësve: proceset dhe standardet", 2009

21. Për punonjësit jo punëmarrës që angazhon klienti përmes sipërmarrësve apo ndërmjetësve të tjerë, për të punuar në zonat e projektit apo për të kryer punë drejtpërdrejt të lidhura me funksionet bazë të projektit, klienti duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme: i. për të siguruar që këta sipërmarrës apo ndërmjetës të jenë ndërmarrje legjitime dhe me reputacion të mirë; dhe ii. për të kërkuar që të zbatojnë kërkesat e parashtruara në pikat 6-18 dhe 20, më lart. Kur klienti kontraktin drejtpërdrejt punonjës jo punëmarrës, klienti duhet të zbatojë kërkesat e pikave 6-18 dhe 20, më lart.
22. Në përputhje me KP 1, klienti duhet të vendosë politika dhe procedura për menaxhimin dhe monitorimin e performancës së punëdhënësve të tretë në lidhje me projektin dhe kërkesat e këtij kriteri performance. Krahas kësaj, klienti duhet të vlerësojë dhe të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'i përfshirë këto kërkesa në kontrata me punëdhënës të tretë dhe, sipas rastit, duhet të hartojë dhe të zbatojë një plan për menaxhimin e sipërmarrësve.
23. Klientit i kërkohet të identifikojë rreziqet që shoqërojnë punonjësit jo punëmarrës. Klienti duhet të sigurojë që punonjësit jo punëmarrës të kenë mundësi të përdorin një mekanizëm të efektshëm ankimi që përmbush kërkesat e KP 2. Në rastet kur pala e tretë nuk është në gjendje të sigurojë një mekanizëm ankimi, klienti duhet të ofrojë një mekanizëm të efektshëm ankimi për t'u shërbyer punonjësve të angazhuar nga pala e tretë.

Zinxhiri i furnitorëve

24. Si pjesë e procesit të vlerësimit të zinxhirit të furnitorëve të parashtruar në KP 1, klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rrezikun e përdorimit të punës së fëmijëve dhe të punës së detyruar⁸ në zinxhirët e furnitorëve të mallrave dhe të lëndëve që janë thelbësore për funksionet bazë të projektit (zinxhirët bazë të furnitorëve).
25. Nëse klienti mëson se në zinxhirin bazë të furnizimit është e pranishme puna e fëmijëve apo puna e detyruar në shkelje të standardeve të ILO-s, klienti duhet të ndërmarrë hapat e duhur për ta zgjidhur këtë problem në përputhje me sa më poshtë.
 - Nëse zbulohet se përdoret puna e fëmijëve, duhen bërë përpjekje në mirëbesim për ta korrigjuar ose zbutur problemin. Klienti duhet ta vazhdojë prokurimin e këtyre mallrave ose të lëndëve nga ky furnitor vetëm pasi të ketë marrë premtim apo dëshmi të pranueshme se furnitori është i angazhuar për të vënë në zbatim një program në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare për eliminimin e praktikave të tilla brenda një afati kohor të arsyeshëm. Klienti duhet të raportojë rregullisht për ecurinë e vënies në zbatim të një programi të tillë.
 - Në lidhje me punën e detyruar, klienti duhet ta vazhdojë prokurimin e këtyre mallrave ose të lëndëve nga ky furnitor vetëm pasi të ketë marrë premtim apo dëshmi të pranueshme se furnitori ka ndërmarrë hapat e duhur për eliminimin e kushteve që përbëjnë punë të detyruar.
 - Kur ekziston rreziku i përdorimit të punës së fëmijëve dhe/ose të punës së detyruar, klienti duhet të monitorojë vazhdimisht zinxhirin parësor të furnitorëve, në mënyrë që të identifikojë çdo ndryshim të konsiderueshëm në zinxhirin e furnizimit dhe rreziqet ose rastet e reja të punës së fëmijëve dhe/ose të punës së detyruar.

Gjithashtu, kur identifikohen çështje të konsiderueshme sigurie për punonjësit e zinxhirit parësor të furnitorëve, klienti duhet të fusë procedura dhe masa zbutjeje, për të siguruar që furnitorët përkatës po ndërmarrin hapa për parandalimin e këtyre situatave.

⁸ Siç përkufizohet në Konventat e ILO-s 138, 182, 29 dhe 105.

26. Aftësia e klientit për t'u dhënë zgjidhje plotësisht këtyre rreziqeve varet nga niveli i kontrollit ose ndikimit menaxherial që ka klienti mbi furnitorët parësorë të tij. Klienti duhet kalojë, brenda një afati kohor të miratuar, nga zinxhiri parësor i furnitorëve të prekur tek furnitorë të tjerë, të cilët mund të dëshmojnë se e përmbushin këtë kriter performance.

Kërkesat për personelin e mbrojtjes fizike

27. Kur klienti përdor punëmarrës ose sipërmarrës për të siguruar mbrojtjen e personelit dhe të pronave, ai duhet të miratojë një standard praktike dhe sjelljeje për personelin e mbrojtjes fizike, të orientuar nga parimi i proporcionalitetit dhe praktika e mirë ndërkombëtare,⁹ në lidhje me marrjen në punë, kodin e sjelljes, trajnimin, pajisjet dhe monitorimin e këtij personeli. Klienti duhet të bëjë hetime të arsyeshme për t'u bindur se ata që japin shërbime të mbrojtjes fizike nuk janë përfshirë në abuzime në të kaluarën, duhet të sigurohet që ata të trajnohen sa duhet për përdorimin e forcës (dhe, nëse duhet, për përdorimin e armëve të zjarrit) dhe për sjelljen e duhur kundrejt punonjësve dhe komunitetit lokal dhe duhet t'u kërkojë anëtarëve të këtij personeli të veprojnë sipas legjislacionit në fuqi. Klienti nuk duhet të sanksionojë asnjë përdorim force, me përjashtim të rastit kur është e nevojshme për qëllime parandaluese dhe mbrojtëse në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e rrezikut. Klienti duhet të krijojë dhe të mbajë një mekanizëm të efektshëm ankimi, për t'i dhënë mundësi komunitetit dhe punonjësve të prekur të shprehin shqetësimet për mënyrën e organizimit të mbrojtjes fizike dhe të veprimeve të personelit të mbrojtjes fizike dhe duhet t'i informojë komunitetet dhe punonjësit për ekzistencën dhe përdorimin e mekanizmave të ankimit, në përputhje me këtë kriter performance dhe me KP 10.
28. Nëse për t'i siguruar mbrojtje klientit mobilizohen forca shtetërore të mbrojtjes fizike, atëherë klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e mundshme që lindin nga kjo gjë, t'i komunikojë autoriteteve përkatëse publike synimin që personeli i mbrojtjes fizike duhet të veprojë në përputhje me pikën 27 më lart dhe të nxisë autoritetet përkatëse publike që t'i bëjnë të ditura publikisht masat e mbrojtjes fizike për objektet e klientit, por pa shkelur interesat madhore të sigurisë.
29. Klienti duhet të hetojë çdo pretendim për vepra të paligjshme ose abuzive të personelit të mbrojtjes fizike, të veprojë (ose të nxisë fort palët e duhura që të veprojnë) për ta parandaluar përsëritjen e tyre dhe të kallëzojë tek autoritetet publike veprat e paligjshme dhe abuzive.

⁹ Për shembull "Parimet vullnetare për sigurinë dhe të drejtat e njeriut".

Kriteri i Performancës nr. 3 i BERZH-it:

Eficienca e burimeve dhe parandalimi e mbajtja nën kontroll e ndotjes së tyre

Hyrje

1. Ky kriter performance pranon se veprimtaria ekonomike në rritje dhe urbanizimi mund të prodhojnë nivele të larta të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës dhe të konsumojë burimet e kufizuara në atë mënyrë që të rrezikojë popullsinë dhe mjedisin në nivel vendor, rajonal dhe global. Për këtë arsye, eficienca e burimeve dhe parandalimi e mbajtja nën kontroll e ndotjes janë elemente thelbësore të qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale dhe projektet duhet të përmbushin praktikën e mirë ndërkombëtare në këtë aspekt.
2. Ky kriter performance pranon rëndësinë e përdorimit të teknikave më të mira të mundshme dhe të praktikës së mirë ndërkombëtare për të optimizuar përdorimin e burimeve dhe për të parandaluar e mbajtur nën kontroll në mënyrë eficiente çlirimin e ndotësve në mjedis.
3. Ky kriter performance parashtron një qasje në nivel projekti për menaxhimin e burimeve dhe parandalimin e mbajtjen nën kontroll të ndotjes, duke u mbështetur tek shkalla e zbutjes, tek parimi që bëmi mjedisor duhet, si përparësi, të zgjidhet në burim dhe tek parimi “ndotësi paguan”. Çështjet dhe ndikimet e projektit që lidhen me përdorimin e burimeve dhe prodhimi i mbetjeve dhe i shkarkimeve duhet të vlerësohen në kuadër të vendndodhjes së projektit dhe kushteve mjedisore lokale.

Objektivat

4. Objektivat e këtij kriteri performance janë:
 - identifikimi i mundësive që ofron projekti për përmirësimin e eficiencës energjetike, asaj ujore dhe të burimeve dhe për minimizimin e mbetjeve
 - miratimi i qasjes së shkallës së zbutjes për të trajtuar ndikimet e padëshirueshme në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, që lindin nga përdorimi i burimeve dhe ndotja e çliruar nga projekti
 - nxitja e pakësimit të shkarkimeve të gazeve serrë lidhur me projektin.

Fusha e zbatimit

5. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të këtij kriteri performance dhe mënyrën se si do të trajtohen dhe do të menaxhohen ato përmes ciklit të jetës së projektit. Zbatimi i veprimeve të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri performance duhet të menaxhohet në kuadër të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) dhe të Planeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) sipas projekteve. Kërkesat e vlerësimit dhe të menaxhimit mjedisor dhe social jepen në KP 1.

Kërkesat

Eficienca e burimeve

6. Procesi i vlerësimit mjedisor dhe social duhet të identifikojë mundësitë dhe alternativat për eficiencën e burimeve që lidhen me projektin, në përputhje me praktikën e mirë

ndërkombëtare. Në këtë kuadër, klienti duhet të zbatojë masa teknikisht dhe financiarisht¹ të realizueshme dhe me kosto efektive² për të minimizuar konsumin dhe përmirësuar eficiencën e përdorimit të energjisë, të ujit e të burimeve të tjera dhe lëndëve të përdorura, si edhe për rikuperimin dhe ripërdorimin e mbetjeve gjatë zbatimit të projekti. Synimi kryesor duhet të jetë tek veprimtaritë që konsiderohen si funksionet bazë të projektit, por duhet të merren në konsideratë edhe mundësi të ngjashme në veprimtaritë e tjera tregtare të klientit që nuk janë pjesë e projektit. Kur ka të dhëna të gatshme për të bërë një vlerësim krahasues, vlerësimi i klientit duhet të bëjë një krahasim të aktiviteteve të tij me praktikën e mirë ndërkombëtare për të vlerësuar nivelin relativ të eficiencës.

7. Klienti duhet të integrojë masat e eficiencës së burimeve dhe parimet për një prodhim më të pastër në projektimin e produktit dhe proceset e prodhimit, me objektiv ruajtjen e lëndëve të para, të energjisë dhe ujit dhe, në të njëjtën kohë, pakësimin e shkarkimit të ndotësve në mjedis.

Kontrolli dhe parandalimi i ndotjes

8. Procesi i vlerësimit mjedisor dhe social i klientit duhet të përcaktojë metodat, teknologjitë dhe praktikatat e duhura të kontrollit dhe parandalimit të ndotjes (“teknikat”) të cilave u nënshtrohet projekti. Vlerësimi duhet të marrë në konsideratë karakteristikat e objekteve dhe të aktiviteteve që janë pjesë e projektit, vendndodhjen gjeografike të projektit dhe kushtet mjedisore lokale. Procesi i vlerësimit duhet të identifikojë teknikat e kontrollit dhe parandalimit të ndotjes teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive, të cilat janë më të përshtatshmet për të shmangur ose minimizuar ndikimet e padëshirueshme mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Teknikat e zbatuara për projektin duhet të favorizojnë parandalimin ose shmangien e rreziqeve dhe të ndikimeve, kundrejt minimizimit dhe zvogëlimit, në përputhje me qasjen e shkallës së zbutjes dhe me praktikën e mirë ndërkombëtare dhe duhet të jenë sipas natyrës dhe shkallës së çështjeve dhe ndikimeve të padëshirueshme të projektit.
9. Klienti duhet t’i strukturojë projektet që të përmbushin standardet mjedisore përkatëse të BE-së, kur këto mund të zbatohen në nivel projekti.³ Disa projekte, për shkak të natyrës dhe shkallës së tyre, do të ishin objekt i Direktivës së BE-së për ndotjen industriale, kështu që do t’u kërkohet të përmbushin teknikat më të mira të mundshme të BE-së dhe standardet përkatëse për çlirimin dhe shkarkimin e ndotësve, pavarësisht vendndodhjes.
10. Kur nuk ka standarde mjedisore përkatëse të BE-së në nivel projekti, klienti duhet të identifikojë, me miratimin e BERZH-it, standarde të tjera të përshtatshme në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare. Krahas kësaj, projektet duhet të hartohen në përputhje me legjisllacionin kombëtar në fuqi dhe duhet të mirëmbahen dhe të shfrytëzohen në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore kombëtare. Kur rregulloret e vendit priten ndryshojnë nga nivelet dhe masat e parashtruara në kërkesat mjedisore të BE-së ose

¹ Realizueshmëria teknike mbështetet në faktin nëse masat dhe veprimet e propozuara mund të zbatohen me zotësitë, pajisjet dhe materialet tregtare në dispozicion, duke mbajtur në konsideratë karakteristikat vendore të tilla si klima, gjeografia, infrastruktura, siguria, qeverisja, kapaciteti dhe besueshmëria operative. Realizueshmëria financiare mbështetet tek argumentet tregtare, përfshi shkallën relative të kostove shtesë që sjell zbatimi i masave dhe i veprimeve të tilla në krahasim me kostot e investimit, të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes të projektit.

² Efektiviteti i koston përcaktohet sipas kostove kapitale dhe operative dhe përfitimeve financiare të masës, të shikuara gjatë gjithë jetës së masës. Në kuptim të këtij kriteri performance, një masë për eficiencën e burimeve ose pakësimin e shkarkimit të gazeve serrë konsiderohet se ka kosto efektive nëse pritet të ofrojë një kthim të vlerësuar sipas rrezikut mbi investimin, i cili të jetë të paktën i krahasueshëm me vetë projektin.

³ Në kuptim të këtij kriteri performance, standardet mjedisore të BE-së mund të zbatohen në nivel projekti kur vetë dokumenti legjislativ dytësor i BE-së përmban kërkesa të qarta sasiore ose cilësore që janë të zbatueshme në nivel projekti (kundrejt atyre në nivel mjedisi, për shembull).

standardet e tjera mjedisore të identifikuara, projektet duhet të përmbushin nivelin më të rreptë të rregullimit.

11. Projektet që përfshijnë objekte dhe aktivitete të reja pritet të përmbushin që në fillim standardet mjedisore thelbësore të BE-së ose standarde të tjera të miratuara mjedisore, si dhe kërkesat rregullatore kombëtare. Projektet që përfshijnë rehabilitimin e objekteve dhe/ose aktiviteteve ekzistuese pritet të përmbushin kërkesat e pikës 9 dhe/ose 10 brenda një afati kohor të arsyeshëm, i cili do të përcaktohet përmes një vlerësimi zyrtar të ecurisë së tyre kundrejt standardeve të zbatueshme.
12. Në lidhje me projektet në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet që po anëtarësohen apo janë kandidatë ose kandidatë potenciale për anëtare në BE, të cilat përfshijnë rehabilitimin e objekteve dhe/ose aktiviteteve ekzistuese dhe kur janë identifikuar standardet mjedisore thelbësore të BE-së, afati kohor për të arritur përputhshmërinë me këto standarde duhet të marrë në konsideratë afatet kohore të miratuara brenda vendit. Për projektet në të gjitha vendet e tjera, afati kohor për arritjen e përputhshmërisë së standardeve mjedisore thelbësore të BE-së duhet të marrë në konsideratë kushtet lokale dhe koston e zbatimit dhe duhet të jetë në përputhje me Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe çdo marrëveshjeje dypalëshe apo plan veprimi të miratuar e të lidhur midis BE-së dhe vendit pritës në fjalë.
13. Në të gjithë ciklin e jetës së projektit, klienti duhet të zbatojë teknika të kontrollit dhe parandalimit të ndotjes në përputhje me qasjen e shkallës së zbutjes për minimizimin e ndikimeve të mundshme të padëshirueshme në shëndetin e njeriut dhe mjedis, ndërkohëqë mbeten teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive. Kjo zbatohet për shkarkimin e ndotësve për shkak të rrethanave rutinë, jo rutinë apo aksidentale.

Gazet serrë

14. Procesi i vlerësimit mjedisor dhe social i klientit duhet të marrë në konsideratë dhe të zbatojë ato alternativa që janë teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive për të shmangur ose minimizuar shkarkimet e gazeve serrë (GHG) të lidhura me projektin gjatë planifikimit dhe funksionimit të projektit. Në këto alternativa përfshihen, ndër të tjera, vendndodhja e projektit, teknikat ose proceset alternative të projektit, përdorimi i burimeve të rinovueshme ose burimeve të energjisë me nivel të ulët karboni, praktika të menaxhimit të qëndrueshëm të bujqësisë, pyjeve dhe gjësë së gjallë, pakësimi i shkarkimeve të pakontrolluara dhe i djegies së gazeve.
15. Për projektet që aktualisht prodhojnë, ose pas investimit pritet të prodhojnë, më shumë se 25.000 ton CO₂-ekuivalent në vit, klienti duhet të bëjë një vlerësim sasior të këtyre çlirimeve në përputhje me Metodologjinë e BERZH-it për vlerësimin e shkarkimit të gazeve serrë. Objekti i vlerësimit të gazeve serrë duhet të përfshijë të gjitha shkarkimet e drejtpërdrejta nga objektet, veprimtaritë dhe aktivitetet që janë pjesë e projektit ose e sistemit, si edhe shkarkimet e tërthorta që shoqërojnë prodhimin e energjisë së përdorur nga projekti. Vlerësimi sasior i shkarkimeve të gazeve serrë duhet të bëhet nga klienti çdo vit dhe t'i raportohet BERZH-it.

Ujërat

16. Klientët duhet të kërkojnë të minimizojnë përdorimin e ujërave nga projekti dhe në situatat kur duhet ndërtuar një ujësjellës i veçantë për projektin, klienti duhet të kërkojë të përdorë, kur është e realizueshme, ujë për qëllime teknike, i cili nuk është i përshtatshëm për konsum njerëzor.

17. Në kuadër të hartimit të projektit duhen të identifikohen dhe të merren në konsideratë të gjitha mundësitë e realizueshme teknikisht dhe financiarisht dhe me kosto efektive për minimizimin, ripërdorimin dhe riciklimin e ujërave në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.
18. Për projektet me kërkesë të lartë për ujë (më shumë se 5.000 m³/ditë):
- duhet përgatitur, mbajtur dhe raportuar çdo vit te BERZH-i një bilanc i hollësishëm i ujërave
 - duhen identifikuar mundësitë për përmirësim të vazhdueshëm sa i takon eficiencës së përdorimit të ujit
 - duhet vlerësuar përdorimi specifik i ujit (matur sipas vëllimit të ujit të përdorur për njësi prodhimi)
 - aktivitetet duhen krahasuar me standardet e sektorit ekonomik në lidhje me eficiencën e përdorimit të ujit.
19. Klienti duhet të marrë në konsideratë ndikimet e mundshme progresive që ka nxjerrja e ujit mbi përdoruesit e tretë dhe ekosistemet. Sipas rastit, klienti duhet të vlerësojë ndikimet që kanë veprimtaritë e tij në furnizimin me ujë të palëve të tretëve dhe duhet të dëshmojë se furnizimi me ujë i propozuar prej tij nuk do të ketë ndikime të padëshirueshme tek burimet ujore që janë thelbësore për të tretët apo për ekosistemet delikate. Si pjesë e procesit të vlerësimit mjedisor të klientit, klienti duhet të identifikojë dhe të zbatojë masat e duhura zbutëse që favorizojnë parandalimin ose shmangien e rreziqeve dhe të ndikimeve, kundrejt minimizimit dhe zvogëlimit, në përputhje me qasjen e shkallës së zbutjes dhe me praktikën e mirë ndërkombëtare.

Mbetjet⁴

20. Klienti duhet të shmangë ose të minimizojë prodhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme dhe ta zvogëlojë rrezikshmërinë e tyre sa më shumë. Kur prodhimi i mbetjeve nuk mund të shmanget por është minimizuar, klienti duhet t'i ripërdorë, riciklojë ose rikuperojë mbetjet ose t'i përdorë ato si burim energjie. Kur mbetjet nuk mund të rikupërohen ose ripërdoren, klienti duhet t'i trajtojë dhe t'i depozitojë ato në mënyrë miqësore për mjedisin.
21. Nëse mbetjet e prodhuara konsiderohen të rrezikshme, klienti duhet të vlerësojë alternativat e realizueshme teknikisht dhe financiarisht dhe me kosto efektive për depozitimin e tyre pa i bërë dëm mjedisit, duke mbajtur në konsideratë kufizimet e zbatueshme për lëvizjen ndërkufitare dhe kërkesat e tjera ligjore.
22. Kur depozitimi i mbetjeve bëhet jashtë zonës së projektit dhe/ose bëhet nga palë të treta, klienti duhet të marrë dokumentacionin e zinxhirit të kujdestarisë deri në venddepozitimin përfundimtar dhe duhet të përdorë sipërmarrës që janë ndërmarrje legjitime, me reputacion e të licencuara nga agjencitë rregullatore përkatëse. Klienti duhet të sqarojë edhe nëse pikat e licencuara të depozitimit të mbetjeve funksionojnë apo jo sipas standardeve të pranueshme. Kur nuk ndodh kështu, klienti duhet të mendojë zgjidhje alternative të depozitimit të mbetjeve, përfshi mundësinë e ndërtimit nga vetë ata të objekteve për rikuperimin dhe depozitimin e mbetjeve në zonën e projektit.

Përdorimi i sigurt dhe menaxhimi i lëndëve dhe materialeve të rrezikshme

⁴Në kuptim të këtij kriteri performance, mbetjet përkufizohen si një përzierje heterogjene lëndësh/materialësh të gazta, të lëngëta dhe/ose të ngurta që duhet trajtuar përmes proceseve të përshtatshme fizike, kimike dhe/ose biologjike përpara se të hidhen në mjedis.

23. Në të gjitha veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejt me projektin, klienti duhet të shmangë ose të minimizojë përdorimin e lëndëve dhe të materialeve të rrezikshme dhe të marrë në konsideratë përdorimin e zëvendësuesve më pak të rrezikshëm për këto lëndë dhe materiale, në mënyrë që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi nga ndikimet e mundshme të dëmshme prej tyre. Kur nuk mundet të shmangen ose të zëvendësohen, klienti duhet të zbatojë masat e duhura të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të minimizojë ose të mbajë nën kontroll çlirimin e lëndëve/materialeve të tilla në ajër, ujë dhe/ose tokë, si pasojë e prodhimit, transportimit, trajtimit, magazinimit, përdorimit dhe depozitimit së tyre në lidhje me veprimtaritë e projektit.
24. Klienti duhet të evitohet prodhimin, tregtimin dhe përdorimin e lëndëve dhe materialeve të rrezikshme që janë subjekt i ndalimit ndërkombëtar ose nxjerrjes jashtë përdorimit për shkak të nivelit të lartë toksik për organizmat e gjalla, rezistencës në mjedis, mundësisë për bioakumulim ose hollimit të shtresës së ozonit.

Përdorimi dhe menaxhimi i pesticideve

25. Klientët që menaxhojnë ose përdorin pesticide duhet të hartojnë dhe të zbatojnë një qasje të menaxhimit të integruar të dëmtuesve (MID) dhe/ose menaxhimit të integruar të vektorëve (MIV) për veprimtaritë e menaxhimit të dëmtuesve. Programi MID dhe MIV i klientit duhet të bashkërendojë përdorimin e informacioneve për dëmtuesit dhe mjedisin së bashku me metodat e mbajtjes në kontroll të dëmtuesve, përfshi praktikat kulturore, mjetet biologjike, gjenetike dhe, si zgjidhje të fundit, ato kimike për të parandaluar nivelet e papranueshme të dëmit të shkaktuar nga dëmtuesit e bimëve. Kur në veprimtaritë e menaxhimit të dëmtuesve përfshihet përdorimi i pesticideve, klienti duhet të përpiqet të zvogëlojë ndikimet që kanë pesticidet tek biodiversiteti, shëndeti i njeriut dhe më gjerë mjedisi dhe, më në përgjithësi, të arrijë një përdorim të qëndrueshëm të pesticideve, si dhe një zvogëlim të përgjithshëm të konsiderueshëm të rreziqeve dhe përdorimeve të pesticideve në përputhje me mbrojtjen e nevojshme të kulturave bujqësore.
26. Përdorimi i qëndrueshëm i pesticideve duhet të përfshijë:
- shmangien, ose kur nuk është e mundur kjo, minimizimin e ndikimeve që kanë pesticidet në biodiversitetin, shëndetin e njeriut dhe mjedisin në përgjithësi
 - uljen e niveleve të lëndëve aktive të dëmshme përmes zëvendësimit të lëndëve më të rrezikshme me alternativa më të sigurta (përfshi edhe alternativa jo-kimike)
 - përzgjedhjen e pesticideve që kanë nivel të ulët toksik, të njohura si të efektshme kundër llojeve të synuara dhe që kanë ndikime minimale tek llojet jo të synuara, siç janë insektet pllenuese dhe mjedisi
 - promovimin e të mbjellave me nivel të ulët ose pa pesticide
 - minimizimin e dëmit ndaj armiqve natyrorë të dëmtuesve të synuar dhe parandalimin e zhvillimit të rezistencës tek dëmtuesit.
27. Klienti duhet t'i trajtojë, magazinojë, përdorë dhe depozitohet pesticidet në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.

Kriteri i Performancës nr. 4 i BERZH-it:

Shëndeti dhe siguria

Hyrje

1. Ky kriter performance njih rëndësinë e shmangies ose të zbutjes së çështjeve dhe ndikimeve të padëshirueshme të shëndetit dhe sigurisë, të lidhura me veprimtaritë e projektit, tek punonjësit, komunitetet e prekura nga projekti dhe konsumatorët.
2. Veprimtaritë, pajisjet dhe infrastruktura e projektit mund ta rrisin mundësinë e ekspozimit të punonjësve dhe të komunitetit ndaj rreziqeve dhe ndikimeve të shëndetit dhe sigurisë, duke përfshirë edhe ato të lidhura me ndërtimin, veprimtaritë dhe nxjerrjen nga puna, ose me transportimin e lëndëve të para dhe materialeve të gatshme.
3. Klientët kanë përgjegjësinë parësore për të siguruar kushte të sigurt dhe të shëndetshme për punonjësit e tyre dhe për informimin, trajnimin, mbikëqyrjen dhe konsultimin e punonjësve për çështjet e shëndetit dhe të sigurisë. Punonjësit kanë përgjegjësinë për të bashkëpunuar aktivisht me punëdhënësin dhe për t'u kujdesur për shëndetin dhe sigurinë e tyre, si dhe shëndetin dhe sigurinë e të tjerëve.
4. Duke njohur rolin që kanë autoritetet përkatëse për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit dhe të sigurisë së publikut, klienti ka detyrën të identifikojë, të shmangë, të minimizojë ose të zbusë rreziqet dhe ndikimet e padëshirueshme, që mund të lindin nga projekti, tek shëndeti dhe siguria e komuniteteve të prekura.

Objektivat

5. Objektivat e këtij kriteri performance janë:
 - mbrojtja dhe promovimi i sigurisë dhe i shëndetit të punonjësve duke, siguruar kushte pune të sigurt dhe të shëndetshme dhe duke zbatuar një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe të sigurisë, në përputhje me çështjet dhe rreziqet përkatëse që shoqërojnë projektin
 - parapritja, vlerësimi dhe parandalimi ose minimizimi i ndikimeve të padëshirueshme tek shëndeti dhe siguria e komuniteteve dhe e konsumatorëve të prekur nga projekti gjatë ciklit të jetës së projektit, nga rrethanat rutinë dhe jo rutinë.

Fusha e zbatimit

6. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të këtij kriteri performance dhe mënyrën se si do të trajtohen dhe do të menaxhohen ato përmes ciklit të jetës së projektit. Zbatimi i veprimeve të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri performance duhet të menaxhohet në kuadër të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) të klientit dhe/ose Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) sipas projekteve, sikurse parashikohet në KP 1.
7. Rreziqet dhe ndikimet e mundshme për punonjësit dhe komunitetet e prekura mund të ndryshojnë sipas fazës së projektit, përfshi ndërtimin, vënien në punë, funksionimin dhe heqjen nga puna. Kërkesat e detajuara për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndikimeve tek shëndeti i njeriut dhe në mjedis për shkak të çlirimit të ndotjes gjenden në KP 3; ndërsa ato që lidhen me fuqinë punëtore dhe kushtet e punës, pa përfshirë shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, trajtohen në KP 2.

8. Në të gjithë këtë kriter performance, termi “punonjës” përdoret për punëmarrësit e klientit, përfshi personelin me kohë të pjesshme, punonjësit e përkohshëm, sezonalë dhe migrues dhe punonjësit jo punëmarrës të angazhuar nga klienti përmes sipërmarrësve të kontratave ose ndërmjetësve të tjerë për të punuar në zonën e projektit ose për të kryer punë të lidhura drejtpërdrejt me funksionet bazë të projektit.

Kërkesat

Kërkesat e përgjithshme për menaxhimin e shëndetit dhe të sigurisë

9. Klienti duhet të ndërmarrë hapa për të identifikuar dhe parandaluar aksidentet, dëmtimet dhe sëmundjet e punonjësve dhe të komuniteteve të prekura, të cilat lindin nga veprimtaritë e projektit ose që shoqërojnë veprimtaritë e projektit ose ndodhin gjatë veprimtarive të projektit, si dhe për të përgatitur e zbatuar masa parandaluese dhe plane për të menaxhuar rreziqet e shëndetit dhe të sigurisë në përputhje me qasjen e shkallës zbutëse dhe praktikën e mirë ndërkombëtare.
10. Klienti duhet t’u japë punonjësve dhe komuniteteve të prekura informacionin, orientimin dhe trajnimin përkatës në lidhje me rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë, masat mbrojtëse dhe parandaluese dhe planet në rast emergjence, të cilat janë të nevojshme për sigurinë e tyre gjatë gjithë projektit.
11. Kur një aksident, dëmtim dhe sëmundje lind ose ndodh gjatë punimeve që shoqërojnë projektin, ose kur ka mundësi të ndodhë diçka e tillë, klienti duhet të hetojë, t’i dokumentojë dhe analizojë konstatimet dhe të zbatojë masa për të parandaluar përsëritjen e tyre dhe, kur e kërkon ligji, të njoftojë dhe të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse.

Shëndeti dhe siguria në punë

12. Klienti duhet t’u sigurojë punonjësve një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm, duke mbajtur në konsideratë rreziqet e vetvetishme të sektorit përkatës dhe klasat specifike të rreziqeve që mund të jenë të pranishme. Klienti duhet të identifikojë rreziqet e shëndetit dhe të sigurisë dhe masat mbrojtëse sipas fazës, madhësisë dhe natyrës së projektit, në përputhje me standardet bazë të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë të BE-së¹ dhe praktikën e mirë ndërkombëtare. Klienti duhet të hartojë një plan për shëndetin dhe sigurinë enkas për projektin, sipas rastit, i cili duhet të integrohet në PMMS.
13. Klienti duhet të zbatojë masa të shëndetit dhe të sigurisë në punë, që parashikojnë: i. masa parandaluese dhe mbrojtëse, përfshi modifikimin, zëvendësimin ose eliminimin e kushteve ose substancave të rrezikshme; ii. pajisje për minimizimin e rreziqeve, duke kërkuar dhe zbatuar me forcë përdorimin e tyre; iii. pajisje të mbrojtjes personale pa kosto për punonjësit; dhe iv. trajnim për punonjësit për të përdorur dhe respektuar procedurat e shëndetit dhe të sigurisë dhe pajisjet mbrojtëse. Klienti duhet t’u kërkojë punonjësve jo punëmarrës, sipërmarrësve dhe palëve të treta, të angazhuar për të punuar në zonat e projektit apo për të kryer punë drejtpërdrejt lidhur me funksionet bazë të projektit, të respektojnë planin e shëndetit dhe sigurisë.
14. Gjatë çdo veprimtarie pune klienti duhet të sigurojë që të gjithë punonjësve t’u bëhet mbikëqyrje e vazhdueshme dhe e duhur për të siguruar zbatimin, mbajtjen dhe zbatimin e duhur të masave të shëndetit dhe të sigurisë.

¹ Standardet e BE-së për shëndetin dhe sigurinë në punë janë kërkesat thelbësore në legjislacionin e BE-së në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, ku vendosen kërkesat minimale për shëndetin dhe sigurinë për mbrojtjen e punonjësve.

15. Klienti duhet të monitorojë shëndetin e punonjësve të tij dhe t'i konsultojë e nxisë punonjësit të marrin pjesë në çështje të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në qendrën e punës. Ndër të tjera, kjo përfshin hetimin e aksidenteve, vlerësimin e rrezikut dhe përzgjedhjen e punës.
16. Kur ka rreziqe të veçanta që shoqërojnë veprimtari të caktuara pune me pasoja të padëshirueshme për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve me ndjeshmëri të tillë si moshë, përkatësia gjinore, aftësi të kufizuara ose kushte shëndetësore afatshkurtra apo afatgjata, klienti duhet të bëjë një vlerësim të rrezikut dhe të bëjë përshtatje për të parandaluar dëmtimin dhe sëmundjen.

Shëndeti dhe siguria në komunitet

17. Klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e lidhura me projektin dhe ndikimet e padëshirueshme për shëndetin dhe sigurinë e komuniteteve mundësisht të prekura dhe duhet të hartojë masa mbrojtëse, parandaluese dhe zbutëse në përpjesëtim me ndikimet dhe rreziqet dhe sipas fazës, madhësisë dhe natyrës së projektit. Klienti duhet të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse dhe palët e tjera të interesit, sipas rastit, për planet dhe masat zbutëse. Këto masa duhet të jenë në përputhje me qasjen e shkallës zbutëse dhe praktikën e mirë ndërkombëtare.
18. Masat për shmangien ose zbutjen e ndikimeve nga projekti në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit mund të jenë përgjegjësi e autoriteteve publike përkatëse. Në këto rrethana, klienti duhet të sqarojë rolin dhe përgjegjësinë e tij për të njoftuar pranë autoriteteve përkatëse dhe për të bashkëpunuar me to.

Kërkesat e veçanta për menaxhimin e shëndetit dhe të sigurisë

Projektimi dhe siguria e infrastrukturës, e ndërtesave dhe e pajisjeve

19. Klienti duhet të përfshijë aspektet e shëndetit dhe të sigurisë në projektimin, ndërtimin, funksionimin dhe nxjerrjen nga puna të elementëve ose komponentëve strukturorë të projektit në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, duke mbajtur në konsideratë rreziqet e sigurisë, objekt i të cilave janë palët e treta dhe komunitetet e prekura. Elementët strukturorë duhet të projektohen dhe të ndërtohen nga profesionistë të kualifikuar dhe me përvojë. Duhet kryer kontroll të mbrojtjes nga zjarri dhe të mbrojtjes së jetës së palëve të treta, si për ndërtesat ekzistuese që përdoren për qëllime të përbashkëta të komunitetit, ashtu edhe për ndërtesat e reja përpara se këto të vihen në funksionim.
20. Ndërtimi dhe pajisja me orenditë kryesore e ndërtesave që përdoren për qëllime të përbashkëta komunitare duhet të planifikohen në përputhje me konceptin e përdorimit nga të gjithë.²
21. Kur elementë strukturorë ose komponentë të tillë si diga, rezervuare të mbetjeve minerare ose rezervuare hiri ndodhen në pika me rrezik të lartë dhe mosfunksionimi ose keqfunksionimi i tyre mund të verë në rrezik sigurinë e punonjësve dhe të komuniteteve, klienti duhet të angazhojë një ose më shumë ekspertë të kualifikuar me përvojën përkatëse dhe të njohur në projekte të ngjashme, veçmas nga personat përgjegjës për projektimin dhe ndërtimin, për të kryer një shqyrtim në një moment sa më të hershëm të përgatitjes së

² Përdorimi nga të gjithë do të thotë mundësi përdorimi që u jepet lirisht njerëzve nga të gjitha moshat dhe aftësitë në situata dhe rrethana të ndryshme.

projektit dhe gjatë të gjitha fazave të planifikimit, ndërtimit, funksionimit dhe vënies në punë të projektit.

Siguria e materialeve të rrezikshme

22. Klienti duhet të parandalojë ose të minimizojë mundësinë e ekspozimit të punonjësve dhe të komunitetit ndaj materialeve të rrezikshme që mund të dalin nga projekti. Kur ekziston mundësia që punonjësit dhe komunitetet e prekur të ekspozohen ndaj rreziqeve, klienti duhet të tregojë kujdesin e duhur për të shmangur ose minimizuar ekspozimin e tyre përmes modifikimit, zëvendësimit ose eliminimit të kushtit apo substancës që shkakton rrezik.
23. Kur materialet e rrezikshme janë pjesë e objekteve ose aktiviteteve ekzistuese që shoqërojnë projektin, klienti duhet të tregojë kujdesin e duhur gjatë vënies në punë dhe heqjes nga funksionimi në mënyrë që të parandalojë ekspozimin e punonjësve dhe të komunitetit të prekur ndaj këtyre materialeve të rrezikshme. Kur nuk mund të shmangët përdorimi i materialeve të tilla, klienti duhet të marrë masat e nevojshme për trajtimin, magazinimin dhe transportimin në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.
24. Klienti duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar transportin e sigurt të lëndëve të para dhe të produkteve, si dhe transportimin dhe depozitimin e mbetjeve dhe duhet të zbatojë masa për të shmangur ose mbajtur nën kontroll ekspozimin e komunitetit.

Siguria e produkteve

25. Kur projekti kërkon prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve të konsumit të gjerë, klienti duhet të garantojë sigurinë e produkteve përmes proceseve të mira të projektimit dhe të prodhimit, si edhe përmes magazinimit, trajtimit dhe transportimit për shpërndarjen e produkteve. Duhet ndjekur praktika e mirë ndërkombëtare, përfshi kërkesat e përgjithshme për sigurinë, specifike për standardet e sigurisë së produktit dhe kodet e praktikës në një sektor ekonomik dhe vend të caktuar.
26. Gjatë procesit të vlerësimit të projektit, klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet dhe ndikimet e mundshme që kanë produktet e tyre tek shëndeti dhe siguria e konsumatorëve. Qasja për sigurinë e produkteve duhet të respektojë shkallën zbutëse dhe të sigurojë që konsumatorëve t'u jepet informacion i mjaftueshëm për rreziqet e shëndetit dhe të sigurisë së produktit. Për situatat që përfshijnë produkte të cilat mund të paraqesin rreziqe serioze për shëndetin, klienti duhet të sigurojë heqjen e produktit nga tregu dhe të sigurohet që ka dhe po zbatohen politika dhe procedura të tërheqjes së produktit nga tregu.

Siguria e shërbimeve

27. Kur projekti kërkon ofrimin e shërbimeve ndaj komunitetit, klienti duhet të garantojë sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të tilla përmes sistemeve të duhura të menaxhimit të cilësisë, për t'u siguruar që këto shërbime të mos paraqesin rrezik dhe ndikime tek shëndeti dhe siguria e punonjësve ose e komunitetit.
28. Kur projekti kërkon ofrimin e shërbimeve publike, klienti duhet të përfshijë, sa më shumë të jetë e mundur, parimet e përdorimit të shërbimeve nga të gjithë.

Trafiku dhe siguria rrugore

29. Klienti duhet të identifikojë, të vlerësojë dhe të monitorojë rreziqet e mundshme të trafikut dhe të sigurisë rrugore për punonjësit dhe komunitetet mundësisht të prekura gjatë gjithë

ciklit të jetës së projektit dhe, sipas rastit, duhet të hartojë masa dhe plane për t'u dhënë zgjidhje. Për projektet që shfrytëzojnë pajisje lëvizëse në rrugët publike dhe forma të tjera të infrastrukturës, klienti duhet të kërkojë të parandalojë ndodhjen e incidenteve dhe të dëmtimeve të publikut të gjerë që vijnë nga përdorimi i pajisjeve të tilla.

30. Klienti duhet të mbajë parasysh standardet përkatëse të BE-së për menaxhimin e trafikut dhe të sigurisë rrugore,³ të identifikojë masat e sigurisë rrugore dhe të përfshijë komponentë të sigurisë rrugore teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshëm dhe me kosto efektive, me qëllimin për të zbutur ndikimet e mundshme të sigurisë rrugore tek komunitetet lokale të prekura. Sipas rastit, klienti duhet të ndërmarrë një kontroll të sigurisë rrugore për secilën fazë të projektit dhe të monitorojë rregullisht raportimet e incidenteve dhe të aksidenteve për të identifikuar dhe zgjidhur problemet apo prirjet negative të sigurisë. Për klientët me automjete ose flota automjesh (në pronësi ose të marra me qira), klienti duhet t'u sigurojë punonjësve trajnimin e duhur për drejtimin dhe sigurinë e automjeteve. Klienti duhet të sigurojë mirëmbajtje të rregullt të të gjitha automjeteve të projektit.

Rreziqet natyrore

31. Klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet dhe rreziqet e mundshme të shkaktuara nga rreziqet natyrore, si tërmeti, rrëshqitjet e dheut ose përmytjet, të cilat lidhen me projektin.
32. Klienti duhet të shmangë dhe/ose të minimizojë përkeqësimin e ndikimeve të shkaktuara nga rreziqet natyrore apo ndryshimin e përdorimit të tokës, tek të cilat mund të kontribuojnë veprimtaritë e projektit.

Ekspozimi ndaj sëmundjeve

33. Për të ndihmuar në parandalimin ose minimizimin e mundësisë së ekspozimit të punonjësve dhe të komunitetit ndaj sëmundjeve, duke marrë parasysh ekspozimin e diferencuar dhe ndjeshmërinë e të lartë të grupeve më të prekshme, klienti duhet të zhvillojë procesin e zbutjes së duhur në konsultim me autoritetet përkatëse. Klienti duhet të marrë masat për të shmangur ose minimizuar transmetimin e sëmundjeve ngjithëse, që mund të shoqërohen me ardhjen e punonjësve të përkohshëm dhe/ose të përhershëm të projektit.
34. Kur në komunitetet e prekura nga projekti ka sëmundje të veçanta endemike, klienti nxitet të identifikojë mundësitë, përgjatë gjithë ciklit të jetës së projektit, për përmirësimin e kushteve që mund të ndihmojnë në pakësimin e përhapjes së këtyre sëmundjeve, si tek punonjësit ashtu edhe tek komunitetet. Klienti duhet të marrë masat për të shmangur ose minimizuar transmetimin e sëmundjeve ngjithëse, që mund të shoqërohen me ardhjen e fuqisë punëtore të përkohshme dhe/ose të përhershme të projektit.

Gatishmëria dhe përgjigjshmëria në situatë emergjence

35. Klienti duhet të i jetë i përgatitur për t'iu përgjigjur incidenteve, aksidenteve dhe situatave emergjente në përputhje me rreziqet operative të lidhura me projektin dhe nevojën për të

³ Në përputhje me objektivat e Direktivës 2008/96/KE, datë 19 nëntor 2008, Për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore.

parandaluar ose minimizuar ndikimet e mundshme të padëshirueshme të tyre dhe në përputhje me kërkesat rregullatore të zbatueshme.⁴

36. Klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e aksidenteve madhore dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet madhore ose për të kufizuar ndikimet e padëshirueshme të tyre tek punonjësit, komunitetet e prekura dhe mjedisi, me qëllim sigurimin e niveleve të larta të mbrojtjes së njerëzve dhe të mjedisit në mënyrë të njëtrajtshme dhe të efektshme. Masa të tilla duhet të identifikohen në politikën e gatishmërisë ndaj emergjencave/parandalimit të aksidenteve madhore dhe në një plan të përshtatshëm menaxhimi, të integruar në SMMS-në e përgjithshme të klientit. Ky plan duhet të përfshijë strukturat organizative, përgjegjësitë, procedurat, komunikimin, trajnimin, burimet dhe aspektet e tjera të nevojshme për zbatimin e kësaj politike, për të siguruar që klienti të ketë kapacitetin për t'iu përgjigjur në mënyrë të efektshme emergjencave që shoqërojnë rreziqet e projektit, me objektiv të përgjithshëm:
- parandalimin, kufizimin dhe mbajtjen nën kontroll të incidenteve, për të minimizuar pasojat dhe për të kufizuar dëmin e shkaktuar tek njerëzit, mjedisi dhe pasuritë
 - zbatimin e masave të nevojshme për të mbrojtur njerëzit dhe mjedisin nga pasojat e aksidenteve madhore
 - dhënien e informacionit të nevojshëm shërbimeve ose autoriteteve përkatëse të emergjencave, punonjësve dhe publikut që mund të preken
 - ofrimin e rimëkëmbjes dhe të pastrimit të mjedisit pas një aksidenti madhor.
37. Për projektet ku është i pranishëm rreziku i aksidenteve madhore, klienti duhet të asistojë dhe të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse dhe komunitetin e prekur nga projekti në përgatitjen e tyre për t'iu përgjigjur me efektivitet situatave emergjente. Nëse autoritetet vendore apo personat që përgjigjen kanë shumë pak ose aspak kapacitet për t'iu përgjigjur me efektivitet, klienti duhet të luajë një rol aktiv në përgatitjen për emergjencat që shoqërojnë projektin dhe në përgjigjen ndaj tyre dhe duhet të japë dëshmi të mjaftueshme për të treguar se ka kapacitetin për t'iu përgjigjur incidenteve të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme, si drejtpërdrejt ashtu edhe tërthorazi.

⁴ Sikurse shtjellohet në Direktivën 2012/18/BE, datë 4 korrik 2012, Për mbajtjen në kontroll të rreziqeve të aksidenteve madhore të lidhura me lëndët e rrezikshme, dhe për ndryshimin e më pas shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 96/82/KE (Direktiva EU SEVESCO III).

Kriteri i Performancës nr. 5 i BERZH-it:

Marrja e tokës, shpërngulja e detyruar dhe zhvendosja për arsye ekonomike

Hyrje

1. Shprehja “shpërngulje e detyrueshme” përdoret si për zhvendosjen fizike (rivendosja ose humbja e strehimit) ashtu edhe për zhvendosjen ekonomike (humbja e mjeteve ose e burimeve dhe/ose humbja e mundësive për të përdorur mjete ose burime që çojnë në humbjen e burimeve të të ardhurave ose humbje të mjeteve të jetesës) si pasojë e marrjes së tokës në funksion të projektit¹ dhe/ose e kufizimeve të vendosura mbi përdorimin e tokës.²
2. Shpërngulja konsiderohet e detyrueshme kur individët ose komunitetet e prekura nuk kanë të drejtë të thonë “jo” për marrjen e tokës apo për kufizimet e vendosura mbi përdorimin e tokës, të cilat çojnë në zhvendosje. Kjo ndodh në rastet e: i. shpronësimeve të ligjshme ose kufizimeve të ligjshme të vendosura mbi përdorimin e tokës në bazë të së drejtës sovrane;³ dhe ii. shpërnguljes së negociuar në të cilën blerësi mund të përdorë si rrugë të fundit shpronësimin ose vendosjen e kufizimeve ligjore mbi përdorimin e tokës nëse negociimet me shitësin nuk kanë sukses.
3. Zbatimi i këtij kriteri performance mbështetet dhe përputhet me respektimin dhe zbatimin nga të gjithë të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe, në veçanti, të së drejtës për strehim të përshtatshëm dhe përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të jetesës.⁴ Në rastet kur ka pasur më parë shpërngulje si pasojë e konfliktit, ky kriteri performance orientohet nga Parimet orientuese për zhvendosjen e brendshme.⁵
4. Nëse nuk menaxhohet si duhet, shpërngulja e detyrueshme mund të sjellë vështirësi afatgjata dhe varfërim për personat dhe komunitetet e prekura, si edhe dëm mjedisor dhe ndikime të padëshirueshme shoqëro-ekonomike në zonat ku shpërngulen. Në disa rrethana, shpërngulja e detyrueshme, e realizuar dobët, mund ta zbulojë klientin ndaj padive. Për këto arsye, është mirë të shmanget shpërngulja e detyruar. Por, kur nuk mund të shmanget, është mirë të minimizohet shpërngulja dhe të planifikohen e zbatohen masat e duhura për të zbutur ndikimet e padëshirueshme tek personat e shpërngulur dhe komunitetet pritëse.⁶ Përvoja tregon se përfshirja e drejtpërdrejtë e klientit në veprimtaritë e shpërnguljes dhe një vlerësim sa më herët në planifikimin e projektit mund të çojë në zbatimin me efektivitet të kostos, eficiencë dhe në kohën e duhur të këtyre veprimtarive, si dhe të promovojë qasje novatore për përmirësimin e mjeteve dhe të standardeve të jetesës për personat e prekur nga shpërngulja.

¹ Marrja e tokës përfshin si blerjen e drejtpërdrejtë të pronës ashtu edhe blerjen e të drejtave të përdorimit, siç është e drejta e kalimit.

² Disa shembuj janë humbja e të drejtave të minatorëve artizanale mbi mineralet nëntokësore në pronësi të shtetit; humbja e të drejtave mbi zonat peshkuese për shkak të veprimtarive të projektit; kufizimi i të drejtave mbi burimet që ndodhen brenda zonave të përcaktuara nga shteti si të kufizuara, por jo të marra nga klienti; dhe pakësimet e dëshmuara të rendimentit bujqësor, blegtoral, pyjor, si dhe në gjah e peshkim, për shkak të shqetësimeve dhe/ose ndotjes të lidhur me projektin.

³ Në kufizime të tilla mund të përfshihen kufizimet mbi të drejtat mbi zonat e mbrojtura me ligj dhe të njohura në nivel ndërkombëtar me rëndësi për biodiversitetin.

⁴ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

⁵ Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut: Parimet orientuese për shpërnguljen brendapërbrenda vendit.

⁶ Një komunitet pritës është komuniteti që pret personat e shpërngulur.

Objektivat

5. Objektivat e këtij kriteri performance janë:

- shmangia ose, kur nuk mund të shmangen, minimizimi i shpërnguljeve të detyrueshme përmes eksplorimit të planeve alternative të projekteve
- zbutja e ndikimeve të padëshirueshme sociale dhe ekonomike nga marrja e tokës ose kufizimet mbi përdorimin dhe të drejtën e përdorimit të mjeteve dhe të tokës së personave të prekur përmes: i. ofrimit të kompensimit për humbjen e mjeteve me koston e zëvendësimit;⁷ dhe ii. kujdesit që veprimtaritë e shpërnguljes të zbatohen duke dhënë siç duhet informacion, duke bërë konsultime dhe duke siguruar pjesëmarrjen e personave të prekur
- rivendosja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i mjeteve dhe i standardeve të jetesës së personave të zhvendosur⁸ në nivelet përpara zhvendosjes
- përmirësimi i kushteve të jetesës tek personat e zhvendosur fizikisht, përmes ofrimit të strehimit të përshtatshëm,⁹ përfshi sigurimin e të drejtës së përdorimit të tokës tek zona e rivendosjes.¹⁰

Fusha e zbatimit

6. Ky kriteri performance zbatohet për zhvendosjen fizike ose ekonomike, që mund të jetë e plotë, e pjesshme, e përhershme ose e përkohshme, e cila vjen nga disa lloje veprimesh:

- të drejtat mbi tokën dhe të drejtat mbi përdorimin e tokës për një projekt, të fituara përmes shpronësimit ose përmes procedurave të tjera me detyrim
- të drejtat e tokës për një projekt, të fituara përmes shpërnguljeve të negociuara me pronarët ose me personat që mbajnë të drejtat ligjore mbi tokën, përfshi edhe të drejtat zakonore ose tradicionale që njihen ose janë të njohura sipas ligjeve të vendit, nëse dështimi i negociimit do të çonte në shpronësim ose procese të tjera të detyrueshme
- vendosja e kufizimeve që çojnë në humbjen e të drejtës për të përdorur mjetet fizike ose burimet natyrore pavarësisht nëse të drejta të tilla kufizimi merren përmes negociimit, shpronësimit, blerjes së detyrueshme ose përmes akteve normative shtetërore.

⁷ Zakonisht kjo llogaritet me vlerën e tregut të mjeteve plus koston e transaksionit të lidhura me rivendosjen e këtyre mjeteve. Llogaritja e kostove të zëvendësimit është komplekse për shkak të luhatshmërisë së mundshme të tokës, pretenduesve për përdorimin e tokës dhe niveleve të ndryshme të zhvillimit të tregut të tokës në vendet e ndryshme anëtare. Për këtë arsye, klientët duhet të identifikojnë dhe të konsultojnë të gjithë personat dhe komunitetet që do të zhvendosen për shkak të marrjes së tokës, si edhe komunitetet pritëse që do të pranojnë personat e shpërngulur, në mënyrë që të merret informacioni i duhur për titujt, të drejtat dhe përdorimin e tokës. Metoda e vlerësimit për përcaktimin e koston të zëvendësimit duhet të dokumentohet në planet përkatëse të shpërnguljes dhe/ose të rivendosjes së mjeteve të jetesës. Kur tregjet e tokës janë ende në fazën e lindjes, klientët duhet të kërkojnë vlerësimin e ekspertëve të jashtëm, të pavarur e profesionistë të vlerësimit (ose nëse nuk ka ekspertë të tillë profesionistë vlerësimi, profesionistë të tjerë me njohuritë përkatëse prej eksperti, të pranueshme për BERZH-in dhe klientin). Shih edhe shënimet 12 dhe 14 më poshtë.

⁸ Këtu mund të përfshihen ata që kanë të drejta ose pretendime të njohura me ligj mbi tokën, ata që kanë pretendime zakonore mbi tokën, ata që nuk kanë të drejta ose pretendime të njohura me ligj mbi tokën, përdoruesit sezonalë të burimeve siç janë familjet që kullojnë bagëti ose merren me peshkim, gjahtarët dhe mbledhësit e ushqimeve të cilët mund të kenë marrëdhënie ndërvarësie ekonomike me komunitetet që ndodhen në zonën e projektit.

⁹ Strehimi i përshtatshëm mund të matet me cilësinë, sigurinë, përbalueshmërinë, banueshmërinë, përshtatshmërinë kulturore, arritshmërinë dhe karakteristikat e vendndodhjes. Strehimi i përshtatshëm duhet të lejojë mundësi për punësim, dyqane dhe infrastrukturë e shërbime bazë si ujë, energji elektrike, kanalizime, kujdes shëndetësor dhe arsim. Klientët duhet t'i përfshijnë këto aspekte të strehimit të përshtatshëm në mënyrë që të ofrojnë kushte të përmirësuara të jetës në zonën e rivendosjes, sidomos për ata që nuk kanë të drejta ose pretendime të njohura me ligj mbi tokën që kanë zënë.

¹⁰ Zona e rivendosjes ofron sigurimin e të drejtave mbi tokën nëse i mbron, sa më shumë të jetë e mundur, personat e rivendosur nga dëbimi me forcë.

7. Kërkesat dhe përgjegjësitë kundrejt personave të zhvendosur pa të drejta ose pretendime të njohura ligjore mbi tokën që kanë në shfrytëzim jepen në pikat 18, 32 dhe 37 më poshtë.
8. Ky kriter performance nuk zbatohet për shpërnguljen që vjen nga veprimet vullnetare me tokën (veprimet e tregut në të cilat shitësi nuk është i detyruar të shesë dhe blerësi nuk mund të përdorë si rrugë të fundit shpronësimin apo procedura të tjera të detyrueshme nëse negociimi del me sukses) dhe kur një veprim i tillë prek vetëm personat me të drejta ligjore.
9. Zbatueshmëria e këtij kriteri performance duhet të përcaktohet gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social sipas kriterëve të parashtruara në pikat 6-8 më lart. Kur shpërngulja e detyrueshme ka ndodhur që më parë, vlerësimi duhet të identifikojë: i. çdo boshllëk; dhe ii. masat korrigjuese që mund të jenë të nevojshme për të siguruar përmbushjen e këtij kriteri performance. Në këtë rast duhet miratuar një plan veprimi.

Kërkesat

10. Nxiten klientët t'i marrin të drejtat mbi tokën përmes marrëveshjeve të negociuara, edhe sikur t'i kenë mjetet juridike për ta marrë të drejtën e përdorimit të tokës pa pëlqimin e shitësit. Marrëveshjet e negociuara ndihmojnë në shmangien e shpronësimit dhe eliminojnë nevojën për të përdorur autoritetin shtetëror për lëvizjen e njerëzve me forcë. Zgjidhjet me negociim zakonisht mund të arrihen duke ofruar kompensim të drejtë dhe të duhur, stimuj ose përfitime të tjera personave ose komuniteteve të prekura dhe duke i zbutur rreziqet e asimetrisë së informimit dhe të fuqisë negociuese.

Shmangia ose minimizimi i zhvendosjes

11. Klienti duhet të mendojë plane alternative të realizueshme të projektit ose të paktën të minimizojë zhvendosjen fizike dhe/ose ekonomike, duke vënë në drejtpeshim kostot dhe përfitimet mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Konsultimet

12. Që në fazat më të hershme e deri te veprimtaritë e shpërnguljes klienti duhet të përfshijë burrat dhe gratë e prekura, përfshi dhe komunitetet pritëse. Kjo do të lehtësojë pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse të lidhura me shpërnguljen që në fazat e hershme e të bazuar në informimin tyre, dhe në KP 10:
 - personave të prekur u duhet dhënë mundësia të marrin pjesë në kërkesat që duhen përmbushur, në bisedimet e paketave të kompensimit, asistencën për shpërnguljen, përshtatshmërinë e vendeve të propozuara ku do të bëhet rivendosja dhe koha e propozuar
 - kërkesa të tjera shtesë zbatohen për konsultimet me popujt indigjenë (siç parashikohet në KP 7) si edhe me individët që u përkasin grupeve më të ndjeshme¹¹
 - konsultimi duhet të vazhdojë gjatë zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të pagesave të kompensimit dhe të shpërnguljes në mënyrë që të arrihen rezultate në përputhje me objektivat e këtij kriteri performance.

¹¹ Në kuptim të kësaj Politike, grupet e ndjeshme janë ata persona të cilët, për shkak të identitetit gjinor, moshës, aftësive të kufizuara, pozitës së pafavorshme ekonomike apo statusit shoqëror mund preken më negativisht nga ndikimet e projektit në krahasim me të tjerët dhe të cilët mund ta kenë të kufizuar mundësinë për të kërkuar të drejtat e tyre apo për të marrë përfitimet e projektit. Individët dhe/ose grupet më të ndjeshme mund të përfshijnë edhe personat që jetojnë nën kufirin e varfërisë, personat pa tokë, të moshuarit, familjet me kryefamiljare gra ose fëmijë, refugjatët, personat e shpërngulur brendapërbrenda vendit, pakicat kombëtare, komunitetet që varen nga burimet natyrore ose çdo person tjetër të zhvendosur që mund të mos mbrohet nga legjislati kombëtar dhe/ose ndërkombehtar.

13. Klienti duhet të marrë në konsideratë çdo individ ose grup të pafavorizuar ose më të ndjeshëm. Në veçanti, klienti duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar që grupet më të ndjeshme të mos vendosen në pozita të pafavorshme gjatë procesit të shpërnguljes, të jenë plotësisht të informuar dhe të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe të jenë në gjendje të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga mundësitë dhe përfitimet e shpërnguljes. Rekomandohet që këto grupe të identifikohen përmes procesit të vlerësimit mjedisor dhe social (siç përshkruhet në KP 1).

Vlerësimi dhe regjistrimi social-ekonomik

14. Klienti duhet të realizojë një vlerësim social-ekonomik të situatës fillestare për njerëzit e prekur nga projekti, përfshi edhe ndikimet e lidhura me marrjen e tokës dhe kufizimet e vendosura mbi përdorimin e tokës. Vlerësimi duhet të identifikojë ndikimet brenda kuadrit social të projektit dhe nevojat dhe të drejtat e njerëzve të prekur dhe të hartojë masat e duhura për të minimizuar dhe zbutur ndikimet e shpërnguljes.
15. Klienti duhet të realizojë një regjistrim të hollësishëm: i. për të identifikuar personat që do të zhvendosen nga projekti; ii. për të përcaktuar se kush ka të drejtë të përfitojë kompensim dhe asistencë; dhe iii. për të bërë një inventar të tokave dhe pasurive të prekura. Ky rregjistrim i përgjithshëm duhet të marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve sezonalë të burimeve, të cilët mund të jenë të pranishëm në zonën e projektit gjatë kohës kur bëhet rregjistrimi.
16. Në mungesë të procedurave të veçanta shtetërore kombëtare, klienti duhet të vendosë një datë-kufi për të drejtën për të përfituar, siç parashikohet në legjislacionin e zbatueshëm dhe afatet e projektit, sipas rastit. Shpesh data-kufi më me vlerë praktike është gjatë vlerësimit të situatës fillestare ose rregjistrimit. Informacioni në lidhje me datën-kufi duhet të dokumentohet mirë dhe të komunikohet në të gjithë zonën e projektit. Vendosja e një date-kufi duhet të ofrojë dhe transparencë lidhur me kriteret e përfitimit të kompensimit dhe të asistencës. Personat që zhvendosen në vendndodhjen e projektit pas datës-kufi nuk kanë të drejtë të përfitojnë kompensim apo asistencë të ndonjë lloji tjetër.

Kompensimi për personat e shpërngulur

17. Klienti duhet t'u ofrojë të gjithë personave dhe komuniteteve të shpërngulura kompensim për humbjen e aktiveve me vlerën e kostos së plotë të zëvendësimit¹² dhe t'u ofrojë asistencë. Kjo bëhet me qëllim rivendosjen dhe, kur është e mundur, përmirësimin e standardeve dhe/ose mjeteve të jetesës së personave të zhvendosur në nivelet përpara zhvendosjes. Masat mund të bazohen tek toka, burimet, pagat dhe/ose veprimtaritë tregtare. Standardet për kompensimin duhet të jenë transparente dhe të njëtrajtshme brenda projektit. Kompensimi duhet të jepet përpara shpërnguljes ose vendosjes së kufizimeve mbi përdorimin. Kur jetesa e personave të shpërngulur mbështeten tek toka, ose kur toka është në pronësi kolektive, klienti duhet të ofrojë, kur është e realizueshme, kompensim të mbështetur në tokë, duke marrë në konsideratë kërkesat sezonale dhe ato kohore bujqësore. Klienti duhet t'u japë mundësi personave dhe komuniteteve të shpërngulura të marrin përfitimet e duhura nga projekti i zhvilluar.

¹² Shkalla e kompensimit për aktivet e humbura duhet të llogaritet me koston e plotë të zëvendësimit, përfshi koston e transaksionit. Për humbjet që nuk mund të vlerësohen me lehtësi apo të kompensohen në formë monetare, mund të jetë i përshtatshëm kompensimi në natyrë. Mirëpo, ky kompensim duhet bërë me mallra ose burime me vlerë të barazvleshme ose më të madhe dhe që janë të përshtatshme nga ana kulturore. Shih shënimet 7 dhe 14.

18. Personat e zhvendosur mund të klasifikohen si persona: i. të cilët kanë të drejta ligjore zyrtare mbi tokën (përfshi edhe të drejta zakonore dhe tradicionale të njohura sipas ligjeve kombëtare); ii. të cilët nuk kanë të drejta ligjore zyrtare mbi tokën në momentin e rregjistrimit, por që kanë pretendime mbi tokën të cilat njihen ose janë të njohura sipas ligjeve kombëtare; ose iii. të cilët nuk kanë të drejta apo pretendime të njohura ligjore mbi tokën që kanë në përdorim.
19. Dokumentacioni për pronësinë ose shfrytëzimin, siç janë tapitë apo kontratat e qirasë (përfshi edhe llogaritë bankare të krijuara për pagimin e kompensimit) duhet të lëshohen në emër të të dy bashkëshortëve ose të kryefamiljarit, sipas rastit. Asistencat e tjera, si trajnimi për zotësi pune, mundësia për kreditim dhe për punësim u duhen vendosur njësoj në dispozicion si burrave ashtu edhe grave dhe duhen përshtatur sipas nevojave të tyre.
20. Klienti duhet të mendojë mundësinë e ofrimit të metodave dhe/ose modaliteteve alternative për kompensim, sidomos në vendet dhe rajonet ku gratë kanë më pak gjasa të kenë mundësi përdorimi të institucionevezyrtare financiare dhe/ose të kenë llogari bankare. Në rrethanat ku legjislacioni kombëtar dhe sistemet e të drejtave mbi pronën nuk i njohin të drejtat e grave për të mbajtur apo këmbyer prona, duhen marrë masa për të siguruar, sa më shumë të jetë e mundur, që grave t'u mundësohet e drejta e tyre mbi pronën.

Mekanizmi për ankesat

21. Klienti duhet të ngrejë një mekanizëm të efektshëm për ankesat që në fazat e hershme të procesit. Mekanizmi duhet të jetë në përputhje me këtë kriter performance dhe me objektivat dhe parimet e kriterit KP 10, në mënyrë që të marrë dhe të trajtojë në kohë shqetësimet e veçanta për kompensimin dhe rivendosjen, të cilat i ngrenë personat e zhvendosur dhe/ose anëtarët e komuniteteve pritëse. Ai duhet të përfshijë një mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të paanshme.

Kuadri për shpërnguljen dhe/ose rivendosjen e mjeteve të jetesës

22. Duhet të hartohet një kuadër për shpërnguljen dhe/ose rivendosjen e mjeteve të jetesës kur nuk mund të dihet, për shkak të fazës së zhvillimit të projektit, natyra e saktë ose shkalla e marrjes së tokës apo e kufizimeve mbi përdorimin e tokës lidhur me një projekt që mund të shkaktojë zhvendosje fizike dhe/ose ekonomike. Ky kuadër duhet të parashtrojë parimet e përgjithshme, procedurat dhe kuadrin e kriterëve të përfitimit në përputhje me këtë kriter performance. Pasi të jenë përcaktuar komponentët e veçantë të projektit dhe pasi të jetë i gatshëm informacioni i nevojshëm, kuadri duhet të shërbejë si bazë për hartimin me hollësi të një Plani Veprimi të Shpërnguljes (PVSH) ose Plani të Rivendosjes së Mjeteve të Jetesës (PRMJ) në përputhje me pikat 26-39, më poshtë.

Monitorimi

23. Monitorimi i procesit të shpërnguljes dhe i rivendosjes së mjeteve të jetesës duhet të realizohet në përputhje me KP 1 dhe duhet të jetë me pjesëmarrjen e palëve kyçe të interesit, siç janë komunitetet e prekura.
24. Në varësi të shkallës së shpërnguljes në një projekt, mund të duhet që klienti të kërkojë realizimin e një raporti të jashtëm mbi PVSH/PRMJ-në për të konstatuar nëse janë përmbushur masat e përcaktuara. Raporti duhet të ndërmerret pasi të kenë përfunduar të gjithë komponentët e procesit, përfshi edhe nismat për zhvillim, nëse ka. Raporti mund të identifikojë veprimet e mëtejshme që duhet të kryejë klienti. Në shumicën e rasteve, kryerja e masave korrigjuese të identifikuar nga raporti përfundimtar duhet t'u japë fund

detyrimeve të klientit për shpërnguljen, kompensimin, rivendosjen e mjeteve të jetesës dhe përfitimet nga zhvillimi.

Shpërnguljet

25. Marrja e tokës dhe/ose kufizimet mbi përdorimin e tokës të lidhura me projektin shpesh sjellin zhvendosjen fizike të njerëzve, si dhe zhvendosjen ekonomike të tyre. Prandaj, kërkesat e këtij kriteri performance në lidhje me zhvendosjen fizike dhe ekonomike mund të zbatohen njëkohësisht. Në një rast të tillë, kërkesat e veçanta lidhur me zhvendosjen ekonomike të parashikuara në pikat 36-39 duhet të përfshihen, përkatësisht, në planet ose kuadrin e veprimit të rivendosjes.

Zhvendosja fizike

26. Kur bëhen veprimet e përshkruara në pikën 6, që kërkojnë lëvizjen fizike të njerëzve, klienti duhet të hartojë një PVSH i cili, minimalisht, të mbulojë kërkesat e zbatueshme të parashtruara në këtë kriter performance, pavarësisht numrit të njerëzve që preken. Plani duhet të ndërtohet për të minimizuar ndikimet negative të zhvendosjes, për të identifikuar përfitimet e mundshme dhe për të përcaktuar të drejtat e përfitimit për të gjitha kategoritë e personave të prekur (përfshi komunitetet pritëse), duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të personave më të ndjeshëm. Plani duhet të dokumentojë të gjitha procedurat për marrjen e të drejtave mbi tokën, si dhe masat e kompensimit dhe veprimtaritë e zhvendosjes. Ai duhet të vendosë procedurat për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e veprimtarive të shpërnguljes dhe për të marrë masat korrigjuese sipas nevojës.
27. Qëllimi dhe niveli i detajimit të PVSH-së varet nga madhësia e zhvendosjes dhe kompleksiteti i masave të nevojshme për të zbutur ndikimet e padëshirueshme. Në të gjitha rastet, ai duhet të përshkruajë mënyrat dhe mjetet me të cilat do të arrihen objektivat e këtij kriteri performance.
28. PVSH-ja duhet të përfshijë masa për t'u dhënë personave të zhvendosur asistencë ligjore që të plotësojnë kërkesat administrative përpara marrjes së tokës dhe, nëse është nevoja, për t'u drejtuar gjykatës.
29. Klienti duhet të konsultohet me personat e prekur gjatë përgatitjes së PVSH-së dhe duhet të bëjë një përmbledhje të informacionit që përmban PVSH-ja për t'ia bërë të ditur publikut, në mënyrë që njerëzit e prekur t'i kuptojnë procedurat e kompensimit dhe të dinë çfarë të presin në fazat e ndryshme të projektit (për shembull, kur t'u bëhet një ofertë, çfarë afati kanë për t'u përgjigjur, cilat janë procedurat e ankimit, procedurat ligjore që duhen ndjekur nëse dështojnë negociimet).
30. Nëse njerëzit që banojnë në zonën e projektit duhet të zhvendosen në një vendndodhje tjetër, klienti duhet: i. t'u ofrojë personave të zhvendosur mundësi të zgjedhin mes mundësive të ndryshme të realizueshme të shpërnguljes, përfshi dhe strehim zëvendësues të përshtatshëm ose kompensim në të holla sipas rastit; dhe ii. të ofrojë asistencë për zhvendosjen sipas nevojave të secilit grup të personave të shpërngulur, duke treguar vëmendje të veçantë për nevojat e personave të varfër dhe më të ndjeshëm. Strehimi alternativ dhe/ose kompensimi në të holla duhet të bëhen përpara zhvendosjes. Zonat e tjera të rivendosjes, të ndërtuara për personat e shpërngulur, duhet të ofrojnë, si minimum, kushtet e jetesës përpara shpërnguljes dhe kur është e arritshme, mundësi të qëndrueshme në kohë dhe me kosto efektive për ta rritur standardin e jetesës.

31. Në rastin e personave të zhvendosur fizikisht sipas pikës 18, nënpika i dhe ii, klienti duhet të ofrojë mundësinë për të zgjedhur pronë zëvendësuese me vlerë të barabartë ose më të lartë, ose kompensim në të holla me vlerën e plotë të zëvendësimit, sipas rastit.¹³
32. Në rastin e personave të zhvendosur fizikisht sipas pikës 18, nënpika iii, klienti duhet t'u ofrojë të zgjedhin mes mundësive për strehim të përshtatshëm, me të drejta të sigurta mbi pronën, në mënyrë që të zhvendosen ligjërisht, pa iu dashur të përballen me rrezikun e dëbimit nga shtëpia.
- Kompensimi në natyrë duhet të ofrohet në vend të kompensimit në të holla aty ku është e realizueshme, nëse nuk mund të dëshmohet se ekzistojnë kushtet e përshkruara në poshtëshënimin nr.14. Kjo vlen për ata persona të cilët kanë të drejta zakonore dhe tradicionale të njohura sipas ligjeve të vendit; për pretenduesit të cilët, përpara datës-kufi nuk kanë të drejta ligjore zyrtare mbi tokën, por kanë pretendime mbi një tokë apo aktive të tilla, për shembull përmes parashkrimit fitues;¹⁴ dhe, në varësi të kualifikimeve të shënuara në pikën 18, për ata që nuk kanë asnjë të drejtë ligjore apo pretendim të njohur mbi tokën që kanë në shfrytëzim.
 - Në bazë të konsultimeve me personat e zhvendosur, klienti duhet të japë asistencë për zhvendosjen, të mjaftueshme që ata të rivendosen dhe, kur mundet, të përmirësojnë standardet e jetesës në një vendndodhje alternative të përshtatshme..¹⁵
33. Në rastet kur personat e prekur i kthejnë mbrapsht ofertat për kompensim, që i përmbushin kërkesat e këtij kriteri performance dhe, për pasojë, kanë filluar procedurat e shpronësimit ose procedura të tjera ligjore, klienti duhet të shqyrtojë mundësitë për të bashkëpunuar me autoritetin shtetëror përgjegjës dhe, nëse ia lejon ky autoritet, të luajë një rol aktiv në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e shpërnguljes.
34. Klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet e mundshme të padëshirueshme tek komunitetet pritëse, të cilët mund të preken nga procesi i shpërnguljes. Çdo masë zbutëse e miratuar me komunitetin pritës duhet të përfshihet në PVSH.
35. Kur duhen zhvendosur komunitetet e popujve indigjenë nga tokat e përbashkëta, që kanë pasur në përdorim tradicionalisht ose me të drejtë zakonore, klienti duhet të përmbushë kërkesat e zbatueshme të këtij kriteri performance, si dhe kërkesat e zbatueshme të kriterit KP 7.

Zhvendosja ekonomike

36. Në rastin e veprimeve të përshkruara në pikën 6, që kërkojnë vetëm zhvendosjen ekonomike, klienti duhet të hartojë dhe të zbatojë një PRMJ. PRMJ-ja duhet të përcaktojë të drejtat e përfitimit të personave dhe të komuniteteve të prekura dhe duhet të sigurojë që këto të jepen në mënyrë transparente, të njëtrajtshme dhe në pozita të barabarta.

¹³ Pagimi i kompensimit në të holla për aktivet e humbura mund të jetë i përshtatshëm kur: i. jetesa nuk mbështetet në tokë; ii. jetesa mbështetet në tokë por toka e marrë për projektin është një pjesë e vogël e aktivitetit të prekur dhe pjesa tjetër e mbetur e tokës është e shfrytëzueshme ekonomikisht; ose iii. ekzistojnë tregje aktive për tokën, banesat dhe krahun e punës, personat e zhvendosur i përdorin këto tregje dhe ka ofertë të mjaftueshme toke dhe banesash. Nivelet e kompensimit në të holla duhet të jenë të mjaftueshme për ta zëvendësuar tokën dhe pasuritë e tjera të humbura me koston e plotë të zëvendësimit, në tregjet lokale. Shih edhe shënimet 7 dhe 12.

¹⁴ Një mënyrë e marrjes së titullit mbi pasurinë e paluajtshme përmes parashkrimit të një periudhe kohore, me disa kushte të caktuara.

¹⁵ Rivendosja e banorëve informalë në zona urbane shpesh ka të mirat dhe të këqijta e veta. Për shembull, familjet e rivendosura mund të fitojnë siguri të drejtave mbi pronën, por mund të humbasin avantazhet e vendndodhjes.

37. Nëse një veprim që bie tek llojet e përkohshme ose të përhershme të të ardhurave ose mjeteve të jetesës, për shembull përmes ndërprerjes ose eliminimit të mundësisë së një personi për të pasur punësim apo për të përdorur aktivitetet e prodhimit, pavarësisht nëse personat e prekur zhvendosen apo jo fizikisht, klienti duhet:
- të kompensojë menjëherë ekonomikisht personat e zhvendosur, për humbjen e aktiveve ose të mundësisë për të përdorur aktivitetet. Ky proces duhet të fillohet përpara zhvendosjes. Kur kompensimi duhet paguar nga një agjenci shtetërore përgjegjëse, klienti duhet të bashkëpunojë me agjencinë për të ndihmuar në përshtetimin e pagesave.
 - të kompensojë, në rastet kur marrja e tokës prek strukturat tregtare, pronarin e aktivitetit tregtar të prekur: i. për koston e rithemelimit të veprimtarive tregtare gjatë; ii. për humbjen e të ardhurave neto gjatë periudhës kalimtare; dhe iii. për kostot e transferimit dhe të riinstalimit të impiantit, makinerive apo pajisjeve të tjera, sipas rastit.
 - T'u ofrojë pronë zëvendësuese (për shembull, vendndodhjet bujqësore ose tregtare) me vlerë të barabartë ose më të madhe, ose kompensim në të holla për koston e plotë të zëvendësimit, sipas rastit, personave me të drejta ose pretendime ligjore mbi tokën të cilat njihen ose janë të njohura sipas ligjeve kombëtare (siç parashikohet në pikën 18, nënpika i dhe ii).
 - të japë asistencë që do të kompensojë çdo humbje të burimeve të përdorura bashkërisht të një komuniteti.¹⁶ Kjo mund të marrë formën e nismave që nxisin produktivitetin e burimeve të mbetura, të cilat mund të përdorë komuniteti, të kompensimit në natyrë ose në të holla për humbjen e mundësisë së përdorimit të burimeve alternative për burimet e humbura.
 - të kompensojë ekonomikisht personat e zhvendosur të cilët kanë pretendime të njohura ligjorisht mbi tokën (shih pikën 18, nënpika iii) për aktivete humbura (siç janë kulturat bujqësore, infrastruktura e ujitjes dhe përmirësimet e tjera që i bëhen tokës) përveç tokës, me koston e plotë të zëvendësimit. Klientit nuk i kërkohet të kompensojë apo të asistojë oportunistët që zaptojnë tokë në zonën e projektit pas datës-kufi.
 - të ofrojnë asistencë shtesë me objekt të përcaktuar mirë (për shembull, linja kreditimi, trajnim ose mundësi punësimi) dhe mundësi për të rivendosur dhe, kur mundet, për të përmirësuar kapacitetin e nxjerrjes së të ardhurave, nivelet e prodhimit dhe standardet e jetesës. Në rastin e veprimtarive tregtare që vuajnë humbje të përkohshme ose që u duhet të mbyllën si pasojë e zhvendosjes lidhur me projektin, si pronari i biznesit ashtu edhe punonjësit që humbin pagën ose vendin e punës, kanë të drejtë të përfitojnë një asistencë të tillë.
 - të japin mbështetje kalimtare për personat e zhvendosur ekonomikisht, sipas nevojës, në bazë të një vlerësimi të arsyeshëm të kohës që nevojitet për të rivendosur kapacitetin e nxjerrjes së të ardhurave, niveleve të prodhimit dhe standardeve të jetesës.
38. Klienti duhet të bëjë një përmbledhje të informacionit që përmban PRMJ-ja për t'ia bërë të ditur publikut, në mënyrë që njerëzit e prekur t'i kuptojnë procedurat e kompensimit dhe të dinë çfarë të presin në fazat e ndryshme të projektit.
39. Kur komunitetet e popujve indigjenë zhvendosen ekonomikisht (por jo fizikisht) si pasojë e marrjes së tokës në lidhje me projektin, klienti duhet të përmbushë kërkesat e zbatueshme të këtij kriteri performance, si dhe kërkesat e zbatueshme të kriterit KP 7.

¹⁶ Disa shembuj janë kullotat, pyjet jo të përdorura për lëndë drusore (për shembull, për bimë mjekësore, lëndë ndërtimi dhe lëndë artizanati), parcelat për lëndë drusore dhe dru zjarri; burimet ujore për bujqësi, zbatimje ose peshkim.

Humbja e shërbimeve publike¹⁷

40. Kur një projekt përfshin humbjen e shërbimeve publike, klienti duhet të ndërmarrë konsultime të plota, në përputhje me KP 10, me komunitetin e prekur në nivel lokal, për të identifikuar dhe, kur është e mundur, për të miratuar një alternativë të përshtatshme.

Përgjegjësitë e sektorit privat në kuadër të shpërnguljeve të menaxhuara nga shteti

41. Mund të ketë raste kur marrja e tokës dhe shpërngulja janë përgjegjësi e qeverisë pritëse. Në raste të tilla, klienti duhet të bashkëpunojë me agjencinë shtetërore përgjegjëse, për aq sa e lejon agjencia, për të arritur rezultate në përputhje me objektivat e këtij kriteri performance. Gjithashtu, kur kapaciteti shtetëror është i kufizuar, klienti duhet të luajë një rol aktiv gjatë planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të shpërnguljes. Klienti duhet të përgatisë një plan (ose një kuadër) i cili, bashkë me dokumentet e përgatitura nga agjencia shtetërore përgjegjëse, duhet të përmbushë kërkesat e këtij kriteri performance. Klienti mund të duhet të përfshijë në planin e tij: i. një përshkrim të të drejtave për përfitim të personave të zhvendosur, parashikuar nga aktet ligjore dhe nënligjore të zbatueshme; ii. masat e propozuara për të kapërcyer çdo boshllëk midis të drejtave të tilla për përfitim dhe kërkesave të këtij kriteri performance; dhe iii. përgjegjësitë financiare dhe zbatuese të agjencisë shtetërore dhe/ose klientit.

¹⁷ Humbja e trashëgimisë kulturore mbulohet në kriterin PR 8.

Kriteri i Performancës nr. 6 i BERZH-it:

Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

Hyrje

1. Ky kriter performance pranon se ruajtja e biodiversitetit¹ dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore² janë themelore për qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale.
2. Ky kriter performance njeh rëndësinë e ruajtjes së funksioneve ekologjike bazë të ekosistemeve dhe të biodiversitetit që ato mbështetin. Të gjitha ekosistemet mbështetin një kompleksitet organizmesh të gjalla dhe ndryshojnë sa i takon pasurisë, sasisë dhe rëndësisë së llojeve.
3. Objektivi i ruajtjes së biodiversitetit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve duhet të vihet në drejtpeshim me mundësinë për shfrytëzimin në mënyrë optimale të vlerave të shumta ekonomike, sociale dhe kulturore të biodiversitetit dhe të burimeve natyrore.
4. Pranohej se: i. mjetet e jetesës të popujve indigjenë dhe të komuniteteve të prekura, për të cilët veprimtaritë e projektit mund të prekin mundësinë e përdorimit ose përdorimin e biodiversitetit ose të burimeve natyrore; dhe ii. ata mund të kenë një rol pozitiv për të luajtur në ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Objektivat

5. Objektivat e këtij kriteri performance janë:
 - mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit duke përdorur një qasje të kujdesshme
 - ndjekja e një qasjeje me shkallë zbutëse,³ me qëllim që të mos ketë humbje neto të biodiversitetit dhe, sipas rastit, të ketë një fitim neto të biodiversitetit
 - nxitja e praktikës së mirë ndërkombëtare në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve natyrore.

Ruajtja e biodiversitetit

Fusha e zbatimit

6. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të këtij kriteri performance dhe mënyrën si do të trajtohen dhe menaxhohen ato përgjatë gjithë ciklit të jetës së projektit. Zbatimi i veprimeve të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri performance duhet të menaxhohet në kuadër të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) të klientit dhe Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) sipas projekteve, përfshi Planet e menaxhimit të biodiversitetit, ose sipas rastit, një Plan veprimi të biodiversitetit,⁴ për ta strukturuar projektin në mënyrë të atillë që të përmbushë këtë kriter

¹ Në kuptim të këtij kriteri performance, biodiversiteti përkufizohet sipas Konventës për biodiversitetin biologjik si “larmia mes organizmave të gjallë nga të gjitha burimet, që përfshijnë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike pjesë e të cilave janë; kjo përfshin diversitetin brenda llojeve, ndërmjet llojeve dhe ndërmjet ekosistemeve e peizazheve”.

² “Burimet natyrore” përkufizohen si “bimë dhe kafshë të kultivuara për përdorim dhe konsum nga njerëzit dhe kafshët, pavarësisht nëse janë në gjendje të lirë apo të kultivuar. Këtu përfshihen të gjitha llojet e pylltarisë, biokarburantet, bujqësia, përfshi kulturat njëvjeçare dhe shumëvjeçare, si dhe blegtoria; gjithashtu dhe peshkun e egër dhe atë të kapur, përfshi të gjitha organizmat e detit dhe të ujërave të ëmbla, vertebrorë ose jo”.

³ Shkalla zbutëse përfshin masat e marra për të shmangur e ndikimet në biodiversitet që në fillim të veprimtarive të zhvillimit, dhe kur kjo nuk është e mundur, për të zbatuar masa të tjera shtesë që do të minimizonin, të zbusnin dhe, si zgjidhje të fundit, të kompensonin çdo ndikim të mbetur të padëshirueshëm.

⁴ Planet e veprimit në biodiversitet (PVB) normalisht përfshijnë një sërë qëllimesh, objektivash dhe masash administruese për të zbutur ndikimet e mbetura me qëllimin për të mos patur humbje neto/fitime neto të karakteristikave kryesore të

performance brenda një kuadri kohor të pranueshëm. Kërkesat e vlerësimit dhe të menaxhimit mjedisor dhe social jepen në KP 1.

Kërkesa të përgjithshme

Vlerësimi i çështjeve dhe ndikimeve

7. Procesi i vlerësimit duhet të karakterizojë kushtet bazë në atë shkallë që të jetë përpjesëtimore dhe specifike për rrezikun e pritur dhe rëndësinë e ndikimeve. Vlerësimi i situatës fillestare duhet të marrë në konsideratë, ndër të tjera, humbjen e habitatit,⁵ degradimin dhe copëzimin, llojet pushtuese të huaja, mbishfrytëzimin, korridoret e shtegimit, ndryshimet hidrologjike, ngarkesën dhe ndotjen ushqimore, si dhe ndikimet e lidhura me ndryshimet e klimës dhe përshtatjen ndaj tyre. Gjatë planifikimit dhe realizimit të vlerësimeve të situatës fillestare dhe të ndikimeve të lidhura me biodiversitetin, klienti duhet të mbështetet tek praktika e mirë, duke shfrytëzuar qasjes e studimit nga zyra dhe të studimit në terren, sipas nevojës. Kur nevojiten hetime të mëtejshme për të pasur një siguri më të madhe për rëndësinë e ndikimeve të mundshme, klienti duhet të kryejë studime të tjera shtesë dhe/ose monitorime shtesë përpara se të ndër marrë veprimtaritë e lidhura me projektin, të cilat mund të shkaktojnë pasoja të pakthyeshme.
8. Përmes procesit të vlerësimit, klienti duhet të identifikojë dhe të karakterizojë, nga fillimi i ciklit të jetës së projektit, mundësitë, rreziqet dhe ndikimet në biodiversitetin lidhura me projektin. Shkalla e vlerësimit duhet të jetë e mjaftueshme për të karakterizuar ndikimet, në bazë të probabilitetit të tyre dhe në bazë të rëndësisë dhe shkallës së ndikimit, dhe duhet të pasqyrojë shqetësimet e komuniteteve që mund të preken dhe, kur ka, edhe të palëve të tjera të interesit. Vlerësimi duhet të shikojë edhe ndikimet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe progresive dhe të vlerësojë efektivitetin dhe realizueshmërinë e masave zbutëse që do të zbatohen për projektin. Procesi i vlerësimit duhet të përfshijë marrjen në konsideratë të ndikimeve të mundshme në nivel peizazhi, si edhe ndikimet mbi paprekshmërinë ekologjike të ekosistemeve, pavarësisht statusit të tyre mbrojtës dhe pavarësisht shkallës së prekjës ose degradimit të tyre.
9. Vlerësimi duhet të marrë në konsideratë përdorimin dhe vartësinë tek ekosistemet të komuniteteve dhe/ose popujve indigjenë që mund të preken, ku përdorimi i këtyre burimeve të biodiversitetit mund të preken nga projekti. Vlerësimi duhet të shikojë edhe se cila është varësia e projektit tek këto ekosisteme. Kur projekti ka potencialin për të ndikuar në këto ekosisteme dhe kur klienti ushtron kontroll të drejtpërdrejtë menaxhimi ose ushtron ndikim të konsiderueshëm, duhen shmangur ndikimet e padëshirueshme. Nëse këto ndikime nuk mund të shmangen, klienti duhet t'i minimizojë dhe/ose të zbatojë masat e duhura zbutëse me qëllim ruajtjen e funksionalitetit të përgjithshëm të këtyre ekosistemeve.
10. Për projektet që mund të kenë ndikime të tilla të mundshme tek popujt indigjenë dhe tek komunitetet vendore, klienti duhet të ofrojë mundësi për ndarje të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që vijnë nga shfrytëzimi i burimeve natyrore, në përputhje me: i. kërkesat për trajtimin e çështjeve të zhvendosjes ekonomike, të KP 5; ii. kërkesat e veçanta në lidhje me menaxhimin e çështjeve dhe ndikimeve të mundshme për popujt indigjenë, të KP 7; dhe iii. kërkesat për angazhimin e palëve të interesit, të parashikuara në KP 10.

Kërkesat për ruajtjen e biodiversitetit

biodiversitetit ose të habitateve kritike. Qëllimet/objektivat duhet të jenë realiste dhe të mbështetura në plane të matshme. Secili objektivi duhet të përcaktojë një seri veprimesh dhe të përfshijë treguesit e përfundimit ose objektivat e monitorimit, si dhe palën përgjegjëse dhe afatin kohor. PVB-të të përgatiten në konsultim me palët përkatëse të interesit, përfshi qeverinë, ekspertët e jashtëm, organizatat vendore/ndërkombëtare të ruajtjes së biodiversitetit dhe komunitetet e prekura nga projekti.

⁵ Habitatat përkufizohet si një njësi gjeografike tokësore, ujëra të ëmbla ose detare ose si korridor ajror që mbështet një tërësi organizmesh të gjalla dhe ndërveprimet e tyre me mjedisin jo të gjallë.

11. Kur vlerësimi ka identifikuar ndikime të mundshme të lidhura me projektin që prekin biodiversitetin, klienti duhet t'i menaxhojë rreziqet e tij në përputhje me shkallën e zbutjes dhe praktikën e mirë ndërkombëtare. Klienti duhet të ndjekë një qasje të kujdesshme dhe të zbatojë praktika përshtatëse menaxhimi, në të cilat zbatimi i masave zbutëse dhe menaxhuese reagon sipas ndryshimit të kushteve dhe rezultateve të monitorimit të projektit përgjatë gjithë ciklit të jetës së projektit.
12. Pavarësisht sa më lart, disa aspekte të prekura nga projektin mund të konsiderohen “karakteristika kryesore të biodiversitetit”⁶ ku përfshihen: i. habitatet e rrezikuara; ii. llojet e pambrojtura; iii. karakteristika kryesore të biodiversitetit të identifikuar nga një tërësi e gjerë palësh interesi ose qeverish (siç janë zonat kyçe për biodiversitetin apo zonat me rëndësi për shpendët); dhe iv. struktura dhe funksionet ekologjike të nevojshme për të ruajtur qëndrueshmërinë e karakteristikave kryesore të biodiversitetit, që përshkruhen në këtë pikë.
13. Kur vlerësimi ka përcaktuar se projektin mund të ketë ndikime të konsiderueshme, të padëshirueshme dhe të pakthyeshme mbi karakteristikat kryesore të biodiversitetit, klienti nuk duhet të zbatojë asnjë veprimtari të lidhur me projektin:
 - nëse ka alternativa të tjera teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme
 - nëse përfitimet e përgjithshme nuk janë më të mëdha se ndikimet që ka projektin tek biodiversiteti
 - nëse palët e interesit nuk janë konsultuar në përputhje me KP 10
 - nëse projektin nuk lejohet sipas ligjeve mjedisore në fuqi, që njohin karakteristikat kryesore të biodiversitetit
 - nëse nuk zbatohen masat e duhura zbutëse, në përputhje me shkallën e zbutjes,⁷ për të siguruar që të mos ketë asnjë humbje neto dhe që mundësisht të ketë një fitim neto për karakteristikat kryesore të biodiversitetit në periudhën afatgjatë, për të arritur rezultate të matshme të ruajtjes.
14. Karakteristikat më të ndjeshme të biodiversitetit përkufizohen si habitat kritik, i cili përfshin një prej elementeve sa më poshtë: i. ekosisteme unike ose tejet të rrezikuara; ii. habitate me rëndësi të konsiderueshme për llojet e rrezikuara⁸ ose tejet të rrezikuara; iii. habitate me rëndësi të konsiderueshme për llojet endemike ose gjeografikisht të kufizuara; iv. habitate që mbështetin llojet shtegtare ose tubuese me rëndësi globale; v. zonat e shoqëruara me proceset kyçe të evolucionit; ose v. funksionet ekologjike që janë jetike për të ruajtur qëndrueshmërinë e karakteristikave kryesore të biodiversitetit, që përshkruhen në këtë pikë.
15. Kur vlerësimi ka identifikuar se projektin mund të ketë ndikime të padëshirueshme mbi një habitat me rëndësi kritike, klienti duhet të marrë ekspertë të jashtëm me përvojë për të kryer vlerësimin e ndikimeve të mundshme të padëshirueshme mbi këtë habitat me rëndësi kritike.

⁶ Karakteristikat kryesore për biodiversitetin janë një nënbashkësi e biodiversitetit që është veçanërisht e pazëvendësueshme ose më të ndjeshme, por me një nivel prioriteti më të ulët se habitatet me rëndësi kritike (të përkufizuara në pikën 14).

⁷ Si rrugëzgjdhje e fundit, kur ka ndikime të konsiderueshme të mbetura, klienti mund të duhet të shikojë mundësinë e përdorimit të masave kompensuese, siç janë kompensimet në biodiversitet.

⁸ Sipas Listës së Kuqe të Llojeve të Rrezikuara, të Njësisë Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Përcaktimi i habitatit me rëndësi kritike mbështetet në lista të tjera si më poshtë: i. nëse lloji është në listë kombëtare/rajonale si lloj në rrezik ose në rrezik kritik, në vendet që kanë aderuar në udhëzuesin e IUCN-së, përcaktimi i habitatit kritik duhet të bëhet projekt pas projektin në konsultim me profesionistët kompetentë; dhe ii. në rastet kur kategorizimet e llojeve në listën kombëtare ose rajonale nuk përkojnë saktësisht me ato të IUCN-së (për shembull, disa vende i përcaktojnë llojet më në përgjithësi si “të mbrojtura” ose “të kufizuara”), duhet të kryhet një vlerësim për të përcaktuar arsyetimin dhe qëllimin e përfshirjes në listë. Në këtë rast, përcaktimi i habitatit kritik duhet të mbështetet në një vlerësim të tillë.

16. Habitatit me rëndësi kritike nuk duhet copëzuar, konvertuar apo degraduar më tej deri aty sa të komprometohet tërësia ekologjike ose rëndësia e biodiversitetit. Për pasojë, në zonat me habitat me rëndësi kritike, klienti nuk duhet të zbatojë asnjë veprimtari të projektit nëse nuk janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
- nuk ekzistojnë alternativa të tjera të realizueshme brenda rajonit për zhvillimin e projektit në habitate me vlerë më të ulët biodiversitare
 - palët e interesit janë konsultuar në përputhje me KP 10
 - projektit lejohet sipas ligjeve të zbatueshme mjedisore, që njohin karakteristikat kryesore të biodiversitetit
 - projekti nuk sjell ndikime të padëshirueshme të matshme mbi ato karakteristika të biodiversitetit për të cilat është caktuar habitatit me rëndësi kritike sikurse përshkruhet në pikën 14
 - projekti është planifikuar të realizojë fitime neto⁹ për habitatin me rëndësi kritike që preket nga projekti
 - projekti nuk pritet të çojë në pakësim neto të popullatës¹⁰ të asnjë lloji të rrezikuar apo shumë të rrezikuar, brenda një periudhe kohore të arsyeshme¹¹
 - në programin e menaxhimit përshtatës të klientit duhet integruar një program afatgjatë monitorimi dhe vlerësimi për biodiversitetin, i hartuar me saktësi dhe si duhet, me qëllim vlerësimin e statusit të habitatit me rëndësi kritike.
17. Në raste të tilla, kur një klient është në gjendje të përmbushë kërkesat e parashikuara në pikën 16, strategjia zbutëse e projektit duhet të përshkruhet në një plan për menaxhimin e biodiversitetit ose plan veprimi për biodiversitetin, sipas rastit.
18. Në rastet kur propozohen kompensime të biodiversitetit për karakteristikat kryesore të biodiversitetit ose për habitatin me rëndësi kritike, klienti duhet të dëshmojë përmes një vlerësimi se ndikimet e konsiderueshme të mbetura të projektit tek biodiversiteti do të zbuten në mënyrën e duhur për të përmbushur kërkesat e pikës 13 dhe 15-17, sipas rastit. Në këto raste, klienti duhet të marrë ekspertët të jashtëm, me përvojë e me njohuri në planifikimin dhe zbatimin e kompensimeve.

Zonat e mbrojtura me ligj dhe të njohura ndërkombëtarisht për vlerat e biodiversitetit

19. Kur projekti realizohet brenda një zone ose ka mundësi të ndikojë negativisht në një zonë të mbrojtur me ligj ose me mjete të tjera të efektshme¹² dhe/ose njihet në nivel ndërkombëtar¹³ apo propozohet për një status të tillë nga qeveria në nivel qendror, klienti duhet të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet e mundshme të lidhura me projektin dhe të zbatojë shkallën zbutëse në

⁹ Fitimet neto janë rezultatet shtesë nga ruajtja që mund të arrihen për vlerat e biodiversitetit për të cilat është përcaktuar habitatit kritik. Fitimet neto mund të arrihen përmes zhvillimit të një kompensimi për biodiversitetin dhe/ose, në rastet kur klienti mund të përmbushë kërkesat e pikës 16 të këtij kriteri performance pa një kompensim për biodiversitetin, klienti duhet t'i arrijë fitimet neto përmes zbatimit të programeve që mund të zbatohen në vend (në terren) për ta përmirësuar habitatin dhe për ta mbrojtur dhe ruajtur biodiversitetin.

¹⁰ Pakësimi neto është humbja e vetme ose progresive e individëve që iu pengon llojeve vijimësinë në shkallë botërore dhe/ose rajonale/kombëtare për shumë breza ose gjatë një periudhe të gjatë kohore. Shkalla (për shembull, globale dhe/ose rajonale/kombëtare) e pakësimit të mundshëm neto përcaktohet në bazë të renditjes së llojeve në Listën e Kuqe (botërore) të Llojeve të Rrezikuara të IUCN-së dhe/ose në listat rajonale/kombëtare. Për llojet e renditura edhe në Listën e Kuqe (botërore) të Llojeve të Rrezikuara të IUCN-së edhe në listat rajonale/kombëtare, pakësimi neto duhet të mbështetet në popullatën kombëtare/rajonale.

¹¹ Afati kohor, brenda të cilit klientët duhet të dëshmojnë se “nuk ka pakësim neto” të llojeve shumë të rrezikuara dhe të rrezikuara duhet të përcaktohet rast pas rasti dhe në konsultim me ekspertët e jashtëm.

¹² Ky kriter performance orientohet nga përkufizimi i IUCN-së për “Zonat e mbrojtura”.

¹³ Zonat e identifikuara sipas konventave apo marrëveshjeve ndërkombëtare, përfshi, ndër të tjera, Zonat e Trashëgimisë Natyrore Botërore e UNESCO-s, Rezervatet “Njeriu dhe biosfera” të UNESCO-s dhe Lista e Ramsarit për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare.

mënyrë të atillë që ndikimet e projektit të mos e komprometojnë tërësinë e zonës, objektivat e ruajtjes dhe/ose rëndësinë e biodiversitetit të kësaj zone.

20. Nëse vlerësimi identifikon se projekti ka potencialin për të prekur negativisht karakteristikat kryesore të biodiversitetit dhe/ose habitatin me rëndësi kritike brenda zonave të mbrojtura me ligj ose të njohura në nivel ndërkombëtar si zona me vlerë për biodiversitetin, klienti duhet të kërkojë t'i shmangë këto ndikime, përkatësisht në përputhje me pikat 13 ose 15-17. Gjithashtu, klienti duhet:
- të tregojë se çdo zhvillim i propozuar lejohet me ligj, ku mund të theksohet se një vlerësim i veçantë i ndikimeve të lidhura me projektin në zonat e mbrojtur është kryer sipas legjislacionit kombëtar
 - të veprojë në përputhje me planet e menaxhimit të njohura nga qeveria për këto zona
 - të konsultohet me menaxherët e zonave të mbrojtura, autoritetet përkatëse, komunitetet vendore dhe palët e tjera të interesit për projektin e propozuar, në përputhje me KP 10
 - të zbatojë programe shtesë, sipas rastit, për të nxitur dhe përmirësuar objektivat e ruajtjes së zonës së mbrojtur.

Llojet e huaja pushtuese

21. Klienti duhet të shmangë dhe të parandalojë futjen, pa dashje ose me dashje, të llojeve të huaja, që mund të kenë ndikime të konsiderueshme të padëshirueshme në biodiversitet, dhe konkretisht:
- klienti nuk duhet të fusë me dashje lloje të huaja në zonat ku nuk gjenden normalisht, nëse kjo nuk bëhet në përputhje me kuadrin rregullator që rregullon një gjë të tillë. Në asnjë rrethanë nuk duhen futur në mjedise të reja lloje që njihen si pushtuese
 - klienti duhet të identifikojë rreziqet, ndikimet dhe mundësitë e zbutjes të lidhura me kalimin pa dashje ose çlirimin pa dashje të llojeve të huaja¹⁴
 - kur llojet e huaja janë vendosur që më parë në vendin ose rajonin e projektit të propozuar, klienti duhet të tregojë korrektesën e duhur për të mos i përhapur llojet pushtuese në zonat ku nuk janë vendosur ende. Sipas mundësive, klienti duhet të marrë masa për t'i zhdukur llojet e tilla nga zonat me rëndësi për biodiversitetin, mbi të cilat kanë kontroll menaxhimi.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

Fusha e zbatimit

22. Ky kriter performance zbatohet për projektet që përfshijnë prodhimin kryesor të burimeve natyrore ose kur ky lloj burimi është thelbësor për funksionin bazë të projektit.¹⁵
23. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të këtij kriteri performance dhe mënyrën se si do të trajtohen dhe do të menaxhohen ato përgjatë ciklit të jetës së projektit. Klienti duhet të miratojë dhe të zbatojë masa për të përmbushur këtë kriter performance, në kuadër të SMMS-së dhe/ose PMMS-së së klientit. Kërkesat e vlerësimit dhe të menaxhimit mjedisor dhe social jepen në KP 1.

Kërkesat

¹⁴ Sa i takon transportit ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, ky kriter performance bazohet në Konventën Ndërkombëtare për Kontrollin dhe Menaxhimin e Ujit e balastës dhe Sedimenteve të Anijeve. Klientët që kërkojnë financim nga BERZH-i për një projekt që përfshin veprimtari të tilla transporti d të përmbushin detyrimet e duhura që rrjedhin nga kjo konventë.

¹⁵ Projektet që përfshijnë prodhim bujqësor ose blegtoral, pylltari natyrore ose të kultivuar, akuakulturë ose peshkim dhe prodhim e përdorim të biomasës për energji ose prodhim të biokarburanteve i nënshtrohen këtij kriteri performance.

Kërkesa të përgjithshme

24. Klienti duhet t'i menaxhojë burimet natyrore duke zbatuar kërkesat kombëtare rregullatore dhe standardet thelbësore mjedisore përkatëse të BE-së, që janë të zbatueshme në nivel projekti.
25. Klienti duhet t'i japë përparësi përdorimit dhe zbatimit të standardeve të njohura në nivel botëror, rajonal ose kombëtar, që i nënshtrohen certifikimit ose verifikimit të pavarur brenda një afati kohor të pranueshëm. Kur nuk ekzistojnë standarde përkatëse për burime natyrore të caktuara, të zbatueshme për projektin, klienti duhet të angazhohet për të zbatuar praktikatat e duhura të menaxhimit të qëndrueshëm sipas sektorit ekonomik.

Vlerësimi i çështjeve dhe ndikimeve

26. Klientët me projekte që kërkojnë përdorimin e burimeve natyrore duhet të vlerësojnë qëndrueshmërinë në kohë të burimeve, si dhe të marrin në konsideratë ndikimet e mundshme tek ekosistemet dhe biodiversiteti që mbështetin, si dhe parimet e mëposhtme:
 - përdorimi i çdo burimi natyror duhet parë në kuadër të funksioneve ekologjike bazë që ai ofron brenda ekosistemit¹⁶
 - marrja në konsideratë e ndikimeve të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe progresive
 - përdorimi i burimit natyror duhet të ndjekë qasjen e shkallës zbutëse dhe të kërkojë të optimizojë përfitimet për përdoruesit e tjerë
 - prodhimi dhe/ose përdorimi i llojeve ose popullatave që nuk janë natyrore për vendndodhjen dhe nuk janë testuar për të parë nëse janë apo jo pushtuese dhe/ose mbizotëruese kundrejt llojeve vendore, duhet të kufizohet ose duhet t'u nënshtrohet studimeve të duhura dhe miratimit nga autoritetet përkatëse kompetente kombëtare, përpara prodhimit ose përdorimit.

Prodhimi i kulturave bujqësore dhe kafshëve blegtorale

27. Klientët e përfshirë në prodhimin e kulturave bujqësore ose të kafshëve blegtorale duhet të sigurojnë që të përdorin praktikatat e mira ndërkombëtare për të shmangur ose minimizuar ndikimet negative dhe konsumimin e burimeve.
28. Klientët e përfshirë në mbarështimin, transportimin dhe therjen e kafshëve për mish ose për nënprodukte (për shembull, qumësht, vezë, lesh) duhet të ndjekin dhe të zbatojnë kërkesat kombëtare rregullatore, standardet përkatëse të BE-së për kujdesin për kafshët dhe praktikën e mirë ndërkombëtare, cilado që ka standardet më të larta, në lidhje me teknikat e mbarështimit të kafshëve.

Peshkimi dhe akuakultura

29. Klientët e përfshirë në mbarështimin, kapjen ose përpunimin e peshqve ose llojeve të tjera ujore duhet të dëshmojnë se veprimtaritë e tyre ndërmerren, ose do të ndërmerren, në mënyrë të qëndrueshme. Kjo mund të arrihet përmes marrjes së një certifikimi të pavarur,¹⁷ ose përmes studimeve të kryera si pjesë e procesit të vlerësimit. Veprimtaritë e peshkimit jo medoemos mjaftohen vetëm me kapjen. Ripopullimi ose futja e llojeve ose e popullatave të ndryshme, sidomos në mjediset e mbyllura, siç janë liqenet, duhet të sigurojë që inventari i ri nuk i shkatërron apo i zëvendëson llojet endemike/natyrore lokale të peshqve.

¹⁶ Për shembull, shpyllëzimi përmes prerjes së pemëve mund të ketë ndikime të padëshirueshme në biodiversitet, erozioni i dherave, hidrologjia e zonës ujëmbledhëse, cilësia e ujërave dhe peshkimi. Po kështu, peshkimi i tepruar i një lloji mund të prekë ekuilibrin ekologjik dhe tërësinë e ekosistemeve në terma afatgjatë.

¹⁷ Për shembull, programet e përshtatshme të peshkimit të njohura në nivel ndërkombëtar përfshijnë skemën e certifikimit të Këshillit të Administrimit Detar.

30. Për projektet e akuakulturës, klientët duhet të vlerësojnë dhe të minimizojnë rrezikun e largimit të pakontrolluar të llojeve jovendase në mjedisin ujor. Klientët duhet të vlerësojnë dhe të minimizojnë edhe mundësinë e transmetimit të sëmundjeve dhe/ose parazitëve në mjedis.

Pylltaria natyrore dhe me plantacione

31. Klientët e përfshirë në pylltari parësore duhet t'i planifikojnë aktivitetet e tyre për të shmangur ose minimizuar ndikimet mbi ekosistemet dhe biodiversitetin që mbështetin dhe të përmbushin kërkesat përkatëse të parashikuara në pikat 11 dhe/ose 13-15 nëse veprimtaritë e lidhura me projektin kanë mundësi të sjellin shndërrim, copëzim ose degradim të karakteristikave kryesore të biodiversitetit ose të habitateve me rëndësi kritike.
32. Klientët duhet të marrin certifikim për pyjet dhe/ose plantacionet mbi të cilat kanë kontroll të drejtpërdrejtë menaxhimi, nëse janë përmbushur parimet dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.¹⁸ Kur vlerësimi identifikon që praktikatat e menaxhimit të pyjeve nuk i përmbushin standarde të tilla, klientët duhet të zhvillojnë një plan menaxhimi për të marrë një certifikim të tillë brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Përdorimi i lëndës djegëse nga biomasa dhe prodhimi i biokarburanteve

33. Klientët e përfshirë në prodhimin dhe përdorimin e biomasës duhet t'i minimizojnë ndikimet e padëshiruara mbi ekosistemet dhe biodiversitetin që ato mbështetin përmes i. përdorimit të lëndëve të mbetura dhe mbetjeve si burim parësor të lëndëve djegëse nga biomasa, kur është e mundur kjo, brenda kushteve teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive; dhe ii. ndjekjes dhe zbatimit të parimeve dhe standardeve përkatëse të BE-së dhe, sipas rastit, përpjekjeve për të certifikuar aktivitetet e tij sipas standardeve të tilla brenda një afati kohor të arsyeshëm.
34. Klientët e përfshirë në prodhimin e biokarburanteve duhet të përdorin material foragjer, që prodhohet në mënyrë të qëndrueshme, në mënyrë që të minimizohen ndikimet e padëshirueshme tek ekosistemet dhe biodiversiteti që ato mbështetin, si dhe përdorimi dhe ndikimet tek toka, ujërat dhe burimet e tjera të nevojshme për prodhimin e çdo njësie energji. Klienti duhet të ndjekë dhe të zbatojë parimet dhe standardet përkatëse të BE-së dhe/ose udhëzimet për prodhimin e materialit foragjer për biokarburantet dhe, kur ka, të bëjë përpjekje për të certifikuar aktivitetet sipas standardeve të tilla brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Zinxhiri i furnitorëve

35. Në rastet kur: i. projekti përdor furnitorë të jashtëm të burimeve natyrore mbi të cilët klienti nuk ushtron kontroll të drejtpërdrejtë administrimi; ii. këto burime janë thelbësore për funksionet bazë të projektit; dhe iii. furnitorët kanë mundësinë për të ndikuar në mënyrë të konsiderueshme tek ekosistemet dhe biodiversiteti që ato mbështetin, klienti duhet të miratojë dhe të zbatojë, si pjesë të SMMS-së ose PMMS-së, një politikë për prokurimin e burimeve të qëndrueshme, procedura menaxhimi dhe sistem verifikimi për të vlerësuar furnitorët parësorë. Politikën, procedurat dhe sistemet e verifikimit duhet të specifikojnë që:

- të blihen vetëm burime natyrore me origjinë të njohur ligjrisht dhe të qëndrueshme
- të monitorohet dhe të dokumentohet origjina e burimeve natyrore
- origjinat e burimeve natyrore të mos ndikojnë negativisht në funksionet bazë ekologjike të ekosistemeve të prekura, të zonave të mbrojtura me ligj, të zonave të njohura në nivel ndërkombëtar me vlerë biodiversitare, në karakteristikat kryesore për biodiversitetin ose habitatet me rëndësi kritike.

¹⁸ Programet e certifikimit të pylltarisë të njohura në nivel ndërkombëtar përfshijnë Këshillin e Administrimit të Pyjeve dhe Programin për Miratimin e Certifikimit të Pyjeve.

36. Klientët duhet të favorizojnë blerjen e burimeve natyrore të prodhuara në përputhje me parimet dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht të menaxhimit të qëndrueshëm, kur ka, për produktin e blerë. Kur ekzistojnë sisteme të certifikimit të qëndrueshmërisë së sektorit ekonomik, të njohura në nivel ndërkombëtar, klienti duhet të kërkojë t'i certifikojë aktivitetet dhe sistemin e menaxhimit të zinxhirit të furnitorëve sipas këtyre standardeve brenda një afati kohor të arsyeshëm. Në mungesë të sistemeve të tilla të certifikimit, klienti duhet të përdorë praktikën e mira ndërkombëtare dhe teknologjitë.

Organizmat e modifikuara gjenetikisht (OMGJ)

37. Në shtetet anëtare të BE-së, OMGJ-të nuk mund të përdoren ose të çlirohen në mjedis pa një miratim nga autoritetet kompetente. Në vendet e tjera ku ushtron aktivitet BERZH-i, OMGJ-të nuk mund të përdoren ose të çlirohen në mjedis pa një vlerësim të rrezikut, të kryer në përputhje me standardet thelbësore të BE-së.

Kriteri i Performancës nr. 7 i BERZH-it:

Popujt indigjenë

Hyrje

1. Ky kriter performance pranon se projektet mund të krijojnë mundësi që popullsitë indigjene të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga veprimtaritë e lidhura me projekte, të cilat mund t'i ndihmojnë të përmbushin aspiratën e tyre për zhvillim ekonomik dhe shoqëror. Meqë shteti shpesh luan një rol qendror në menaxhimin e çështjeve që kanë të bëjnë me popujt indigjenë, klientët duhet të bashkëpunojnë, sipas rastit, me autoritetet përgjegjëse dhe komunitetet përkatëse për menaxhimin e rreziqeve dhe të ndikimeve të veprimtarive të tyre.
2. Nuk ekziston asnjë përkufizim i pranuar nga të gjithë njësoj për “popujt indigjenë”. Po kështu, për popujt indigjenë vende të ndryshme mund të përdorin terma të ndryshme. Po ashtu, pranohet se grupet që mund të mos klasifikohen si popull indigjen në një vend ose rajon, mund të klasifikohen si të tillë në një vend tjetër.
3. Në politikë dhe në këtë kriter performance, termi “popuj indigjenë” përdoret, në kuptimin teknik, për të quajtur një grup shoqëror dhe kulturor, të dallueshëm nga grupet dominuese brenda shoqërive kombëtare, që zotëron karakteristikat e mëposhtme, në shkallë të ndryshme:
 - vetë-identifikimi si anëtarë të një grupi të dallueshëm etnik ose kulturor indigjen dhe njohja e këtij identiteti nga të tjerët
 - përkatësia kolektive në habitate gjeografikisht të dallueshme, në toka tradicionale ose territore të të parëve në zonën e projektit dhe në burime natyrore në këto habitate dhe territore¹
 - prejardhja nga popullata që tradicionalisht² kanë ndjekur strategji për të jetuar duke mos u bazuar në pagë (dhe shpesh nomadët/shtegëtarët) dhe statusi i të cilëve është rregulluar nga zakonet ose traditat e tyre ose me akte ligjore e nënligjore të posaçme
 - institucionet zakonore kulturore, ekonomike, sociale ose politike që janë më vete nga institucionet e shoqërisë ose të kulturës mbizotëruese
 - gjuhë ose dialekt të dallueshëm, shpesh të ndryshëm nga gjuha ose dialekti zyrtar i vendit ose rajonit.
4. Fakti që një grup, ose anëtarët e një grupi, bëjnë jetë nomade ose shtegëtare, jetojnë në komunitete urbane dhe/ose vetëm sa shkojnë për vizitë në tokat e tyre tradicionale në mënyrë sezonale, pasi janë larguar me forcë prej andej, nuk është ndalim apriori i zbatimit të këtij kriteri performance.
5. Ky kriter performance i trajton popujt indigjenë si partner, duke i respektuar ata si njerëz dhe si popuj vlerat e të cilëve mund të kontribuojnë shumë në zhvillimin e tyre shoqëror-

¹ Grupi që e ka humbur “përkatësinë kolektive në habitate gjeografikisht të dallueshme ose territore të të parëve në zonën e projektit” për shkak të largimit me forcë vazhdon të ketë të drejtë të përfitojë sipas këtij kriteri performance, nëse pritet të preket nga projekti. “Largimi me forcë” është humbja e përkatësisë kolektive në habitate gjeografikisht të dallueshme ose territore të të parëve për shkak të konfliktit, programeve shtetërore të shpërnguljes, heqjes së tokës nga përdorimi, fatkeqësive natyrore ose përfshirjes së territoreve të tilla në një zonë urbane. Në kuptim të këtij kriteri performance, “zonë urbane” normalisht do të thotë një qytet ose një qytezë e madhe dhe merr në konsideratë të gjitha karakteristikat e mëposhtme, asnjëra prej të cilave nuk është përfundimtare: i. përcaktimi ligjor i zonës si urbane me legjislacion kombëtar; ii. dendësi popullore e madhe; dhe iii. përqindje e lartë veprimtarish ekonomike jobujqësore në krahasim me veprimtaritë bujqësore.

² Kjo zbatohet edhe nëse nuk ndiqet më një strategji e tillë, sipas poshtëshënimit të mëparshëm.

ekonomik dhe atë kombëtar. Por ky kriter performance pranon se popujt indigjenë, si grupe shoqërore me identitete të dallueshme nga grupet mbizotëruese në shoqëritë kombëtare, mund të jenë mes segmenteve më të rrezikuara dhe në pozita të pambrojtura në popullsi. Statusi i tyre ekonomik, shoqëror dhe ligjor shpesh e kufizon kapacitetin e tyre për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e tyre (që mund të jenë edhe individuale dhe/ose kolektive) për tokën dhe burimet natyrore e kulturore dhe mund ta kufizojnë aftësinë e tyre për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi. Ata janë sidomos në pozita të pambrojtura nëse tokat dhe burimet e tyre transformohen ose shkelen nga ata që nuk janë anëtarë të komuniteteve të tyre.

6. Ky kriter performance pranon se identitetet, kulturat, tokat dhe burimet e popujve indigjenë janë të ndërthurura në mënyrë unike dhe sidomos më të ndryshme kundrejt ndryshimeve të shkaktuara nga disa lloje investimesh, prandaj mund të rrezikohen edhe gjuhët, kulturat, fetë, besimet shpirtërore dhe institucionet e tyre. Këto karakteristika i nxjerrin zbuluar popujt indigjenë ndaj llojeve të ndryshme të rreziqeve dhe shkallës së rëndë të ndikimeve, përfshi humbjen e identitetit, të kulturës dhe mjeteve të jetesës varur tek burimet natyrore, si dhe i nxjerr ata të zbuluar përpara varfërisë dhe sëmundjeve. Pranohet edhe që rolet e burrave, grave dhe fëmijëve në kulturat indigjene mund të jenë të ndryshme nga rolet përkatëse në grupet mbizotëruese: burrat dhe gratë mund të kenë trajtim të diferencuar si brenda komuniteteve të tyre ashtu edhe në shoqëri më gjerë, çka mund të konsiderohet si diskriminim. Në veçanti, fëmijët mund të jenë në rrezik përjashtimi social, për shkak të statusit të tyre prej fëmije, si edhe të jenë objekt diskriminimi për shkak të statusit prej indigjeni. Për shkak të këtyre realiteteve, çështjet e lidhura me popujt indigjenë janë shpesh komplekse. Gjithashtu, kultura mbizotëruese ndonjëherë mund të mos jetë e ndërgjegjshme ose mund të mos dojë të pranojë ekzistencën e një statusi prej indigjeni të disa grupeve të caktuara të popullsisë. Kështu, nevojiten masa të posaçme për të siguruar që burrat dhe gratë indigjene të mos vihen në pozita të pafavorshme dhe që ata të përfshihen dhe të përfitojnë nga projektet e mbështetura nga Banka, sipas rastit.
7. Ky kriter performance e pranon se rrethanat e popujve indigjenë në vendet ku ushtron aktivitet BERZH-i janë unike për shkak të historisë së veçantë të tyre. Popujt indigjenë nuk mund të merren më me jetesën zakonore të ekonomive minimale dhe identiteti i tyre nuk mund të shoqërohet më vetëm me ndjekjen e stileve të tilla tradicionale të jetesës. Për më tepër, pranohet se popujt indigjenë shpesh jetojnë në vendbanime me kombësi të përzier. Ekzistenca e vazhdueshme e nomadëve ose e shtegëtarëve dhe historia e shpërnguljeve të detyrueshme kanë çuar në një pritshmëri për t'i vazhduar lidhjet fikse me territore të veçanta, çka jo gjithmonë është e duhur. Pranohet nga ky kriter performance se mjetet dhe modelet e jetesës së popujve indigjenë mund të jenë krejt të dallueshme nga kultura mbizotëruese dhe, gjithashtu, mund të kenë qenë objekt ndryshimi me kalimin e kohës.

Objektivat

8. Objektivat specifike janë:
 - sigurimi që procesi i tranzicionit të nxisë respektimin e plotë për dinjitet, të drejta njerëzore, aspirata, kultura dhe jetesë varur tek burimet natyrore të popujve indigjenë
 - parashikimi dhe shmangia e ndikimeve të padëshirueshme tek jetët dhe mënyra e jetesës së komuniteteve të popujve indigjenë, ose kur nuk është e realizueshme shmangia, minimizimi, zbutja ose kompensimi i ndikimeve të tilla
 - dhënia mundësi popujve indigjenë për të përfituar nga projektet në mënyrë të atillë që të jetë e përshtatshme nga ana kulturore
 - mbështetja e klientit për të vendosur dhe mbajtur një marrëdhënie të vazhdueshme me popujt indigjenë të prekur nga një projekt përgjatë gjithë jetës së projektit

- nxitja e negocimeve në mirëbesim të klientit me popujt indigjenë, dhe pjesëmarrjen e bazuar në informim, kur projektet janë planifikuar të vendosen në tokat tradicionale ose zakonore të përdorura nga popujt indigjenë, kur mjetet zakonore ose jotradicionale të jetesës do të preken nga projekti ose në rastin e shfrytëzimit për qëllime tregtare të burimeve kulturore të popujve indigjenë
- pranimi i parimit të parashtruar në Deklaratën e OKB-së “Për të drejtat e popujve indigjenë”,³ se është i nevojshëm pëlqimi paraprak i bazuar në informim i popujve indigjenë të prekur për veprimtaritë e lidhura me projektin të identifikuar në pikat 30-34 më poshtë, duke pasur parasysh dobësitë e veçanta të popujve indigjenë kundrejt ndikimeve të padëshirueshme të projekteve të tilla⁴
- pranimi i nevojave të veçanta të burrave, grave dhe fëmijëve të popujve indigjenë, duke trajtuar çështjet gjinore dhe duke zbutur ndikimet e mundshme jopërpjesëtimore gjinore të një projekti
- njohja dhe respektimi i ligjeve zakonore dhe i zakoneve të popujve indigjenë dhe marrja në konsideratë të plotë e tyre
- respektimi dhe ruajtja e kulturës, dijeve dhe praktikave të popujve indigjenë në përputhje me dëshirat e tyre.

Fusha e zbatimit

9. Ky kriter performance zbatohet kur një projekt ka të ngjarë të prekë popujt indigjenë. Gjatë vlerësimit, nëse një grup i caktuar konsiderohet apo jo si popull indigjen në kuptim të këtij kriteri performance, klientit mund t’i kërkohej të kërkojë këshilla të ekspertëve.
10. Zbatueshmëria e këtij kriteri performance duhet të përcaktohet gjatë procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, sipas kriterëve të parashtruar në pikat 2-7 më sipër. Zbatimi i masave të nevojshme për të përmbushur këto kërkesa duhet menaxhuar në përputhje me këtë kriter performance dhe me kriteret e performancës 1, 5, 8 dhe 10, sipas rastit.

Kërkesat

11. Në projektet ku ka të ngjarë të preken popujt indigjenë,⁵ klientit i kërkohej të kryejë një vlerësim të ndikimeve tek popujt indigjenë. Në varësi të rezultatit të këtij vlerësimi, nga klienti pritet që në fillim të shmangë ndikimet e padëshirueshme dhe, kur kjo nuk është e realizueshme, të përgatisë një plan zhvillimipër popujt indigjenë sipas pikës 19, më poshtë, në mënyrë që të minimizohen dhe/ose zbuten ndikimet e mundshme të padëshirueshme dhe të identifikohen përfitimet. Nga klienti pritet që të angazhohet në konsultime të informuara dhe me pjesëmarrje me komunitetet e prekura indigjene, të zbatojë një mekanizëm të veçantë për ankesat dhe të identifikojë dhe të përcaktojë mënyrat e duhura për kompensimin dhe mundësitë për të përfituar komunitetet. Gjatë kryerjes së konsultimit, klienti duhet të ketë parasysh faktin se në disa raste ka një sezonalitet të strukturës së jetesës të popujve indigjenë dhe klienti duhet ta ndërtojë konsultimin në atë mënyrë që të sigurojë marrjen e pikëpamjeve të popujve indigjenë në kohën e duhur për të siguruar dhënien e kontributit përkatës në procesin e planifikimit.
12. Kur klienti i ka filluar aktivitetet e projektit që mund të kenë prekur dhe/ose mund të prekin popujt indigjenë, vlerësimi duhet të identifikojë: i. çdo boshllëk; dhe ii. masat korrigjuese

³ Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme për të drejtat e popujve indigjenë, miratuar më 13 shtator 2007.

⁴ Konventa nr.169 e ILO-s (Konventa për popujt indigjenë dhe fisnorë) e cila mbulon një gamë të gjerë çështjesh që kanë të bëjnë me popujt indigjenë, përfshi tokën, punësimin, sigurimet shëndetësore dhe shoqërore dhe të drejtën zakonore. Konsultimi dhe pjesëmarrja janë guri themeltar i Konventës.

⁵ Popujt indigjenë të prekur nga projekti janë ata persona, statusi shoqëror-ekonomik, kultura dhe mënyra tradicionale e jetesës e të cilëve preken negativisht nga veprimtaritë e projektit.

që mund të jenë të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë e këtij kriteri performance. Në këtë rast duhet miratuar një plan veprimi.

13. Kur burimi i duhur nuk është i disponueshëm brenda organizatës së klientit, rekomandohet marrja e këshillave nga specialistët socialë, me përvojë dhe të pavarur, përgjatë gjithë periudhës së përgatitjes dhe zbatimit të projektit.

Vlerësimi

14. Kur ekziston një kërkesë në legjislacionin kombëtar për një lloj të veçantë vlerësimi social, klienti duhet ta kryejë këtë vlerësim social krahas kryerjes së çdo vlerësimi tjetër social që kërkon ky kriter performance.
15. Në rastet kur projekti nuk ka filluar ende, klienti duhet të identifikojë, përmes një procesi vlerësimi social, të gjitha komunitetet e popujve indigjenë që mund të preken drejtpërdrejt ose tërthorazi, si pozitivisht ashtu edhe negativisht, nga projekti, si dhe natyra dhe shkalla e ndikimeve të pritura sociale, kulturore (përfshi trashëgiminë kulturore) dhe mjedisore tek ta. Ky vlerësim duhet të shikojë pozitat dobësitë e veçanta të komuniteteve indigjene kundrejt ndryshimeve në mjedisin dhe mënyrën e tyre të jetesës. Klienti duhet të planifikojë masa: i. për të shmangur ose zbutur ndikimet e padëshirueshme; dhe ii. për të ndarë me ta përfitimet e lidhura me projektin.
16. Në rastet kur ka filluar që më parë ndërtimi, veprimtaritë ose aktivitetet e lidhura me projektin, klienti duhet të japë të gjitha informacionet dhe dokumentet përkatëse (përfshi edhe ato që kanë të bëjnë me ecurinë e klientit në të shkuarën) bashkë me një kopje të dokumenteve që u janë paraqitur autoriteteve, për të dëshmuar se janë kërkuar dhe janë marrë në konsideratë mendimet e popujve indigjenë të prekur nga projekti, duke ndjekur, sa më shumë të jetë e mundur, procesin e përshkruar në këtë kriter performance.
17. Nëse nuk përmbushen kërkesat e pikës 16, klienti duhet të porositë kryerjen e një studimi objektiv dhe të pavarur si për ndikimet që ka projekti tek popujt indigjenë, ashtu edhe për pikëpamjet lidhur me projektin. Ky studim, i cili duhet kryer në mënyrë të përshtatshme nga ana kulturore, duhet të shqyrtojë ndikimet e deritanishme tek jeta dhe mjetet e jetesës së popujve indigjenë, punën e klientit për të zbutur ndikimet e padëshirueshme dhe për të identifikuar dhe ndarë përfitimet e projektit dhe nivelin e pjesëmarrjes së popujve indigjenë në planifikimin dhe zbatimin e projektit.

Shmangia e ndikimeve të padëshirueshme

18. Të gjitha përpjekjet në fillim duhen orientuar drejt shmangies së çdo ndikimi të padëshirueshëm që mund të ketë projekti tek popujt indigjenë. Kur shmangia e ndikimeve të padëshirueshme nuk është e realizueshme, klienti duhet të minimizojë, të zbusë dhe të japë kompensim për këto ndikime në mënyrë të drejtë, të duhur dhe përpjesëtimore.

Përgatitja e një plani për zhvillimin e popujve indigjenë

19. Masat e propozuara të klientit për të minimizuar, zbutur dhe kompensuar ndikimet e padëshirueshme dhe për të identifikuar dhe ndarë përfitimet duhet të hartohen me pjesëmarrjen e informuar të popujve indigjenë të prekur dhe të jenë pjesë e një plani me afate kohore, për shembull një plan për zhvillimin e popujve indigjenë (PZHPI), ose një plan për zhvillimin e komunitetit të gjerë me komponentë më vete për popujt indigjenë. Klienti duhet të marrë sociologë të kualifikuar me njohuritë përkatëse dhe të duhura për të përgatitur PZHPI-në. PZHPI-ja duhet të vlerësojë, në mënyrë sistematike, ndikimet e një

projekti në lidhje me përkatësinë gjinore dhe brezat e ndryshëm dhe duhet të përfshijë masa për t'i trajtuar këto ndikime mbi grupet e komunitetit.

Niveli i detajeve dhe qëllimi i PZHPI-së duhet të ndryshojë sipas projektit të veçantë, natyrës dhe qëllimit të veprimtarive të projektit. Në përgjithësi, PZHPI-ja duhet të përfshijë komponentët e mëposhtëm:

Rubrika I – Përmbledhje e vlerësimit social

- Informacioni bazë: është e rëndësishme që në këtë fazë të jepet informacion si për strukturën sociale të komunitetit të popujve indigjenë, ashtu edhe për rolet dhe përgjegjësitë brenda familjes. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e një plani të duhur zbatimi.
- Konstatimet kryesore: analizë e ndikimeve, rreziqeve dhe mundësive.

Rubrika II – Konsultimet dhe pjesëmarrja

- Rezultati i konsultimeve dhe plani për angazhimin në të ardhmen.

Plani i zbatimit

- Masa për shmangien, minimizimin dhe zbutjen e ndikimeve negative dhe rritjen e ndikimeve pozitive.
- Masa për të siguruar vijimësinë e menaxhimit me bazë komunitetin të burimeve natyrore.
- Masa për të marrë pjesë në mundësitë për të përfituar nga projekti.
- Mekanizmi për ankesat.
- Kostot, buxheti, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative.
- Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi.

Dhënia e informacionit, konsultimet e plotë dhe pjesëmarrja e informuar

20. Klienti duhet të vendosë një marrëdhënie të vazhdueshme me komunitetet e prekura të popujve indigjenë, sa më herët në procesin e planifikimit të projektit dhe përgjatë gjithë jetës së projektit. Procesi i angazhimit duhet të sigurojë konsultimin e plotë të tyre, në mënyrë që të mundësohet kuptimi për natyrën dhe kohëzgjatjen e ndikimeve; pjesëmarrja e informuar për çështje që i prekin drejtpërdrejt; masat e propozuara për zbutjen; ndarja e përfitimeve dhe mundësive për zhvillim; dhe çështjet e zbatimit.
21. Klienti duhet të sigurojë që popujt indigjenë të prekur nga projekti të informohen në mënyrën e duhur të përshtatshme nga ana kulturore për kriteret përkatëse të performancës dhe për planet e projektit që i prekin ata, duke siguruar, sipas rastit, masa për pjesëmarrje të efektshme të të gjitha palëve të komunitetit.
22. Procesi i angazhimit të komunitetit duhet të jetë i përshtatshëm nga ana kulturore, të respektojë proceset vendimmarrëse kolektive të popujve indigjenë dhe të jetë në përpjesëtim me rreziqet dhe ndikimet e mundshme tek popujt indigjenë. Klienti duhet të japë të dhëna të dokumentuara për të treguar se ky proces është kryer siç duhet.
23. Në veçanti, procesi i angazhimit duhet të përfshijë sa më poshtë:
 - përfshirje e organeve përfaqësuese të popujve indigjenë (për shembull, e këshillit të pleqësisë ose e këshillit të fshatit, mes të tjerave), e organizatave të popujve indigjenë si dhe e personave indigjenë individual të prekur
 - mirëkuptim dhe respektim të çdo ligji zakonor përkatës
 - parashikim i kohës së mjaftueshme për procesin vendimmarrës kolektiv të popujve indigjenë

- dhënie e mundësisë popujve indigjenë të shprehin pikëpamjet, shqetësimet dhe propozimet e tyre në cilën gjuhë të duan dhe pa manipulim, ndërhyrje apo frikësim nga jashtë dhe në mënyrë të përshtatshme nga ana kulturore
- dhënia e të gjitha planeve përkatëse dhe e informacionit për ndikimet e mundshme sociale dhe ekologjike që prekin komunitetet indigjene në një gjuhë dhe mënyrë të përshtatshme nga ana kulturore, pa terminologji teknike
- njohja e përbërjes heterogjene të komunitetit, duke marrë në konsideratë:
 - popujt indigjenë jetojnë në komunitete mikse me njerëz të cilët nuk janë indigjenë
 - komunitetet indigjene janë me shumë aspekte – konsultimet dhe pjesëmarrja duhet të përfshijnë grupet me përkatësi gjinore të ndryshme, nga breza të ndryshëm dhe grupe të përjashtuara
 - dhënie e informacionit të duhur BERZH-it dhe përfshirje e BERZH-it në procesin e konsultimeve, kur kjo gjë është e mundur
- dokumentimi i plotë⁶ i procesit të konsultimit.

Mekanizmi i ankimit dhe parandalimi i diskriminimit me bazë etnike

24. Klienti duhet të sigurojë që mekanizmi për ankesat, i ngritur për projektin siç përshkruhet në KP 10, të jetë i përshtatshëm nga ana kulturore dhe i arritshëm për popujt indigjenë; kjo mund të kërkojë më pak mbështetje tek procedurat e shkruara dhe më shumë përdorim të kanaleve verbale të raportimit.
25. Në projektet e financuara nga Banka, ku ekzistojnë faktorë të nënkuptuar që i përjashtojnë individët dhe popujt indigjenë nga përfitimet, të tilla si mundësitë për punësim për shkaqe etnike, veprimtaritë e projektit duhet të përfshijnë masa korrigjuese, si: i. informimi i organizatave dhe i individëve të popujve indigjenë për të drejtat e tyre sipas legjislacionit të punës, të çështjeve sociale, financave dhe biznesit dhe për mekanizmat e rrugëve ligjore që mund të ndiqen; ii. përhapja e duhur dhe ndikimi i informacionit, trajnimi dhe masat për eliminimin e barrierave ndaj përfitimeve dhe burimeve të tilla si kreditimi, punësimi, shërbimet për biznesin, shërbimet shëndetësore dhe shërbimet arsimore, si dhe përfitime të tjera të krijuara ose të mundësuar nga projektet; dhe iii. ofrimi punonjësve, tregtarëve dhe përfituesve indigjenë të njëjtën mbrojtjeje që u jep legjislacioni kombëtar individëve të tjerë në sektorë dhe kategori të ngjashme, duke patur parasysh çështjet gjinore dhe segmentimin etnik në tregjet e mallrave dhe punës, si edhe faktorët gjuhësorë.

Kompensimi dhe ndarja e përfitimeve

26. Qasjet me pjesëmarrje duhet të jenë themeli i përcaktimit të masave për zbutjen, ndarjen e përfitimeve dhe mbështetjen e mënyrës zakonore të jetesës. Klienti duhet të sigurojë që popujt indigjenë të prekur të kompensohen drejtpërdrejt për çdo humbje të mjeteve të jetesës (të llogaritur në përputhje me këtë kriter performance), që ka ndodhur si pasojë e veprimtarive të lidhura me projektin dhe të rehabilitohen në marrëveshje me komunitetin vendor. Kriteret për përfitimin e kompensimit mund të jenë individuale ose kolektive, ose mund të jenë ndërthurje e të dyjave. Kompensimi duhet të jepet si për ndikimet e padëshirueshme mbi mjetet zakonore të jetesës, ashtu edhe për ndikimet negative mbi pagën ose nismat ekonomike të varura nga fitimi. Natyra e “mjeteve zakonore të jetesës” duhet interpretuar me elasticitet (për të përfshirë edhe përshtatjet bashkëkohore të tilla si etnoturizmi dhe përpunimi ushqimor). Gjatë llogaritjes së kompensimit, klientët duhet të mbajnë parasysh ndikimet e padëshirueshme sociale që ka projekti tek mënyra tradicionale e jetesës dhe jeta familjare e popujve indigjenë. Kjo duhet ndërmarrë në bashkëpunim me

⁶ Këtu mund të përfshihen procesverbalet dhe/ose regjistrimet audio.

ekspertët dhe përfaqësuesit e popujve indigjenë. Dispozitat e kësaj pike zbatohen edhe në rastet kur klientit i duhet t'u japë kompensim organeve të pushtetit vendor ose rajonal.

27. Gjatë konsultimeve me popujt indigjenë, duhen diskutuar mënyra të pranueshme dhe të realizueshme nga aspekti juridik për kompensimin dhe për zbatimin e PZHPI-ve. Mbështetur në këto konsultime, duhet zhvilluar dhe miratuar një mekanizëm për transferimin e kompensimit dhe/ose të burimeve. Mund të duhet që kjo të jepet në formë kolektive, kur toka dhe burimet janë në pronësi kolektive. Nëse është e nevojshme, asistencë/mbështetje duhet dhënë nga klienti për të mundësuar ngritjen e sistemeve të duhura të menaxhimit dhe të qeverisjes.
28. Klienti duhet të ofrojë, përmes procesit të konsultimit të plotë dhe pjesëmarrjes së informuar të komuniteteve të prekura të popujve indigjenë, siç parashikohet në pikat 20-23, më lart, mundësi për përfitime të zhvillimit, të përshtatshme nga ana kulturore. Mundësi të tilla duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e ndikimeve të projektit, me qëllim përmirësimin e standardeve dhe të mjeteve të tyre të jetesës në mënyrën e duhur, me nxitjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të burimeve natyrore tek të cilat mund të mbështeten. Klienti duhet të dokumentojë përfitimet e zhvillimit në përputhje me kërkesat e këtij kriteri performance dhe t'i ofrojë ato në kohën e duhur. U duhet dhënë mbështetje e fortë veprimtarive zakonore ekonomike minimale, përfshi veprimtaritë ekonomike tradicionale dhe derivatet e tyre moderne, siç janë artizanati dhe etnoturizmi.

Kërkesa të posaçme

29. Duke qenë se popujt indigjenë mund të jenë sidomos më të ndjeshëm në rrethanat e projekteve të përshkruara më poshtë, krahas kërkesave të përgjithshme sa më lart, duhen zbatuar edhe kërkesat e posaçme të mëposhtme. Këto kërkesa kanë të përbashkët nevojën që klienti:
 - të hyjë në negocime në mirëbesim me popujt indigjenë
 - të sigurojë pjesëmarrjen e informuar dhe gjithëpërfshirëse të popujve indigjenë
 - të marrë pëlqimin e lirë, paraprak dhe të informuar (PLPI)⁷ të popujve indigjenë përpara fillimit me një veprimtari të përshkruar më poshtë (pikat 30-35).

Në secilën prej rrethanave të mëposhtme, klienti duhet të marrë sociologë të pavarur e të kualifikuar për të asistuar në zhvillimin dhe dokumentimin e veprimtarive të përshkruara në pikat 30-35 të këtij kriteri performance.

Ndikimet mbi tokat tradicionale ose zakonore në përdorim

30. Popujt indigjenë janë të lidhur shpesh me tokat zakonore të tyre dhe me pyjet, ujërat, llojet e egra dhe burimet e tjera natyrore dhe, për rrjedhojë, zbatohen aspekte të posaçme nëse projekti prek lidhje të tilla. Edhe pse toka të tilla mund të mos jenë në pronësi ligjore, sipas legjislacionit kombëtar, përdorimi i këtyre tokave nga komunitetet e popujve indigjenë, përfshi përdorimin sezonal ose ciklik, si mjete jetese apo për qëllime kulturore, ceremoniale ose shpirtërore që përkufizojnë identitetin dhe komunitetin e tyre, shpesh mund të mbështeten me dëshmi dhe dokumente.
31. Nëse klienti propozon ta ketë vendndodhjen e projektit ose të zhvillojë në formë tregtare burimet natyrore në tokat zakonore në përdorim dhe mund të priten ndikime të

⁷ Nuk ekziston asnjë përkufizim i pranuar nga të gjithë njësoj për PLPI-në. Por, në kuptim të këtij kriteri performance, pëlqimi është procesi përmes të cilit komuniteti i prekur i popujve indigjenë arrin një vendim, në përputhje me traditat kulturore, zakonet dhe praktikatat e tij.

padëshirueshme⁸ tek jetesa ose përdorimet kulturore, ceremoniale ose shpirtërore që përkufizojnë identitetin dhe komunitetin e popujve indigjenë, klienti duhet ta respektojë përdorimin e tyre:

- duke hyrë në negocime në mirëbesim me komunitetet e prekura të popujve indigjenë dhe të dokumentojë pjesëmarrjen e tyre të lirë, paraprake dhe të informuar dhe pëlqimin e tyre si rezultat i negocimit
- duke i dokumentuar përpjekjet e veta për të shmangur ose, të paktën, për të minimizuar madhësinë e tokës në përdorim, shfrytëzim dhe/ose pronësi të popujve indigjenë që propozohet për projektin
- duke e dokumentuar përdorimin e tokës së popujve indigjenë përmes ekspertëve në bashkëpunim me komunitetet e prekura të popujve indigjenë, pa çenuar asnjë pretendim tjetër të popujve indigjenë mbi tokën
- duke i informuar komunitetet e prekura të popujve indigjenë për të drejtat e tyre në lidhje me këto toka sipas ligjeve kombëtare, përfshi çdo ligj kombëtar që njih të drejtat ose përdorimin zakonor
- duke u ofruar komuniteteve të prekura të popujve indigjenë, të paktën, proces dhe kompensim të drejtë për tokën në rastin e ndërtimit për arsye tregtare në tokën e tyre sipas ligjeve kombëtare, së bashku me mundësi zhvillimi të përshtatshme nga ana kulturore; kompensimi me tokë ose kompensimi në natyrë duhet të ofrohet në vend të kompensimit në të holla, aty ku është e realizueshme
- duke dhënë, në varësi të pëlqimit nga popujt indigjenë, të drejta kolektive pronësie mbi tokën dhe burimet natyrore që do të ofrohen si kompensim, nëse këtë nuk e ndalon ligji
- duke u dhënë kohë të mjaftueshme komuniteteve të prekura indigjene që të arrijnë një marrëveshje të brendshme, pa imponuar klienti vullnetin e tij drejtpërdrejt ose tërthorazi
- duke përdorur funksione të tilla si avokati i popullit dhe/ose institucione të tjera të tilla publike brenda sistemit përkatës kombëtar, për të bërë të mundur që komuniteti të japë pëlqimin për projektin dhe/ose përdorimin e propozuar të tokës nga klienti dhe për paketën e masave zbutëse
- duke siguruar të drejtë përdorimi të vazhdueshme të burimeve, duke identifikuar zëvendësues ekuivalentë të burimeve ose, si rrugë të fundit, duke dhënë kompensim
- duke siguruar ndarje të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që shoqërojnë përdorimin nga projekti të burimeve që janë të pandara nga identiteti dhe mjetet e jetesës së komuniteteve të prekura të popullsisë indigjene
- duke u siguruar komuniteteve të prekura të popujve indigjenë të drejtë hyrjeje, përdorimi dhe kalimi në tokën në të cilën por ndërton klienti, duke iu nënshtruar gjithmonë kërkesave për ruajtjen e shëndetit, të jetës dhe sigurisë.

32. Gjatë zbatimit të projektit, klienti duhet t'i sjellë menjëherë në vëmendje BERZH-it çdo konflikt midis popujve indigjenë dhe klientit, të cilat mbeten të pazgjidhura edhe pasi kanë kaluar në mekanizmin e ankesave të projektit; klienti duhet të vlerësojë faktet dhe të hartojë një qasje të përshtatshme për ta zgjidhur çështjen.

Zhvendosja e popujve indigjenë nga tokat tradicionale ose zakonore

33. Klienti duhet të shqyrtojë plane alternative të projektit për të shmangur zhvendosjen e popujve indigjenë nga tokat tradicionale ose zakonore që kanë zotëruar bashkërisht. Kur zhvendosja është e pashmangshme, klienti nuk duhet ta bëjë këtë zhvendosje pa marrë

⁸ Ndikimet e pavaforshme mund të përfshijnë, ndër të tjera, ndikimet që ndodhin si pasojë e humbjes së mjeteve ose të burimeve, kufizimi mbi përdorimin e tokës ose kryerjen e veprimtarive tradicionale të mënyrës së jetesës që shkaktohen nga veprimtaritë e projektit.

pëlqimin e lirë, paraprak dhe të informuar (PLPI) të komuniteteve të prekura të popujve indigjenë, në bazë të negociemeve të kryera në mirëbesim. Këto negocieme duhet të marrin në konsideratë ligjet, traditat, zakonet dhe të drejtat mbi tokën të popujve indigjenë dhe të bëhen me pjesëmarrjen e plotë të tyre. Çdo zhvendosje e popujve indigjenë duhet të jetë në përputhje me kërkesat e KP 5 për planifikimin dhe zbatimin e shpërnguljeve. Popujt indigjenë duhet të marrin kompensim të drejtë dhe të barabartë për tokat, territoret dhe burimet që kanë zotëruar tradicionalisht ose që kanë pasur në shfrytëzim apo përdorim, dhe të cilat janë konfiskuar, marrë, shfrytëzuar, përdorur ose dëmtuar si pasojë e projektit pa PLPI-në e tyre.

34. Kur është e realizueshme, popujt indigjenë të zhvendosur duhet të kenë mundësi të kthehen në tokat e tyre tradicionale ose zakonore, nëse pushon së ekzistuari arsyeja për zhvendosjen e tyre dhe toka do të rikthehet në gjendjen origjinale.

Trashëgimia kulturore

35. Kur një projekt propozon të përdorë burimet, dijet, novacionet ose praktikave kulturore të popujve indigjenë për qëllime tregtare, klienti duhet t'i informojë popujt indigjenë për: i. të drejtat e tyre sipas legjislationit kombëtar dhe atij ndërkombëtar; ii. objektin dhe natyrën e zhvillimit tregtar të propozuar; dhe iii. pasojat e mundshme të një zhvillimi të tillë. Klienti nuk duhet ta fillojë një shfrytëzim të tillë tregtar nëse nuk: i. hyn në negocieme në mirëbesim me komunitetet e prekura të popujve indigjenë; ii. dokumenton pjesëmarrjen e tyre të informuar dhe pëlqimin e lirë paraprak e të informuar të tyre për një veprimtari të tillë; dhe iii. parashikon ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve nga shfrytëzimi tregtar i dijeve, novacioneve ose praktikave të tilla, në përputhje me zakonet dhe traditat e tyre.

Kriteri i Performancës nr. 8 i BERZH-it:

Trashëgimia kulturore

Hyrje

1. Ky kriter performance njih rëndësinë që ka trashëgimia kulturore për brezat e tashëm dhe të ardhshëm. Qëllimi është të mbrohet trashëgimia kulturore dhe të orientohen klientët në shmagjien ose zbutjen e ndikimeve të padëshirueshme mbi trashëgiminë kulturore në rrjedhën e aktiviteteve të tyre tregtare. Nga klientët pritet të tregojnë kujdes në qasjen e tyre për menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore.
2. Si trashëgimia e trupëzuar, ashtu edhe ajo e patrupëzuar, janë pasuri të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror dhe janë pjesë përfshirëse e vijmësisë së identitetit dhe të praktikave kulturore (përfshi zotësitë tradicionale, njohuritë, besimet dhe/ose dialektet dhe gjuhët e vogla).
3. Në ndjekje të qëllimeve të mbrojtjes dhe ruajtjes, ky kriter performance orientohet nga konventat ndërkombëtare dhe instrumente të tjera. Ky kriter njih edhe nevojën që të gjitha palët të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore e që mund të preken nga një projekt dhe detyrimet në bazë të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi pritis. Këto akte ligjore mund të jenë për trashëgiminë kulturore ose për antikitetet, planifikimin ose lejet e ndërtimit, zonat e ruajtura, zonat e mbrojtura dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mjediset historike të ndërtuara apo aktet ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e kulturave të popujve indigjenë. Kërkesat e hollësishme për mbrojtjen e popujve indigjenë jepen në KP 7.

Objektivat

4. Objektivat e këtij kriteri performance janë:
 - mbështetja e mbrojtjes dhe e ruajtjes së trashëgimisë kulturore
 - ndjekja e një qasjeje me shkallë zbutëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nga ndikimet e padëshirueshme që lindin nga projekti
 - nxitja e ndarjes së barabartë të përfitimeve nga përdorimi i trashëgimisë kulturore në veprimtari tregtare
 - nxitja e ndërgjegjësimit dhe e vlerësimit për trashëgiminë kulturore sa herë të jetë e mundur.

Fusha e zbatimit

5. Në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë kërkesat përkatëse të këtij kriteri performance dhe se si do të trajtohen ato si pjesë gjithëpërfshirëse e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) të klientit dhe/ose Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) sipas projekteve. Kërkesat për vlerësimin dhe menaxhimin mjedisor dhe social jepen në KP 1. Gjithashtu, klienti duhet ta zbatojë këtë kriter performance gjatë zbatimit të projektit, nëse projekti prek ose ka mundësi të prekë trashëgiminë kulturore (të trupëzuar ose të patrupëzuar) e cila nuk ka qenë identifikuar më parë.
6. Në kuptim të këtij kriteri performance, termi trashëgimi kulturore përkufizohet si një grup burimesh të trashëguara nga e shkuara, të cilat njerëzit i identifikojnë, pavarësisht se kush është pronar, si pasqyrim dhe shprehje të vlerave, besimeve, dijeve dhe traditave evoluese

të tyre. Ky term përfshin trashëgiminë kulturore të trupëzuar (fizike) dhe të patrupëzuar, e cila njihet në nivel vendor, rajonal dhe qendror ose brenda komunitetit ndërkombëtar.

- Trashëgimia kulturore fizike përfshin sendet e lëvizshme ose të palëvizshme, vendet, grupet e objekteve si dhe hapësirat kulturore ose të shenjta që shoqërohen me to dhe vendet e peizazhet natyrore me rëndësi arkeologjike, paleontologjike, historike, arkitekturore, fetare, estetike ose me vlera të tjera kulturore.
- Trashëgimia kulturore e patrupëzuar përfshin praktikën, përfaqësimet, shprehjet, dijet dhe zotësitë që komunitetet, grupet dhe, në disa raste, individët i njohin si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore dhe të cilat kalohen nga njëri brez në tjetrin.

7. Duke pranuar se vende, sende ose tradita kulturore me vlerë ose rëndësi të trashëgimisë kulturore mund të zbulohen aty ku nuk e pret, projekti është objekt i dispozitave të këtij kriteri performance, nëse:

- kërkon gjurmime të mëdha, prishje, lëvizje dhe, përmbytje ose ndryshime të tjera në mjedisin fizik
- ndodhet brenda ose pranë një pike të trashëgimisë kulturore, e njohur si e tillë nga vendi përkatës
- mund të kenë një ndikim të padëshirueshëm tek format e patrupëzuara të trashëgimisë kulturore të njerëzve, përfshi edhe popujt indigjenë.

Kërkesat

Procesi i vlerësimit

Shqyrtimi paraprak për të parë ndikimet tek trashëgimia kulturore

8. Në një fazë të hershme të vlerësimit mjedisor dhe social, klienti duhet të identifikojë nëse trashëgimia kulturore ka të ngjarë apo jo të preket negativisht nga projekti dhe të vlerësojë probabilitetin e gjetjeve të rastësishme. Në këtë proces, klienti duhet të konsultohet me autoritetet përkatëse, ekspertët, komunitetet lokale dhe palët e tjera të interesit, sipas rastit. Intensiteti i studimit të burimeve kulturore duhet të jetë i përshtatshëm për përshkrimin e çështjeve dhe ndikimeve të mundshme të projektit dhe pasqyrimin e shqetësimeve të palëve përkatëse të interesit.

Shmangia e ndikimeve

9. Në bazë të rezultateve të shqyrtimit paraprak, klienti duhet ta përzgjedhë vendndodhjen dhe hartimin e projektit në mënyrë të atillë që të shmangë ndikimet e konsiderueshme tek trashëgimia kulturore. Kur procesi i shqyrtimit paraprak i klientit identifikon ndikime të mundshme të padëshirueshme në fazat e hershme të përgatitjes së projektit, duhet favorizuar shmangia e ndikimeve të padëshirueshme gjatë fazave të projektimit dhe përzgjedhjes së vendndodhjes.

Vlerësimi i ndikimeve që nuk mund të shmangen

10. Kur ndikimet nuk mund të shmangen, klienti, në bazë të rezultateve të shqyrtimit paraprak, duhet të ndërmarrë studime dhe konsultime për të vlerësuar ndikimet e mundshme dhe, nëse është e nevojshme, ndryshimet e kërkuara në projektin teknik. Objekti i këtyre studimeve dhe konsultimeve duhet të përcaktohet rast pas rasti, në konsultim me autoritetet rregullatore në nivel qendror dhe vendor, të cilave u është besuar mbrojtja e trashëgimisë kulturore. Studimet duhet të kryhen nga specialistë të kualifikuar dhe me përvojë të trashëgimisë kulturore, ose si pjesë e procesit të vlerësimit të përgjithshëm mjedisor dhe social, ose më vete.

11. Vlerësimi dhe zbutja e ndikimeve mbi trashëgiminë kulturore duhet të bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të akteve ligjore kombëtare dhe/ose vendore, planet dhe aktet nënligjore për menaxhimin e zonave të mbrojtura, detyrimet kombëtare sipas ligjeve ndërkombëtare dhe praktikës së mirë ndërkombëtare.

Menaxhimi i ndikimeve tek trashëgimia kulturore

12. Klientit do t'i kërkohet të hartojë masat e duhura për minimizimin dhe zbutjen e ndikimeve të padëshirueshme tek trashëgimia kulturore. Masat zbutëse duhet të trajtojnë rezultatet e vrojtimeve në terren, të vlerësimeve të ekspertëve lidhur me rëndësinë e trashëgimisë kulturore, legjislacionin kombëtar dhe konventat përkatëse ndërkombëtare dhe rezultatet e konsultimeve me komunitetet e prekura dhe palët e tjera të interesit. Masa të tilla zbutëse duhet të përfshihen në SMMS-në e përgjithshme dhe në PMMS-në e veçantë të projektit, ose një plan të veçantë për menaxhimin e trashëgimisë kulturore, ku të përfshihet edhe një afat kohor për zbatimin dhe një vlerësim i nevojave për burime për secilën prej masave zbutëse. Klienti duhet të sigurojë që të ketë personel të trajnuar dhe të kualifikuar për të mbikëqyrur zbatimin e masave zbutëse dhe që çdo i tretë, si nënkontraktor, që punon për projektin, të ketë zotësitë dhe njohuritë e nevojshme dhe të menaxhohet e monitorohet në përputhje me KP 1.
13. Kur vendndodhja e projektit shoqërohet me ndikime ndaj trashëgimisë kulturore ose pengon hyrjen në zona të trashëgimisë kulturore të arritshme më parë, klienti duhet të vlerësojë përdorimin e kësaj zone nga komunitetet e prekura. Kur zona në fjalë është përdorur nga komunitetet e prekura, për aq sa mbajnë mend njerëzit që jetojnë ende, për qëllime kulturore afatgjata, klienti, në bazë të konsultimeve, duhet të mundësojë vijimësinë e arritjes së zonës kulturore në fjalë ose të sigurojë një rrugë alternative për ta arritur atë, gjithmonë në varësi të aspekteve madhore të shëndetit, sigurisë dhe mbrojtjes.

Procedura për gjetjet e papritura

14. Klienti duhet të sigurojë që të ketë në zbatim dispozita për menaxhimin e gjetjeve të rastësishme, të përkufizuara si trashëgimi kulturore fizike, të hasura papritur gjatë zbatimit të projektit. Dispozita të tilla duhet të përfshijnë njoftimin e organeve kompetente në lidhje me sendet apo objektet e gjetura; ndërgjegjësimin e personelit të projektit për mundësinë e gjetjeve të rastësishme; dhe mbrojtjen e zonës ku ka pasur gjetje, për të shmangur çdo shqetësim apo shkatërrim. Klienti nuk duhet të shqetësojë asnjë gjetje të rastësishme, pa u bërë një vlerësim nga një specialist i përcaktuar dhe i kualifikuar dhe pa u identifikuar veprimet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe me këtë kriter performance.

Konsultimet me komunitetet e prekura dhe palët e tjera të interesit

15. Kur një projekt mund të prekë trashëgiminë kulturore, klienti duhet të konsultohet me komunitetet e prekura brenda vendit pritës, të cilët e përdorin ose e kanë përdorur trashëgiminë kulturore për sa kohë mbajnë mend njerëzit që janë ende gjallë, për qëllime kulturore afatgjata, në mënyrë që të identifikohet ajo trashëgimi kulturore që ka rëndësi dhe të përfshihen në procesin vendimmarrës të klientit mendimet e komuniteteve të prekura në lidhje me këtë trashëgimi kulturore. Klienti duhet t'u japë informacion komuniteteve të prekura në një gjuhë transparente dhe të përshtatshme, në lidhje me objektin, vendndodhjen dhe kohëzgjatjen e projektit dhe në lidhje me çdo veprimtari që mund të sjellë ndikime tek trashëgimia kulturore. Këto konsultime duhet të ndjekin kërkesat e KP 10 dhe mund të ishin pjesë e një procesi të gjerë konsultimi lidhur me ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit. Konsultimet duhet të përfshijnë edhe palët e tjera të interesit, si autoritetet në

nivel qendror dhe vendor, të cilave iu është besuar mbrojtja e trashëgimisë kulturore, ekspertët e trashëgimisë kulturore dhe organizatat joqeveritare dhe të shoqërisë civile. Ndikimet mbi trashëgiminë kulturore duhet të zbuten ashtu siç duhet me pjesëmarrjen e lirë dhe të informuar të komuniteteve të prekura.

Përdorimi i trashëgimisë kulturore nga projekti

16. Kur një projekt kërkon të përdorë burimet, dijet, novacionet ose praktikatat e komuniteteve vendore që mishërojnë mënyra tradicionale të jetesës, për qëllime tregtare, klienti duhet t'i informojë këto komunitete për: i. të drejtat e tyre sipas legjislacionit kombëtar; ii. objektin dhe natyrën e zhvillimit tregtar të propozuar; dhe iii. pasojat e mundshme të një zhvillimi të tillë. Klienti duhet ta fillojë një shfrytëzim të tillë tregtar vetëm nëse: i. hyn në negociime në mirëbesim me komunitetet e prekura vendore që mishërojnë mënyra tradicionale jetese; ii. e dokumenton pjesëmarrjen e informuar të tyre dhe rezultatin e suksesshëm të negociimit; dhe iii. u siguron komuniteteve vendore ndarje të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve nga shfrytëzimi tregtar i dijeve, novacioneve ose praktikave të tilla, në përputhje me zakonet dhe traditat e tyre. Kur një projekt propozon të përdorë burimet, dijet, novacionet ose praktikatat kulturore të popujve indigjenë, zbatohen kërkesat e KP 7.

Kriteri i Performancës nr. 9 i BERZH-it:

Ndërmjetësit financiarë

Hyrje

1. Ky kriter performance pranon se ndërmjetësit financiarë (NF) janë një instrument kyç për promovimin e tregjeve financiare të qëndrueshme dhe sigurojnë një mjet për të kanalizuar financimin drejt sektorit të ndërmarrjeve shumë të vogla, të vogla dhe të mesme (SME). Në këta ndërmjetës financiarë përfshihet një larmi ofruesish shërbimesh, përfshi fondet e kapitalit privat, bankat, kompanitë *leasing*, shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve. Ndërmjetësit financiarë angazhohen në një gamë të gjerë veprimtarish, si mikro-financimi, huadhënia për SME-të, financimi i tregtisë, financimi i infrastrukturave të mëdha, financimi afatmesëm dhe afatgjatë për projektet dhe për shoqëritë e mëdha dhe financimi për strehim.
2. Natyra e financimit me ndërmjetësim do të thotë që ndërmjetësit financiarë marrin përsipër përgjegjësinë e deleguar për vlerësimin mjedisor dhe social, menaxhimin e rrezikut dhe monitorimin, krahas menaxhimit të përgjithshëm të portofolit. Natyra e delegimit mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të disa faktorëve, siç është lloji i financimit të ofruar. Efektiviteti i menaxhimit mjedisor dhe social të ndërmjetësve financiarë duhet të vlerësohet dhe të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, gjatë të gjithë ciklit të jetës së projektit.

Objektivat

3. Objektivat e këtij kriteri performance janë:
 - dhënia mundësi ndërmjetësve financiarë që të menaxhojnë rreziqet mjedisore dhe sociale që shoqërojnë veprimtaritë e tyre tregtare dhe që të ndjekin praktika të mira tregtare mjedisore dhe sociale tek klientët e tyre
 - caktimi i një qasjeje praktike me të cilën ndërmjetësit financiarë mund të nxisin dhe të arrijnë praktika tregtare të qëndrueshme nga aspekti mjedisor dhe social, në përputhje me këtë kriter performance dhe me praktikën e mirë ndërkombëtare në sektorin financiar tregtar
 - nxitja e menaxhimit të mirë mjedisor dhe e burimeve njerëzore brenda ndërmjetësve financiarë.

Fusha e zbatimit

4. Në kuptim të këtij kriteri performance, termi “projekt” përdoret për tërësinë e përcaktuar të veprimtarive tregtare për të cilat një klient kërkon financim nga BERZH-i ose për të cilat është siguruar që më parë financim, ku tërësia e veprimtarive të punës është e përcaktuar në kontratat e financimit dhe është miratuar nga Bordi i Drejtorëve i BERZH-it, ndërsa termi “nënprojekt” përdoret për projektet e financuara nga ndërmjetësit financiarë.
5. Kur projekti përfshin një tërësi të përcaktuar qartë veprimtarish tregtare (për shembull, një linjë kreditimi ose një produkt tjetër financimi), kërkesat specifike të këtij kriteri performance duhet të jenë të zbatueshme për të gjitha nënprojektet.
6. Kur projekti përfshin financim të përgjithshëm për shoqërinë tregtare, që nuk mund të gjurmohet në një financim përmes një nënprojekti të veçantë, si në formë kapitali neto, aksione preferenciale ose borxhi të nënrenditur, kërkesat e këtij kriteri performance zbatohen për të gjitha nënprojektet e ardhshme të ndërmjetësit financiar.

7. Kur një projekt i ndërmjetësit financiar ka të ngjarë të ketë ndikime minimale ose zero ndikime të padëshirueshme mjedisore ose sociale, si dhënia e kredive konsumatore dhe opsionet e kurseve të kryqëzuara valutore, ndërmjetësi financiar nuk ka nevojë të zbatojë procedura të menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social.
8. Ndërmjetësit financiar mund t'i kërkohej të ndjekë dhe të zbatojë kërkesa shtesë ose alternative mjedisore dhe sociale, në varësi të natyrës së ndërmjetësit financiar dhe veprimtarive tregtare të tij, portofolit dhe vendit ku ushtrohet aktivitetet.

Kapaciteti organizativ brenda ndërmjetësit financiar

9. Ndërmjetësi financiar duhet të mbajë politika për burimet njerëzore, sisteme dhe praktika administrimi në përputhje me KP 2: Kushtet e punës, dhe kërkesat përkatëse për shëndetin dhe sigurinë në punë të KP 4: Shëndeti dhe siguria, dhe t'ua komunikojë këto punonjësve të tij. Ndërmjetësi financiar duhet t'u sigurojë punonjësve dhe sipërmarrësve të tij një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm.
10. Ndërmjetësi financiar duhet të caktojë një përfaqësues të drejtuesve të lartë të ndërmjetësit financiar për çështjet mjedisore, shëndetësore, sociale dhe të sigurisë, përfshi edhe për zbatimin e këtij kriteri performance dhe të KP 2 dhe KP 4 (të përmendura më lart). Përfaqësuesi përgjegjës i drejtuesve të lartë duhet: i. të caktojë një punonjës si personin përgjegjës për zbatimin e përditshëm të kërkesave mjedisore dhe sociale dhe të japë mbështetje për zbatimin; ii. të identifikojë nevojat për trajnim mjedisor dhe social dhe buxhetin e nevojshëm; dhe iii. të sigurojë që të ketë ekspertizën e duhur teknike, ose nga brenda organizatës ose nga jashtë saj, për të kryer vlerësimet dhe për të menaxhuar nënprojektet me çështje dhe ndikime të mundshme e të konsiderueshme të padëshirueshme mjedisore ose sociale.

Kërkesat

11. Ndërmjetësi financiar duhet të ketë në funksionim një Sistem të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS), përfshi një politikë mjedisore dhe sociale dhe procedura mjedisore dhe sociale¹ sipas natyrës së ndërmjetësit financiar, nivelit të rreziqeve mjedisore dhe sociale që shoqërojnë veprimtaritë e tij tregtare dhe llojit të projektit dhe nënprojekteve.
12. Kur ndërmjetësi financiar mund të tregojë se e ka një SMMS në funksionim, ai duhet të japë dëshmitë e duhura e të dokumentuara për një SMMS të tillë.
13. Procedurat mjedisore dhe sociale duhet të përfshijnë mekanizmat e vlerësimit dhe të monitorimit të rrezikut, sipas rastit:
 - për të shqyrtuar paraprakisht të gjithë klientët/nënprojektet kundrejt Listës së përjashtimit mjedisor dhe social të ndërmjetësit financiar, bashkëlidhur si Shtojca 1 e Politikës Mjedisore dhe Sociale
 - për të kategorizuar rrezikun mjedisor dhe social të nënprojekteve të propozuara (i ulët/u mesëm/i lartë) në përputhje me Listën e BERZH-it për kategorizimin e rrezikut mjedisor dhe social për ndërmjetësit financiarë

¹ Për t'i ndihmuar ndërmjetësit financiarë të vënë në zbatim një SMMS dhe procedura, BERZH-i ka hartuar një manual për menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe social ku jepen udhëzime për lloje të ndryshme ndërmjetësish financiarë dhe shërbimesh financiare. Nga ndërmjetësit financiarë që nuk kanë procedura ekuivalente në përdorim, kërkohej të përdorin pjesët përkatëse të manualit në lidhje me nënprojektet përkatëse.

- për të siguruar, përmes vlerësimit, që nënprojektet të strukturohen në përputhje me kërkesat rregullatore të vendit në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale, përfshi, sipas nevojës, kërkesën ndaj klientëve të zbatojnë plane korrigjuese veprimi
- për të siguruar që nënprojektet që financohen të përmbushin kriteret e listës orientuese të projekteve të Kategorisë A të përfshira në Shtojcën 2 të Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it; nënprojekteve të tilla do t'u duhet të përmbushin KP 1-8 dhe 10
- për të mbajtur dhe përditësuar rregullisht të dhënat mjedisore dhe sociale për nënprojektet
- për të monitoruar nënprojektet për të siguruar përputhshmëri me aktet kombëtare ligjore për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë, si dhe punën.

Angazhimi i palëve të interesit

14. Ndërmjetësit financiarë duhet të vënë në zbatim një sistem për trajtimin e komunikimit të jashtëm për çështjet mjedisore dhe sociale, për shembull duke caktuar një pikë kontakti për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të publikut, përfshi edhe shqetësimet në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale. Ndërmjetësi financiar duhet t'u përgjigjet pyetjeve dhe shqetësimeve të tilla në kohën e duhur. Nxiten ndërmjetësit financiarë gjithashtu të publikojnë politikën e tyre mjedisore dhe sociale ose një përmbledhje të SMMS-së së tyre në faqen e internetit, nëse ka. Kur është e mundur, ndërmjetësit financiarë duhet të vendosin në faqen e tyre të internetit lidhjen për çdo raport vlerësimi të ndikimeve mjedisore dhe sociale për nënprojektet e Kategorisë A që financojnë.

Raportimi tek BERZH-i

15. Ndërmjetësi financiar duhet t'i paraqesë BERZH-it raporte vjetore mjedisore dhe sociale për zbatimin e SMMS-së së tij, të këtij kriteri performance, të kriterit 2, të kërkesave për sigurinë dhe shëndetin në punë të kriterit 4, si edhe për ecurinë mjedisore dhe sociale të portofolit të nënprojekteve të tij.

Nismat vullnetare

16. Nxiten ndërmjetësit financiarë të ndjekin praktikën e mirë ndërkombëtare në menaxhimin mjedisor dhe social në të gjitha operacionet e tyre për huadhënien dhe investimet, pavarësisht janë apo jo pjesë e projektit. Në veçanti, nxiten ndërmjetësit financiarë:
 - ta shtrijnë zbatimin e SMMS-së dhe të procedurave të menaxhimit të rreziqeve mjedisore dhe sociale tek të gjitha veprimtaritë e tyre tregtare, përfshi edhe ato për të cilat nuk zbatohet ky kriter performance
 - të identifikojë, sipas rastit, mundësitë për zhvillimin e produkteve financiare me përfitime të larta mjedisore dhe/ose sociale (për shembull, financim për investime në fushën e eficiencës së energjisë, burimet e rinovueshme të energjisë ose biznesin në favor të biodiversitetit, produktet e ndërtuara enkas për sipërmarrëset femra, ofrimi i kreditimit për sipërmarrësit shumë të vegjël).

Nxiten gjithashtu ndërmjetësit financiarë të mendojnë pjesëmarrjen në nisma ndërkombëtare ekzistuese, që nxisin praktikën më të mirë në sektorin financiar, siç janë Parimet e Ekuatorit, Nisma e UNEP-it për Financim dhe Parimet për Investimet e Përgjegjshme.

Kriteri i Performancës nr. 10 i BERZH-it:

Dhënia e informacionit dhe përfshirja e palëve të interesit

Hyrje

1. Ky kriter performance njeh rëndësinë e një pjesëmarrjeje të hapur dhe transparente midis klientit, punonjësve të tij, komuniteteve vendore drejtpërdrejt të prekur nga projekti dhe, sipas rastit, palëve të tjera të interesit, si një element thelbësor i praktikës së mirë ndërkombëtare dhe qytetarisë së shoqërisë tregtare.¹ Një përfshirjeje tillë është edhe një mënyrë për ta përmirësuar qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale të projekteve. Në veçanti, një përfshirjeje e efektshme e komunitetit, i përshtatshëm me natyrën dhe shkallën e projektit nxit një ecuri mjedisore dhe sociale të shëndoshë dhe të qëndrueshme dhe mund të sjellë rritje të rezultateve financiare, mjedisore dhe sociale, krahas rritjes së përfitimeve për komunitetin. Përfshirja e palëve të interesit është thelbësore për ndërtimin e marrëdhënieve të forta, konstruktive dhe reaguese të cilat janë të rëndësishme për menaxhimin me sukses të çështjeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të një projekti. Për të qenë i efektshëm, përfshirja e palëve të interesit duhet të fillohet në një fazë të hershme të ciklit të projektit.
2. Ky kriter performance identifikon praktikën e mirë ndërkombëtare lidhur me përfshirjen në vazhdimësi të palëve të interesit, si një proces i vazhdueshëm i cili kërkon: i. bërjen publike të informacioneve të duhura; ii. konsultime të kuptimta me palët e interesuara; dhe iii. një procedurë ose mekanizëm të efektshëm përmes të cilit njerëzit të mund të bëjnë vërejtje ose ankesa. Prosesi i përfshirjes së palëve të interesit të fillojë në një fazë sa më të hershme të planifikimit të projektit dhe të vazhdojë gjatë gjithë jetës së projektit. Ai është pjesë përfshirëse e vlerësimit, menaxhimit dhe monitorimit të ndikimeve dhe çështjeve mjedisore dhe sociale të projektit. Për rrjedhojë, ky kriter performance duhet të lexohet së bashku me kriterin 1 dhe me kërkesat e kriterit 2 në lidhje me përfshirjen punonjësve. Në rastin e projekteve që kërkojnë shpërngulje të detyrueshme dhe/ose zhvendosje ekonomike, që prekin popuj indigjenë ose që kanë ndikimeve të padëshirueshme tek trashëgimia kulturore, klienti duhet të zbatojë edhe kërkesat e posaçme për dhënien e informacionit dhe konsultimet siç parashikohet në kriteret 5, 7 dhe 8.

Objektivat

3. Objektivat e këtij kriteri performance janë:
 - përvijimi i një qasjeje sistematike për përfshirjen e palëve të interesit, që do t'i ndihmojë klientët të ndërtojnë dhe të mbajnë një marrëdhënie konstruktive me palët e interesit, në veçanti me komunitetet e prekura drejtpërdrejt
 - promovimi i përmirësimit të ecurisë mjedisore dhe sociale të klientëve përmes përfshirjes së efektshme të palëve të interesit për projektin
 - promovimi dhe sigurimi i mjeteve për përfshirjen e duhur të komuniteteve të prekura përgjatë gjithë ciklit të projektit, për çështje që mund t'i prekin këto komunitete dhe për të siguruar dhënien e informacioneve të plota mjedisore dhe sociale palëve të interesit të projektit
 - sigurimi që ankesat që vijnë nga komunitetet e prekura dhe palët e tjera të interesit të marrin përgjigje dhe të menaxhohen siç duhet.

¹ Ky kriter performance orientohet nga fryma, parimet dhe qëllimet madhore për dhënien e informacioneve dhe përfshirjen e palëve të interesit të mishëruara në Konventën "Për të drejtën e informimit, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore" të Komisionit të Ekonomisë për Evropën i Kombeve të Bashkuara (UNECE).

Fusha e zbatimit²

4. Ky kriter performance zbatohet për të gjitha projektet që ka të ngjarë të kenë çështje dhe ndikime të padëshirueshme mjedisore dhe sociale tek mjedisi, punonjësit ose komunitetet vendore të prekura drejtpërdrejt nga projekti. Nga klientët pritet të identifikojnë dhe të përfshijnë palët e interesit si pjesë integrale të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) të tyre, procesit të vlerësimit mjedisor dhe social të projektit dhe Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) sikurse përcaktohet në KP 1.

Kërkesat

5. Klientët duhet ta realizojnë pjesëmarrjen palëve të interesit duke u dhënë komuniteteve vendore, që preken drejtpërdrejt nga projekti dhe palëve të tjera përkatëse të interesit, të drejtën për të marrë në kohën e duhur informacion aktual, të kuptueshëm dhe të arritshëm, në mënyrë të kulturuar dhe pa asnjë manipulim, ndërhyrje, kanosje dhe frikësim.
6. Pjesëmarrja e palëve të interesit duhet të përfshijë elementet e mëposhtme: identifikimin dhe analizimin e palëve të interesit, planifikimin e përfshirjes së palëve të interesit, dhënien e informacionit, konsultimet dhe pjesëmarrjen, mekanizmin e ankimit dhe raportimin në vazhdimësi tek palët përkatëse të interesit.
7. Natyra dhe shpeshtësia e përfshirjes së palëve të interesit duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e projektit dhe me ndikimet e padëshirueshme që mund të ketë tek komunitetet e prekura, ndjeshmërinë e mjedisit dhe nivelin e interesit publik. Për ta përshtatur pjesëmarrjen sipas veçantive të klientit dhe projektit, është e rëndësishme që klientët t'i identifikojnë palët e interesit siç parashikohet më poshtë. Gjithmonë duhen përmbushur kërkesat e legjislacionit kombëtar në lidhje me informimin dhe konsultimin e publikut, përfshi edhe ato akte ligjore që zbatohen detyrimet që ka vendi prites në kuadër të së drejtës ndërkombëtare.
8. Klienti duhet të përcaktojë role, përgjegjësi dhe autoritete të qarta, si dhe të caktojë punonjës specifikë të cilët të jenë përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e veprimtarive të përfshirjes së palëve të interesit.

Përfshirja gjatë përgatitjes së projektit

Identifikimi i palëve të interesit

9. Klienti duhet të identifikojë dhe të dokumentojë individët ose grupet e ndryshme që i preken ose ka të ngjarë të preken (drejtpërdrejt ose tërthorazi) nga projekti (palët e prekura); ose ii. mund të kenë interes për projektin (palët e tjera të interesuara).
10. Klienti duhet të identifikojë individët dhe grupet që mund të preken në mënyrë të diferencuar ose jo përpjesëtimore nga projekti për shkak të pozitave të tyre të pafavorshme apo më të ndjeshme (shih KP 1, KP 5 dhe KP 7) dhe të identifikojë nëse këta individë apo grupe të tjera të interesuara kanë të ngjarë të përjashtohen, ose nuk kanë mundësi të marrin pjesë, në procesin e konsultimeve ose do të kishin nevojë për masa të veçanta dhe/ose asistencë për të marrë pjesë në to. Sipas rastit, klienti duhet të identifikojë edhe interesat e ndryshme brenda grupeve të identifikuar. Kjo mund të jetë për shkak të çështjeve të tilla si mosha të ndryshme, përkatësia gjinore dhe dallimet etnike dhe kulturore, që shkaktojnë shqetësime dhe përparësi të ndryshme në lidhje me ndikimet e projektit, masat zbutëse dhe

² Gjithashtu, dispozitat e posaçme për gatishmërinë dhe përgjigjshmërinë në rast emergjence mbulohen në KP 4.

përfitimet. Prandaj kjo mund të kërkojë forma të ndryshme dhe/ose të veçanta pjesëmarrjeje. Klienti duhet të identifikojë edhe mënyrën me të cilën preken palët e interesit dhe shkallën e ndikimeve të mundshme (faktike ose të perceptuara). Kur ndikimet janë të perceptuara, mund të duhet komunikim tjetër shtesë për të dhënë informacion dhe garanci lidhur me nivelin e vlerësuar të ndikimeve. Duhet përfshirë një nivel i mjaftueshëm detajimi në identifikimin e palëve të interesit, në mënyrë që të përcaktohet niveli i komunikimit që është i përshtatshëm për projektin.

Plani për përfshirjen e palëve të interesit

11. Për projektet që ka të ngjarë të kenë çështje dhe ndikime të padëshirueshme mjedisore ose sociale, klienti duhet të hartojë dhe të zbatojë një plan për përfshirjen e palëve të interesit (PAPI) të përshtatshëm për natyrën dhe shkallën e rreziqeve, të ndikimeve dhe fazës së zhvillimit të projektit. Për çdo projekt që kërkon një Vlerësim të ndikimeve mjedisore dhe sociale (VNMS), PAPI duhet të zbatojë kërkesat për dhënie të informacionit dhe konsultimet e parashtruara më poshtë në pikat 21-25. PAPI duhet të përshtatet për të mbajtur në konsideratë karakteristikat kryesore dhe interesat e palëve të prekura dhe nivelet e ndryshme të përfshirjes dhe të konsultimit, që mund të jenë të përshtatshme për palët e prekura dhe palët e tjera të interesuara. PAPI duhet të parashikojë se si do të bëhet komunikimi me palët e identifikuara të interesit gjatë gjithë përgatitjes dhe zbatimit të projektit, përfshi edhe procedurën e parashikuar për ankesat (shih më poshtë). Niveli i detajimit të nevojshëm përcaktohet rast pas rasti. Burimet e mundshme për informimin dhe konsultimin e publikut duhet të përqendrohen në fillim tek palët e prekura.
12. PAPI duhet të dokumentojë se si do të kryhen konsultimet me grupet e ndryshme të komunitetit, duke identifikuar se cilat masa do të zbatohen për heqjen e pengesave për pjesëmarrjen. Këto mund të mbështeten në çështje të tilla si përkatësia gjinore, mosha apo të tjera dallime, dhe tek mënyra se si do të dokumentohen pikëpamjet e grupeve të ndryshme të prekura. Kur duhen, PAPI duhet të përfshijë masat e diferencuara që mundësojnë pjesëmarrjen e efektshme të atyre që janë identifikuar si grupe në pozita të pafavorshme ose të pambrojtura. Për të komunikuar në mënyrë të efektshme me palët të tilla të interesuara mund të duhen qasje të përkushtuara dhe një nivel më i madh burimesh. Kur përfshirja e palëve të interesit varet në mënyrë të konsiderueshme tek përfaqësuesit e komunitetit,³ klienti duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të verifikuar që këta persona përfaqësojnë me të vërtetë pikëpamjet e komuniteteve të prekura dhe që ata e lehtësojnë procesin e komunikimit duke ua komunikuar informacionin zgjedhësve të tyre dhe duke i përcjellë komentet e tyre tek klienti ose autoritetet, sipas rastit.
13. Kur përfshirja e palëve të interesit është përgjegjësi e autoriteteve përkatëse shtetërore, klienti duhet të bashkëpunojë me autoritetin shtetëror përgjegjës, për aq sa lejohet, për të arritur rezultate që të jenë në përputhje me këtë kriter performance. Kur ka boshllëqe midis kërkesave rregullatore vendore dhe këtij kriteri performance, klienti duhet të identifikojë veprimtaritë e pjesëmarrjes në plotësim shtesë të procesit rregullator zyrtar dhe, sipas rastit, të angazhohet për masa plotësuese shtesë.
14. Në rastet kur nuk dihet vendndodhja e saktë e projektit, PAPI duhet të ketë formatin e një qasjeje kornizë si pjesë e SMMS-së së përgjithshme të klientit, duke përvijuar parimet e përgjithshme dhe një strategji për të identifikuar palët e prekura të interesit dhe planin për një proces pjesëmarrjeje në përputhje me këtë kriter performance që do të zbatohet pasi të merret vesh vendndodhja.

³ Për shembull, udhëheqësit e komunitetit dhe ata fetarë, përfaqësuesit e pushtetit vendor, përfaqësuesit e shoqërisë civile, politikanët, mësuesit dhe/ose të tjerë përfaqësues të një ose më shumë grupeve të prekura të palëve të interesit.

15. Klientët me aktivitete dhe projekte në disa zona, për të cilat kërkohet financim i përgjithshëm i shoqërisë tregtare, kapital qarkullues ose financim për kapitalin neto, duhet të ndjekin dhe të batojnë një PAPI në nivel shoqërie tregtare. PAPI në nivelin e shoqërisë tregtare duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën e veprimtarisë tregtare të klientit dhe me ndikimet përkatëse mjedisore dhe sociale dhe nivelin e interesit publik. PAPI duhet të shtrihet tek të gjitha objektet në kohën e duhur. Ai duhet të përfshijë procedura dhe burime për të siguruar përfshirjen e palëve të interesit në nivel objekti dhe për të siguruar që palët e interesit në afërsi të objekteve të marrin informacion për ecurinë mjedisore dhe sociale të objektit përkatës.

Dhënia e informacionit

16. Bërja e ditur e informacioneve përkatëse për projektin i ndihmon palët e interesit të kuptojnë rreziqet, ndikimet dhe mundësitë e projektit. Nëse komunitetet mund të preken nga ndikimet e padëshirueshme mjedisore ose sociale nga projekti, klienti duhet t'u japë atyre mundësi shikimi të informacionit të mëposhtëm (Informacioni):
- qëllimi, natyra, madhësia dhe kohëzgjatja e veprimtarive të projektit
 - rreziqet dhe ndikimet e mundshme për palët e interesit dhe planet e propozuara për zbutjen e tyre
 - procesi i parashikuar për përfshirjen e palëve të interesit, nëse ka, dhe mundësitë dhe mënyrat me të cilat mund të marrë pjesë publiku
 - koha dhe vendi i çdo mbledhjeje të parashikuar për konsultimet me publikun dhe procesi me të cilin njoftohen, përmbledhen dhe raportohen mbledhjet
 - procesi me të cilin do të menaxhohen ankesat.
17. Informacioni duhet të jepet në gjuhën ose gjuhët vendore, sikurse identifikohet në PAPI-n, dhe në një mënyrë që të jetë e arritshme dhe e përshtatshme nga ana kulturore. Kjo do të marrë në konsideratë nevojat e veçanta të grupeve që mund të preken në mënyrë të diferencuar ose më shumë se të tjerët nga projekti për shkak të statusit të tyre ose të grupeve të popullsisë me nevoja të veçanta informimi.

Konsultime kuptimplota

18. Konsultimi kuptimplotë është një proces me dy kahe. Prosesi i konsultimit me palët e prekura duhet të kryhet në mënyrë të atillë që të jetë gjithëpërfshirës dhe i përshtatshëm nga ana kulturore dhe që të përfaqësojë mendimet dhe nevojat e veçanta të grupeve të ndryshme sikurse identifikohet në PAPI ose sikurse merr dijeni klienti gjatë zbatimit të PAPI-t. Konsultimi duhet të përfshijë, përtej palëve të prekura, edhe çdo grup ose individ që është identifikuar si palë tjetër e interesuar. Klienti duhet të mbajë parasysh preferencat kryesore gjuhësore të palëve të prekura, procesin e tyre vendimmarrës dhe nevojat e grupeve në pozita të pafavorshme ose më të ndjeshme. Klienti duhet të sigurojë që konsultimi do të jetë pa manipulime dhe pa ndërhyrje nga jashtë, si dhe pa kanosje apo frikësime.
19. Nevoja dhe natyra e çdo konsultimi të veçantë përcaktohet në bazë të identifikimit të palëve të interesit dhe në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e ndikimeve të padëshirueshme, që mund të kenë tek komunitetet e prekura nga projekti. Kur komunitetet e prekura mund të vuajnë ndikime të konsiderueshme të padëshirueshme në të ardhmen nga projekti, klienti duhet të zhvillojë një proces konsultimi kuptimplotë në mënyrë që t'u japë palëve të interesit mundësi për të shprehur mendimet e tyre për rreziqet e projektit, ndikimet dhe masat zbutëse dhe t'i japë mundësi vetes t'i marrë këto mendime në konsideratë dhe t'u përgjigjet atyre. Konsultimi kuptimplotë duhet të kryhet në vazhdimësi, me zhvillimin e

natyrës së çështjeve, ndikimeve dhe mundësive. Nëse klientët janë angazhuar më parë në një proces të tillë, ata duhet të paraqesin dëshmi të dokumentuar për një përfshirjetë tillë.

20. Klienti duhet t'i informojë në kohë ata që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit publik lidhur me vendimin përfundimtar për projektin, masat përkatëse zbutëse mjedisore dhe sociale dhe çdo përfitim të projektit për komunitetet vendore, së bashku me arsyet dhe argumentet mbi të cilat është bazuar vendimi dhe mekanizmin ose procesin që mund të përdoret për ankesat.

Dhënia e informacionit dhe konsultimet për Projektet e Kategorisë A

21. Projektet e kategorisë A⁴ mund të sillnin ndikimeve të padëshirueshme mjedisore dhe/ose sociale të konsiderueshme në të ardhmen të cilat nuk mund të identifikohen ose analizohen menjëherë dhe të cilat kërkojnë që klienti të kryejë një proces zyrtar të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social (VNMS). Kërkesat për dhënie të informacionit dhe konsultimet duhet të përfshihen në çdo fazë të procesit VNMS-së, rast pas rasti. Pjesëmarrja e informuar kërkon konsultime të organizuara dhe të përsëritura, si rezultat i të cilave klienti duhet të përfshijë në procesin vendimmarrës pikëpamjet e palëve të prekura për çështjet që i prekin drejtpërdrejt, siç janë masat e propozuara zbutëse, ndarja e barabartë e përfitimeve dhe e mundësive që vijnë nga projekti dhe çështjet e zbatimit.
22. Klienti duhet të përfshihet në një proces të përcaktimit të fushëveprimit me palët e interesuara dhe palët e identifikuar të interesit në një fazë të hershme të procesit VNMS, për të siguruar identifikimin e çështjeve kryesore që duhen vlerësuar në kuadër të VNMS-së. Në kuadër të procesit të përcaktimit të fushëveprimit, palët e interesit duhet të jenë në gjendje të japin vërejtje dhe sugjerime për një projekt-PAPI dhe dokumentet e tjera të përcaktimit të fushëveprimit.
23. Nëse për një projekt është miratuar një plan veprimi mjedisor dhe social (PVMS) i cili kërkon një VNMS-ë, klienti duhet t'ua bëjë të ditur PVMS-në palëve të prekura në përputhje me PAPI-n.
24. Gjithashtu, procesi i konsultimeve duhet të përmbushë çdo kërkesë të zbatueshme sipas legjislacionit të brendshëm për vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sipas akteve të tjera përkatëse ligjore. Klienti duhet ta mbajë publik VNMS-në përgjatë gjithë jetës së projektit, por ai mund të ndryshohet, herë pas here, me informacione shtesë ose të arkivohet pas përfundimit të projektit, për sa kohë është i disponueshëm sipas kërkesës brenda afateve të duhura.
25. Klientit i kërkohet t'ua japë raporte të rregullta palëve të interesuara për ecurinë e tij mjedisore dhe sociale, si një botim më vete, ose në faqen e tij të internetit, sikurse parashikohet në PAPI. Këto raporte duhet të kenë një format të përdorshëm për komunitetet e prekura dhe shpeshësia e tyre duhet të jetë në përpjesëtim me shqetësimet e komuniteteve të prekura, por jo më pak se një herë në vit.

Përfshirja gjatë zbatimit të projektit dhe raportimi i jashtëm

26. Për të gjitha projektet, klienti duhet t'ua japë informacion palëve të identifikuar të interesit, në mënyrë të vazhdueshme, në përshtatje me natyrën e projektit dhe çështjet e ndikimit e padëshirueshme mjedisore dhe sociale të tij, dhe nivelin e interesit publik gjatë gjithë jetës

⁴ Një listë orientuese për projekte të kategorisë A jepet në Shtojcën 2 të Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it.

së projektit. Mund të duhet të jepen informacione shtesë në faza kyçe të ciklit të projektit, për shembull përpara fillimit të aktiviteteve, dhe për çdo çështje të veçantë që është identifikuar si shqetësim nga komunitetet e prekura gjatë procesit të dhënies së informacionit dhe konsultimit apo mekanizmit të ankesave.

27. Nëse ka ndryshime me rëndësi materiale të projektit, të cilat sjellin çështje ose ndikime të tjera të padëshirueshme shtesë, që përbëjnë shqetësim për komunitetet e prekura, klienti duhet të informojë se si po trajtohen këto çështje dhe ndikime dhe të bëjë të ditur një PMMS-ë të përditësuar në përputhje PAPI-në. Nëse ndikimet shtesë të padëshirueshme tek komunitetet e prekura janë të konsiderueshme, klientit mund t'i kërkohej, rast pas rasti, të japë informacion dhe të bëjë konsultime shtesë në përputhje me pikat 16-20.

Mekanizmi për ankesat

28. Klienti do të duhet të jetë i ndërgjegjshëm për shqetësimet e palëve të interesit në lidhje me projektin dhe t'u përgjigjet atyre në kohë. Për këtë qëllim, klienti duhet të ngrejë një mekanizëm, proces ose procedurë të efektshme për ankesat, në mënyrë të që marrë dhe të mundësojë zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, sidomos për ecurinë mjedisore dhe sociale të klientit. Mekanizmi i ankesave duhet të jetë në përputhje me shkallën e rreziqeve dhe të ndikimeve të padëshirueshme që mund të ketë projekti.
- Procesi ose procedurat e mekanizmit të ankesave duhet t'i trajtojnë shqetësimet menjëherë dhe në mënyrë të efektshme, transparente dhe të përshtatshme nga ana kulturore, si edhe të arritshme për të gjitha segmentet e komuniteteve të prekura, pa kosto dhe pa hakmarrje. Mekanizmi, procesi apo procedura nuk duhet ta pengojë përdorimin e rrugëve ligjore gjyqësore ose administrative. Klienti duhet t'i informojë komunitetet e prekura për procesin e ankesave gjatë veprimtarive të përfshirjesme komunitetin dhe të raportojë rregullisht përpara publikut për zbatimin e tij, duke mbrojtur të dhënat private të individëve të prekur.
 - Trajtimi i ankesave duhet bërë me një mënyrë të përshtatshme nga ana kulturore dhe të jetë diskret, objektiv, i ndjeshëm dhe reagues ndaj nevojave dhe shqetësimeve të palëve të interesit. Mekanizmi duhet të mundësojë paraqitjen dhe trajtimin e ankesave në formë anonime.